



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në “Bashkinë Gjirokastër”**

# **RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI**

**“MBI AUDITIM FINANCIAR DHE  
TË PËRPUTHSHMËRISË”**

**SUBJEKTI BASHKIA  
GJIROKASTËR**

**Tiranë, 2023**

<b>NR</b>	<b>EMËRTIMI I KAPITUJVE</b>	<b>FAQE</b>
<b>I</b>	<b>PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE</b>	<b>4-26</b>
<b>1.</b>	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	<b>4-4</b>
<b>2.</b>	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve.....	<b>4-24</b>
<b>3.</b>	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni I Auditimit.....	<b>24-26</b>
<b>II</b>	<b>HYRJA</b>	<b>26-31</b>
	a. Objektivat e auditimit.....	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikim i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit .....	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodat e auditimi .....	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
<b>III.</b>	<b>PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.</b>	<b>31-112</b>
<b>1.</b>	<b>Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim..</b>	<b>31-33</b>
<b>2.</b>	<b>Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit...</b>	<b>33-112</b>
2.1	<i>Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm; Vlerësim mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.</i>	34-43
2.2.	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	43-49
2.2.6	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.</i>	49-54
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.</i>	54-74
2.4	<i>Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.</i>	74-91-96
2.5	<i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit</i>	96-103
2.6	<i>Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV)</i>	103-106
2.7	<i>Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.</i>	107-111
2.8	<i>Të ndryshme të dala gjatë auditimit</i>	111-112
<b>IV.</b>	<b>GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË.....</b>	<b>112-131</b>
<b>V.</b>	<b>ANEKSE.....</b>	<b>133-189</b>

## SHKURTIME

<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues.
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues.
<b>GSM</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
<b>AB</b>	Auditi i Brendshëm
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
<b>FZHR</b>	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave.
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak.
<b>ISSAI</b>	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>IFAC</b>	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ALUIZNI-t</b>	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit.
<b>NJA</b>	Njësi Administrative.
<b>SHA</b>	Shoqëri Anonimë.
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
<b>OE</b>	Operator Ekonomik.

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 26.06.2023 deri në datë 28.07.2023, në subjektin Bashkia Gjirokastrë, për auditimin financiarë për periudhën 01.01.2022 deri në 31.12.2022 dhe për auditimin përputhshmërie për periudhën 01.10.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërie*” duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2022, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike dhe menaxhimit të të ardhurave, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë periudhës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi janë të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të Audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën nga data 01.01.2022 deri më datë 31.12.2022, grupi i auditimit konkludon në një **opinion të modifikuar, me rezervë**, për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2022), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet ka dalë me **opinion të modifikuar**.

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

### I.1. Përshkrim i shkurtër i Raport Auditimit

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1	Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastrë nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe	<b>E lartë</b>	34-43	Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë të merren masa për hartimin dhe miratimin e

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori.</p> <p>Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II “Rolet dhe aktorët në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, pika 2.2.6 “Grupi i menaxhimit strategjik”, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, Kapitulli III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, hapi 5.</p>			<p>strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimit të riskut.</p>
2	<p>Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2022, nga 1,299,784 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 995,656 mijë lekë ose në masën 77 %, (Pagat (600) nga 366,254 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 350,489 mijë lekë, sigurime shoq. (601) nga 60,144 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 58,354 mijë lekë, Shpenzime operative (602) nga 184,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 155,688 mijë lekë dhe shpenzime për investime (230-231) nga 431,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 185,300 mijë lekë, me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 30,065 mijë lekë, grand në vlerën 59,395 mijë lekë, dhe transfertës e kushtëzuar në vlerën 95,840 mijë lekë) ose 43%, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për investime, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se është më i</p>	E lartë	43-49	<p>Bashkia Gjirokastër, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky mos realizim vjen si rezultat i realizimit të procedurave të prokurimit në fund të vitit e për pasojë kontratat janë lidhur në vitin 2023, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.</p>			<p>buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.</p>
3	<p>Nga auditimi i rezultoi se nga totali i detyrimeve sipas bilancit në vlerën 10,889,181 lekë, janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë <b>për vlerën 9,199,181 lekë</b> (detyrime shpenzime kapitale në vlerën 8,236,219 lekë dhe detyrime për vendime gjyqi në vlerën 962,962 lekë). Diferenca për vlerën 1,690,000 lekë që nuk është raportuar MFE ka të bëjë me paradhëniet për kopshte e çerdhe në fund të vitit. Detyrime të papaguara më datë 31.12.2022, janë në vlerën gjithsej 9,199,181 lekë të cilat nuk janë likuiduar për mungesë të fondeve, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe ligjit nr. 10269 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” neni 12, germa “gj”.</p>	<b>E lartë</b>	43-49	<p>Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Financës , të paraqesë në mbledhjen e këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet t’i ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbarusit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore.</p>
4	<p>Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,986,115 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, është paraqitur më pak për vlerën 59,718,570lekë në të nuk janë përfshirë vlera e plotë e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore në vlerën 54,266,148 lekë, detyrimet për qira objekti në vlerën 2,526,000 lekë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve në vlerën 1,854,317 lekë dhe detyrimet për qira tokë bujqësore në vlerën 1,072, 105 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe</p>	<b>E lartë</b>	54-74	<p>Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore, qira tokash, qira objekti dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30, ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, germa “g”.			
5	Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 46,772,800 lekë, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare për vlerën 275,277,960 lekë, pasi kjo llogari është pasqyruar në vlerën 322,050,760 lekë, në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 59.	<b>E lartë</b>	54-74	Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.
6	Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, e pasqyruar në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 40,345,713 lekë, konstatohet se në këtë llogari ka projekte për ndërtim e rikonstrukcion ujësjellësi, ndërtesa dhe rrugë e rrjete, në vlerën 36,435,713 lekë, të cilët janë trashëguar nga ish-Komunat sot Nj/Administrative të Bashkisë Gjirokastrë, për të cilat nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në përdorim dhe vlerat e tyre të sistemoheshin në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 36,435,713 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2	<b>E lartë</b>	54-74	Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësisht të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.
7	Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 162 artikuj kontabël, në vlerën 50,552,353 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 261 artikuj kontabël, në vlerën 2,019,415,999 lekë, nuk janë të analizuara sipas ndërtimeve dhe konstruksioneve apo rrugëve e rrjeteve, nuk ka informacioni për çdo objekt, në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezultojnë shtesat për rikonstrukcionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit por janë trajtuar si aktive më	<b>E lartë</b>	54-74	Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zbrëthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	vete, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30,31.			
8	Nga auditimi ka rezultuar se, nga 431 artikuj kontabël të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 31,343,317,280 lekë, Bashkia Gjirokastrë, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 , Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.	<b>E lartë</b>	54-74	Bashkia Gjirokastrë duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Gjirokastrë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.
9	Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 12 objekte variojnë nga 3,907 lekë deri në 86,215 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”.	<b>E lartë</b>	54-74	Bashkia Gjirokastrë duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.
10	Nga auditimi ka rezultuar se: <b>Bashkisë Gjirokastrë</b> , me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008 “Për miratimin e	<b>E lartë</b>	54-74	Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastrë, Cepo



Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Gjirokastrë, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 240 fletë dhe përfundon me numër rendorë 1713, <b>Njesisë Administrative Cepo</b>, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Cepo, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 83 fletë dhe përfundon me numër rendorë 612, <b>Njesisë Administrative Lazarat</b>, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lazarat, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 31 fletë dhe përfundon me numër rendorë 157, <b>Njesisë Administrative Lunxheri</b>, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lunxheri të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 701 prona, <b>Njesisë Administrative Picar</b>, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Picar të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 439 prona <b>Njesisë Administrative Antigone</b>, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Antigone të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 259 prona dhe <b>Njesisë Administrative Odrie</b>, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Odrie të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 136 prona.</p> <p>Për pronat si më sipër Sektori Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike, <b>nuk</b> ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, <b>nuk</b> janë inventarizuar, <b>nuk</b> disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.</p>			<p>dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.</p>
11	Në subjektin Bashkia Gjirokastrë për periudhën objekt auditimi 01.10.2022 deri më 31.12.2022, janë realizuar gjithsej 12 procedura me vlerë të lartë me fond limit	<b>E lartë</b>	74-91	Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike ( <i>Njësia e Prokurimit</i> ),

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>168,061 mijë lekë dhe vlerë kontrata të lidhur 139,034 mijë lekë ose 82.7% e fondit të prokuruar.</p> <p>Nga grupi i KLSH, referuar materialiteti të përcaktuar në fillim të procesit të auditimit me vlerë popullore 19,913 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim <b>4 procedura</b> me fond limit <b>145,257</b> mijë lekë ose 86.4% e fondit të prokuruar.</p> <p>Nga auditimi janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, të cilat kanë konsistuar në:</p> <p><b>a- Aplikimin e kriterëve</b> të paargumentuara dhe jo në përputhje me tipologjinë e procedurave, duke vendosur pika licence jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit dhe të përshtatur me zërat e preventivit. Janë kërkuar inxhinier ku referuar zërave të preventivit nuk kërkohet prezenca e këtyre inxhinierëve.</p> <p>Këto mangësi janë konstatuar në procedurat me objekt <i>“Rikonstruksion rruga Zhulat 1”</i>, me fond limit 48,561,521 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “E.I.” shpk me vlerë kontrate 38,296,731 lekë dhe në procedurën me objekt <i>“Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita”</i>, me fond limit 73,079,408 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE <i>“N.J.B.”</i> shpk me vlerë kontrate pa TVSh 71,217,249 lekë.</p> <p>Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Vendosja si kriter e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht cënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit <i>“Për prokurimin publik”</i>, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.</p> <p><b>b- Në vlerësimin e procedurës</b>, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi disa nga kriteret nuk plotësohen nga ana e tyre</p> <p>Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar, konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Mos deklarim të saktë të stafit inxhinjerik.</li> <li>- Mos paraqitja e kategorive të liçensave të kërkuara.</li> <li>- Mos plotësimi i kriterit me specialit të fushave elektrik, hidraulik, etj, si dhe dokumentacion bashkëzotërues argumentues.</li> <li>- Për disa nga specialistet kodi sipas listpagesës nuk përputhet me llojin e profesionit të deklaruar, konkretisht bazuar në listëpagesat FDP të ngarkuara</li> </ul>			<p>për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.</p> <p>Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Gjyrokastër në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.</p> <p>Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>ne sistem si dhe ne Strukturën e Listës Kombëtare te Profesioneve.</p> <p>Këto mangësi janë konstatuar në procedurat me objekt “Permiresimi i kushteve te banimit per komunitetet e varfëra dhe te pafavorizuara” me fond limit 12,123 mijë lekë; “Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita” me fond limit 73,074 mijë lekë dhe “Rikonstruksion rruga zhulat 1” me fond limit 48,561 mijë lekë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 <i>Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve</i> dhe 78 <i>Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit</i> dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (për kriteret), si dhe në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, <i>Parimet e përzgjedhjeje</i>, neni 98, <i>Anulimi i një procedure</i>, neni 76 <i>Kriteret detyruese për skualifikim</i>, neni 92, <i>Shqyrtimi i ofertave</i>, , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, <i>Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave</i>, neni 67, <i>Klasifikimi i ofertave</i>, neni 83, <i>Njoftimi i fituesit</i> (për vlerësimin).</p>			
12	<p>Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kushtet në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar. Gjetja e konstatuar u evidentuan në rastin e miratimit të lejes së ndërtimi, me objekt: <i>“Shtesë kati mbi objektin ekzistues në lagjen Çafkë”</i>, me vendim nr.72, datë 06.10.2022, zhvillues V.H, në adresën Rruga “Hasan Xhiku”, Nr.26. Gjirokastër.</p> <p>Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 08.02.2017, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë ZU.4.1.C, në sistemin urban, me kategorinë e lejuar banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 1.8, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 60%. Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave të treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosjen e miratuar me projektin e ndërtimit, intensiteti i ndërtimit për objektin pas shtesës së katit është 1.82 dhe jo 1.26, sipas të dhënave të pasqyruara tek planvendosjen e miratuar. Në projektin konstruktiv të paraqitur në dosjen teknike të aplikimit për leje ndërtimi konstatohet që përmasat e konstruksionit nuk përkojnë me përmasat e strukturës së projektit arkitektonik, nga 13.19 metra x 15.29 metra sipas projektit arkitektonik, në projektin konstruktiv</p>	<b>E lartë</b>	96-103	<p>Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastër të merren masa për:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rilevimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.</li> <li>- Lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.</li> <li>- Të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar që planvendosjen të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konformë kushteve teknike të projektimit.</li> </ul>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>përmasat e objektit janë 15 metra x 15.45 metra. Sipërfaqja e shtesës së objektit nga 162 m<sup>2</sup> të pasqyruar tek të dhënat e treguesve të zhvillimit, në bazë të projektit konstruktiv është 180 m<sup>2</sup>. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15, pika i dhe pika ii, në dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit është projektin arkitektonik dhe projekti konstruktiv, të cilat duhet të jenë në përputhje dhe të korrespondojnë me njëra tjetrën. Shtimi i sipërfaqes së ndërtimit nga 162 m<sup>2</sup> në 180 m<sup>2</sup> ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit nga 1.77 në 1.82 nga 1.8 e lejuar me parametrat e njësisë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit evidentohet që nuk është respektuar lartësia maksimale e lejuar e godinës në bazë të Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin Nr.1, datë 08.02.2017. Në parametrat e lejuar të njësisë ZU.4.1.C, nga 10 metra me çati deri 1.5 metra që është objekti i paraqitur në projektin e ndërtimit, objekti i miratuar zhvillohet në lartësinë 13.16 metra, në mospërputhje me kondicionet urbane të lejuara. Në raport me lejen e ndërtimit të miratuar për shtimin e katit në lartësi, sipas projektit të ndërtimit dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, objekti zhvillohet në lartësinë e 4 kateve plus çati, nga 3 kate me çati deri 1.5 m të lejuar sipas njësisë ZU.4.1.C dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin Nr.01, datë 08.02.2017. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 37, lartësia e ndërtimit, në pikën 3/b . Në bazë të projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje, ajo që përcaktohet si kat nëntokë në lejen e ndërtimit të miratuar, në bazë të legjislacionit në fuqi është i gjithë kati mbi tokë, pasi nuk është 1 metër mbi kuotën e sistemimit, por është 4 metra, në lartësinë e plotë të katit dhe aksesohet në mënyrë direkte nëpërmjet sistemimit të jashtëm perimetral. Gjithashtu duke u bazuar edhe në VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, në nenin 37, në pikën c. Tek projekti arkitektonik, tek fasada dhe prerja, evidentohet qartë lartësia e godinës, si në metra dhe në numër katesh.</p> <p>2- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“, i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Për objektin në lartësinë e 4 kateve distanca që duhet të respektohet nga kufiri i pronës duhet të jetë 5 metra. Nga verifikimi i planvendosjen së miratuar, u evidentua që nuk janë</p>			

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>respektuar distancat nga kufiri i pronës në të gjitha orjentimet. Gjithashtu nuk janë pasqyruar të gjitha përmasat ndërmjet pikave të skajeve të objektit dhe kufirit të pronës.</p> <p>3- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet numri i kateve të objektit që do të zhvillohet dhe të objekteve të tjera me të cilat kufizohet, në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, i ndryshuar, neni 15, pika c, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për “Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor, Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, Neni 38, Intensiteti i ndërtimit (I), përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.</p>			
13	<p>Nga auditimi i lejeve të zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, konkretisht:</p> <p>1.“<i>Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj</i>”, të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit “, i ndryshuar, neni 27/2, në dokumentet për pajisjen me çertifikatë përdorimi, në pikën g përcaktohet që të duhet të dorëzohet edhe projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentat e ngarkuara në sistemin e-leje, pasqyrohet vetëm projekti arkitektonik i miratuar, por nuk dokumentohet projekti “as build” i zbatuar.</p> <p>2.“Banesë dy katëshe në Humelicë - Gjirokastrë”, për të cilën është marrë vendimi nr. 94, datë 16.12.2022, me zhvillues z. D.K., në adresën Humelicë, Gjirokastrë. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit. Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së zhvillimit, konstatohet se kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhurnuara gjatë 3 muajve të fundit. Gjithashtu në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje mungon deklarata e përgjegjësisë profesionale për topografin që ka hartuar rilevimin topografik dhe mungojnë vërtetimet e statusit aktiv për hartuesit të projektit arkitektonik .</p>	<b>E lartë</b>	96-103	Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.
14	Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Çertifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e	<b>E lartë</b>	96-103	Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë, përpara miratimit të

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar me objekt: “<i>Pikë grumbullimi produkteve bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj</i>”, të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Nga verifikimi i realizimit të punimeve në terren dhe nga fotot e ngarkuara në sistemin e-leje për miratimin e çertifikatës së përdorimit, evidentohet që objekti nuk është realizuar në përputhshmëri me projektin e ndërtimit të miratuar. Në ndryshim nga projekti arkitektonik i miratuar është realizuar një rampë për aksesin e automjetit në katin përdhe, elementë i cili nuk është parashikuar gjatë lejes së ndërtimit. Gjithashtu ka ndryshuar realizimi i shkallëve për aksesin në katin e dytë, duke shtuar disa shkallë për aksesin në krahun tjetër. Ndërsa struktura me kolonat e drurit dhe brisoleit për hijëzim, nuk janë realizuar sipas projektit. Në bazë të fotove të ngarkuara në sistem, nuk pasqyrohet qartë realizimi i objektit në të gjitha orientimet dhe fasadat janë të pasqyruara në mënyrë të fragmentuara. Gjithashtu funksioni i objektit me qëllim grumbullimin e produkteve bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj nuk evidentohet.</p> <p>Në bazë të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, datë 31.7.2014, Neni 42, pika 3 dhe pika 4, çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi. Mungesa e verifikimit në terren të realizimit të punimeve të ndërtimit nga specialistët e DPZHT Gjirokastrë, përpara dhënies së çertifikatës së përdorimit, ka sjellë realizimin e objektit jo në përputhshmëri të plotë me lejen e ndërtimit të miratuar dhe me kondicionet urbane të përcaktuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.</p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42/ Çertifikata e përdorimit, pika 3 dhe pika 4.</p> <p>-Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 29, pika c, dhënien e çertifikatës së përdorimit -VKM-ja 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e</p>			<p>çertifikatës së përdorimit, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.</p>



Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve.			
15	<p>Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:</p> <p>- Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të <b>nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve</b>.</p> <p>Referuar shkresës nr. 883/13prot Prot, datë 07.06.2022 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të KLSH-së, rezultoi se <b>afati 6 muor</b> për raportimin në KLSH lidhur me zbatimin e rekomandimeve plotësohet më datë 7.6.2023. Në kushtet kur auditimi aktual korrespondon në periudhën që do të raportohet në KLSH, nuk është e nevojshme të bëhet raportimi pasi nga grupi i auditimit është pjesë e programit të auditimit edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve.</p> <p>- Bashkia Gjirokastrë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1069prot, datë 2.2.2023, <b>por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve</b>.</p> <p>- <u>Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon.</u></p> <p><b>a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative</b>, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa, në proces auditimi janë 7 masa dhe <b>nuk janë zbatuar 8 masa</b>.</p> <p><b>b. Për masa shpërblim bëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 21,107,773 lekë</b>, të pranuarat nga subjekti. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, janë në proces zbatimi <b>3</b> masa me vlerë <b>21,107,773 lekë</b>, nga e cila nuk është arkëtuar asnjë vlerë dhe nuk ka masa të pazbatuara.</p> <p><b>c. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 5 masa me vlerë 230,412 mijë lekë</b>, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 0 (zero) masa pa vlerë, janë në proces zbatimi 2 masa pa vlerë, ku nga vlera e rekomanduar prej 217,928 mijë lekë është arkëtuar vlera 15,899 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 202,029 mijë lekë . <b>Nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 12,484 mijë lekë</b>.</p> <p><b>d. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 12 masa të pranuar plotësisht dhe zbatuara nga subjekti.</b></p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan</p>	<b>E lartë</b>	107-111	Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përsheptimin e atyre në proces.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.			
16	<p>Me anë të kërkesës së z. A.B. administruar nga KLSH me nr.691 prot., datë 26.07.2023, nëpërmjet të cilës shpreh shqetësimin e tij dhe të banorëve të tjerë të cilët banojnë në rrugën “Zeman Haska”, në lagjen “Kodra e Shtufit”. Në këtë ankesë të paraqitur shkurtimisht pretendohet se miratimi i deklaratës paraprake nga Bashkia Gjirokastrë, për rrethimin e pasurisë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, në pronësi të z. P.B., ka ndërprerë aksesin për në banesat e tyre.</p> <p>Në lidhje me trajtimin e rastit të mësipërm, nga Bashkia Gjirokastrë u kërkua informacioni i nevojshëm për këtë situatë dhe dokumentacioni i shkarkuar nga sistemi e-leje. Për të verifikuar problematikën e ngritur në ankesë u shqyrtua deklarata paraprake e kryerjes së punimeve, e miratuar me vendimin nr. 65, datë 13/07/2023 nga Bashkia Gjirokastrë, për objektin “Rrethi metalik i lehtë edhe sisteme oborri”, (<i>aplikuar me kërkesën me numër identifikimi NID/NUIS FO, dorëzuar më datë 11/07/2023, me numër AN110720230031</i>), në pasurinë me nr. pasurie 8541-16/110, ZK 8541, në rrugën “Zeman Haska”, nr.26, Gjirokastrë.</p> <p>Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, u verifikua çertifikata e pronësisë për pasurinë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, me llojin e pasurisë truall, me një sipërfaqe të truallit 400 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 0 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. P.B., të lëshuar me datë 15.06.2023. <i>Ndërsa në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në pikën “c”, tek të drejtat reale përshkruhet mbi këtë truall gjendet edhe ndërtesa me numër pasurie 16/110-ND.</i></p> <p>Në planvendosjen e miratuar, pasqyrohet konturi i pronës i mbivendosur mbi gjendjen ekzistuese dhe mbi foton ajrore, në të cilën evidentohet që kufiri i pronës sipas paraqitjes <b>përfshin edhe një pjesë të infrastrukturës rrugore të rrugës “Zeman Haska”, duke kufizuar aksesin e rrugës.</b></p>	<b>E lartë</b>	111-112	Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.
17	<p>Nga auditimi i kontratës nr. 4049 prot., datë 10.05.2021 me objekt “<i>Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit Gjirokastrë</i>”, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastrë , të përfaqësuar nga Zyrtari i Autorizuar i autoritetit Kontraktor z. N.N. dhe bashkimi OE <b>N.K." ShPK</b> . Vlera e kontratës baze 28,757,171 lekë pa TVSh me afat 10 muaj. Është bere modifikim kontrate për kontrate shtese Nr. 4452 Prot date 09.05.2023 ne vlere 4,778,319 lekë pa TVSh me afat 2 muaj. Akti i kolaudimit është hartuar në datën 23.06.2023.</p> <p>Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit nga Bashkia</p>	<b>E lartë</b>	91-96	Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej <b>43,300 lekë</b> në ngarkim të <b>JV N.K." ShPK</b> , si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.



Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Gjirokastër me datë 29.06.2023, e hartuar nga grupi i punës, me përbërje Ark. J.M., ing. A.P.dhe ing. F.M. . Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se si “Ieje ndërtimi” për këtë objekt, është me nr.70 date 02.06.2021. Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “E.” ShPK.</p> <p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, punimet kanë nisur me datë 28.07.2021 dhe kanë përfunduar me datë 12.06.2023. Është bërë amendim te afatit te punimeve nr. 2902/2prot, datë 28.04.2022 , sipas të cilit janë shtyrë punimet me 6 muaj . Ky amendim e çon përfundimin e objektit me date 28.11.2022.</p> <p>Është bërë pezullimi i punimeve date 24.11.2022 nga mbikëqyrësi i punimeve protokolluar me shkrese nr. 13160 prot date 30.11.2022, për shkak të problematikave për zbatimin e punimeve deri ne miratimin e fondit shtese. -</p> <p>Fillimi i punimeve në objekt është bërë me shkresën 4516 prot date 10.05.2023</p> <p>Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve "N." me shkresën nr. 7prot, datë 24.03.2022, dhe shkrese përcjellëse te mbikëqyrësi i punimeve “E.” SHPK dhe Zyrtari i Autorizuar i autoritetit Kontraktor, për te realizuar objektin, kanë miratuar fondin rezerve ne vlerën 697,989.58 lekë pa TVSh ,ndryshime volumesh, me punime që shtohen e hiqen dhe kontrate shtese 4,778,318.64 lekë pa TVSH.</p> <p>Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librit të masave, ditarit të punimeve, projektit dhe preventivit bazë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën <b>43,300 lekë pa TVSh.</b></p> <p>Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.</p>			
18	<p>Nga auditimi i kontratës për punë publike nr. 13460 prot., datë 07.12.2022, të lidhur midis Bashkisë Gjirokastër dhe BOE "N.J." shpk &amp; “B.” shpk me objekt "Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme “Asim Zeneli”, baza prodhuese dhe shkolla “Drita”, me vlerë të kontratës 85,460,698 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh në situacionet pjesore.</p> <p>Kontrata përbëhet nga 6 situacione pjesore progresive, ku situacionet pjesore janë shoqëruar me librezë masash pjesore, por nga verifikimi faktik në objekt datë</p>	E lartë	91-96	<p>Bashkia Gjirokastër të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të zbatuara në vlerën <b>7,831,423 me TVSH</b> nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>27.07.2023, <i>nuk ishin në përputhje me realizimin e punimeve</i>, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu II, pika 8.1; "Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave".</p> <p>Në dosjen teknike administrohet preventiv i rishikuar, tabela e lëvizjes së volumeve por nuk disponohen librezat e masave. Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, referuar Situacionit pjesor progresiv nr. 5 deri më date 31.03.2023, dhe verifikimit në objekt datë 27.07.2023 në prezencë të specialistit të IKMT, u konstatua se sipërmarrësi kishte punime të përfunduar. Punimet e përfunduar janë: Fv dyer brendshme druri importi cilësi I-re, Fv dyer d/alumini plastike me dopio xham (tualetet), Fugatim muri guri brendshëm, Fugatim muri guri i jashtëm, Lyerje me llak e sipërfaqes së murit të gurit, Shtresë mikroçiment me ngjyrë për shtrimin e galerisë, Tavan Kartonxhes, Dritare d/alumini plastike me dopio xham, Dyer të brendshme druri, Patinim muri, Punimet e instalimit elektrike, ndriçues, spote, çelësa, priza etj në vlerën prej 6,526,186 lekë pa tvsh ose <b>7,831,423 lekë me TVSH</b>, duke përfituar padrejtësisht fonde publike të përfunduar.</p>			së punimeve të likujduara por të përfunduar.
19	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI Gjyrokastër janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuar për regjistrim në ASHK Gjyrokastër, për periudhën deri më 31.12.2022, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 84 persona për vlerën 1,854,317 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë, nga Drejtoria Urbanistikës Bashkisë Gjyrokastër, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për</p>	<b>E lartë</b>	49-54	Bashkia Gjyrokastër, Drejtoria Planifikim Zhvillim Teritori, të marrë masa që të dërgohen në Drejtorin e Financës për kontabilizim, listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 84 persona me vlerë <b>1,854,317 lekë</b> .

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- <i>Taksa e ndikimit në infrastrukturë</i> , pika 3, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,854,317 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “ <b>dh</b> ” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale të dhënat sipas pasqyrës Aneks nr.2/5 bashkëlidhur.			
20	Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e tokave bujqësore të pandara, për kontratat e vitit 2022 e para, u konstatua se 24 fermer, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, <b>në vlerën 1,072,105 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastër</b> , nga Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,072,105 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “ <b>g</b> ”, neni 22, pika 3, germa “ <b>dh</b> ” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale të dhënat sipas pasqyrës Aneks nr.2/6 bashkëlidhur.	<b>E lartë</b>	49-54	Bashkia Gjirokastër, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës <b>1,072,105 lekë</b> .
21	Nga auditimi i veprimtarisë së IMT Bashkia Gjirokastër për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022, <i>rezulton se:</i> - IMTV nuk ka në strukturën e saj punonjës me profil arsimimi teknik si ing. ndërtimi, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj, profile të cilat janë të specializuar në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, gjë e cila do të rriste dhe përmirësonte rendimentin e IMTV, duke mbrojtur kështu territorin nga ndërhyrjet abuzive, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”. - Nga ballafaqimi i blloqeve të vendimeve dhe konstatimeve të mbajtura nga IMTV Gjirokastër, vihen re se ka parregullsi të ndryshme, si mungesa e proces verbaleve të konstatimit të kundërvajtjes, vendimeve për pezullim, prishje, masë gjobe, në përputhje me <b>Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”</b> , Neni 5, pika b), ç), d), Nenin 12 dhe 13. - Për gjobat e vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk	<b>E lartë</b>	103-106	Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të marrë masa për ristrukturimin e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit me personel të kualifikuar arsimorë sipas deponitave ligjore. IMTV Gjirokastër të marrë masa për: - Kryerjen e kontrolleve në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga Kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike. - Të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik. - Marrjen e masave për arkëtimin e penaliteti në masën 2% per çdo ditë vonesë në shumën 900,000 lekë ndajë <b>2</b> subjekteve të cilat nuk kanë likuiduar në afat, respektivisht: “ <b>E.H.</b> ” në shumën <b>300,000 lekë</b> dhe subjektin “ <b>M.C.</b> ” në shumën

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV nuk ka ndjekur hapat e parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë, si dhe nuk janë llogaritur kamatëvonesat në shumën <b>900,000 lekë, si mungesë të ardhurash.</b></p> <p>- IMTV Gjirokastër nuk ka kërkuar në asnjë rast heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, për rastet e ndërtimit të kundërligjshëm, siç parashikohet në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 5, pika c), si dhe Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 5. Ky veprim ndëshkohet sipas përcaktimeve të Nenit 15, pika 7, të po këtij ligji.</p> <p>- Nuk është respektuar afati 10 ditor për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, pasi është mbajtur proces verbali i konstatimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 13. Ky veprim ndëshkohet sipas përcaktimeve të Nenit 15, pika 3, të po këtij ligji.</p> <p>- Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në <b>Ligjin 107/2014</b>, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave.</p> <p>- Për periudhën nën auditim nga IMTV nuk u paraqitën akte kontrolli të miratuara nga Kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipër cituara dhe detyrat e Kryeinspektorit dhe inspektorëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Gjirokastër.</p> <p>- Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, IMTV Gjirokastër ka për detyrë të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacion periodik çdo tre muaj për masat e marra</p>			<p><b>600,000 lekë.</b></p> <p>- Për të gjitha rastet e shkeljeve të lejes së ndërtimit të kërkohet heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë.</p> <p>- Të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	dhe nuk ka raportuar në IKMT në kundërshtim me përcaktimet ligjore sipërcituar.			
22	<p>Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, Bashkia Gjirokastrë konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë <b>1032</b> subjekte në vlerën <b>70,197,983 lekë</b>, <b>64</b> subjekte për qira objekte të tregut në vlerën <b>2,526,000 lekë</b> dhe <b>11,345</b> familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën <b>108,289,000 lekë</b> për të cilat edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 1032 subjekte debitorë në vlerën 70,197,983 lekë, janë aktiv 591 subjekte ose 57 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksat dhe tarifa, në vlerën 45,033,000 lekë ose 64 % e vlerës së debitorëve.</p> <p>-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimit të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar.</p>	<b>E lartë</b>	49-54	Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore në fund të periudhës në vlerën <b>181,012,983 lekë</b> .

## I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit.

- Nga auditimi i pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2022, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një “**Opinion të modifikuar, me rezervë**”, pasi kemi marrë evidenca të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit arrijmë në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë përmbledhëse vjetore të konsoliduar të vitin 2022.

- Në auditimin e përputhshmërisë në fushën e shpenzimeve operative (602), investimeve (231), të fondit të pagave (601) dhe menaxhimit e të ardhurave nga taksat e tarifat vendore, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord, mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Gjirokastrë bazuar në analizën e riskut, janë konstatuar disa anomali materiale por jo të përhapura, që janë baza për dhënien e një “**Opinion të modifikuar**”, pasi:

-Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, rezultuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore në aplikimin e kriterëve të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, si dhe shkelje në shpalljen fitues të OE, jo në kushtet plotësisht të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK dhe në përputhje me dispozitat e LPP.

-Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, si dhe personat që kanë kontratë qiraje, leje legalizimi për ndërtim pa leje, nuk është ndjekur e plotë procedura për arkëtimin e debitorëve në vlerën 183,939 mijë lekë.

- Në fushën e zbatimit të kontratave për vlerën 7,831,423 lekë.

## OPINIONI I AUDITIMIT

### **I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Gjirokastrë për periudhën ushtrimore 01.01.2022 – 31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Gjirokastrë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar, me rezervë**", e shprehur kjo në bazën për opinionin.*

### **Baza për opinion e modifikuar, me rezervë :**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>-të</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Njësia shpenzuese Bashkia Gjirokastrë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (ISA 700-ISSAI 1700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura (ISA 705-ISSAI 1705). Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 është 19,913 mijë lekë.

### **Përshkrimi i çështjeve:**

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë faktin se:

-Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 468 "Debitorë të ndryshëm" është pasqyruar më pak për vlerën 59,718,570lekë, pasi në fund të vitit nuk janë kontabilizuar detyrimi i plotë për taksa e tarifa vendore, detyrimet për qira objekti, detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve dhe detyrimet për qira tokë bujqësore.

-Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", nuk kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" për vlerën 275,277,960 lekë.

-Nga auditimi ka rezultuar se në llogarinë 202 "Studime dhe projekte", vlera prej 36,435,713 lekë e trashëguar nga ish Komunitat sot Njësitë Administrative, janë të paanalizuara dhe nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në zbatim.

-Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 212 "Ndërtesa Konstruksione" dhe llogaria 213 "Rrugë rrjete vepra ujore", shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit, me ndikim në inventarin fizik dhe informacionin kontabël.

## **II. Opinion i auditimit mbi përputshmërinë:**

Ne audituam përputshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Gjirokastrë për periudhën 01.10.2022 deri më 31.12.2022, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat ky projekt realizon qëllimin e tij, në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Gjirokastrë.

Pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, në përfundim rezultuan devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, efektet e të cilave janë *materiale por jo të përhapura*, të cilave justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**.

*“Ne opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Gjirokastrë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar, e shprehur kjo në bazën për opinion.*

### **Baza për opinionin:**

- Në auditimin e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, rezultuan shkelje të akteve ligjore e nënligjore në aplikimin e kriterëve të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, si dhe shkelje në shpalljen fitues të OE, jo në kushtet plotësimi të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK dhe në përputhje me dispozitat e LPP.

#### **Gjithashtu:**

-Në administrimin e të ardhurave vendore nga subjektet fizik/juridik dhe abonentët familjare, si dhe personat që kanë kontratë qiraje, leje legalizimi për ndërtim pa leje, nuk është ndjekur e plotë procedura për arkëtimin e debitorëve në vlerën 183,939 mijë lekë.

- Në fushën e zbatimit të kontratave për vlerën 7,831,423 lekë.

### **Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Gjirokastrë:**

Strukturat drejtuese të subjekti Bashkia Gjirokastrë, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara në procedurat e prokurimit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

### **Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH:**

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë



e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

## II. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 519/1, datë 20.06.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 26.06.2023 deri në datë 28.07.2023, në subjektin Bashkia Gjirokastrë, për auditimin financiarë për periudhën nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022 dhe për auditimin përputhshmërie për periudhën nga 01.10.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi me objekt “*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmërie*” nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. P.Gj., *Përgjegjës Grupi*
2. K. Gj., *anëtarë,*
3. M. M., *anëtarë,*
4. A. K., *anëtarë,*

### a- Objektivat dhe qëllimi i auditimit:

Objektivi i auditimit financiar është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

#### • *Objektivat e auditimit* synojnë:

Për auditimin **financiar**, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për auditimin e **përputhshmërisë**, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim. Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Dhënien e vlerësimeve të pavarura mbi funksionimin e sistemeve dhe nënsistemeve të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të menaxhimit financiar të subjektit, nëpërmjet përcaktimit nga ana e Audituesve:

-Nëse pasqyrat financiare janë hartuar në përputhje me rregullat dhe ligjet e kontabilitetit;

-Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar të sektorit publik dhe të sjelljes me integritet të zyrtarëve të sektorit publik;

-Nëse të ardhurat dhe shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

-Verifikimin e përgjegjësisë financiare të subjekteve përgjegjëse, nëpërmjet ekzaminimit dhe vlerësimit të të dhënave financiare;

- Auditimin e sistemeve financiare dhe transaksionet, duke përfshirë edhe vlerësimin e përputhshmërisë me ligjet dhe rregulloret.

**b- Procedura e ndjekur:** Raporti Auditimit i dërgohet subjektit Bashkia Gjirokastrë, pasi nga subjekti i audituar me shkresën nr. 9115, datë 27.09.2023 (*prot KLSH nr. 519/4, datë*



29.09.2023), është kthyer Projekt Raporti i Auditimit me observacione, i cili është dërguar në subjekt me shkresën nr. 519/3, datë 28.08.2023. Gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, gjejnë pasqyrim në këtë Raport Auditim, i cili i përcillet subjekti për zbatim dhe përmisimin e gjendjes në të ardhmen, referuar kjo dhe rekomandimeve të KLSH të reflektuara në fund të raportit.

**c- Identifikimi i çështjes:** Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësitë të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Gjirokastrë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre. Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiarë në fuqi.

**d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim (në vartësi të llojit të auditimit).**

Strukturat drejtuese të Bashkisë Gjirokastrë janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare dhe në të njëjtën kohë janë përgjegjës për aktivitetin financiar të Bashkisë në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për planifikimin, zhvillimin dhe mbrojtjen e territorit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditim e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

**e- Përgjegjësitë e Audituesve.** Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare të Bashkisë Gjirokastrë dhe një opinion në lidhje me përputhshmërinë në lidhje me aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimin. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

**f- Kriteret e vlerësimit.**

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- ✓ Rregullore e Brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e brendshme “Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi “Auditimin e përputhshmërisë”, Manualët e Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;
- ✓ Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020 “Për buxhetin e vitit 2021” dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”;

- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, “Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, date 28.12.2006”;
- ✓ Udhëzimi i MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”; etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.

#### **g- Standardet e auditimit:**

- Auditimi është kryer sipas standardeve ndërkombëtare të auditimit të hartuara nga INTOSAI.
- ISSAI 100 “*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*” që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
  - ISSAI 400 “*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*” që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
  - ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200;
  - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
  - Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.
  - Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”; etj.

**h- Dokumentimi i rezultateve të auditimit:** Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatorë, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

**I- Praktikrat e ndjekura në kryerjen e auditimit.** Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale. Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t’u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e

materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231).

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH aplikon<sup>1</sup>.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve ne regjistra/ ditarë/ partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/ procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

## **k- Metodatat dhe Teknikat e Kontrollit të përdorura nga audituesit gjatë auditimit:**

### 1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*)

### 2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*) konstatoi se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”.

### 3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

### 4. Kontrolli i vlerësimit.

<sup>1</sup> Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm \* Risku i kontrollit \* Risku i Zbulimit

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

#### 5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtuar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

#### 6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

#### 7. Intervistimi

#### 8. Raporte dhe Informacione

#### 9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

- **Metoda e Auditimit:** Auditim mbi bazë risku.

### **III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT**

#### **1. Informacioni i Përgjithshëm:**

Auditimi në Bashkinë Gjirokastrë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *materiale po jo të përhapura*, si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi, në fushën e prokurimeve dhe menaxhimit të të ardhurave, *materiale po jo të përhapura*.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, të reflektuara në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve.

Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar dhe paraqitur nga subjektit, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP, për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Gjirokastrë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes Vendore”, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Gjirokastrë.

#### 1. Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Gjirokastra është qytet në Shqipërinë jugore. Qytet i përfshirë në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO-s më 2005, si një nga pak shembujt e mbijetuar në Ballkan, të qyteteve tregtare të stilit osman.

Gjirokastra është e vendosur në faqen e Malit të Gjerë, në shpatet verilindore të tij dhe në krahun e majtë të luginës së lumit Drino. Rrëza dhe faqja e malit ku ndodhet është pothuajse e zhveshur, pa bimësi. Duke qenë e tillë, në dimër kur rreshjet janë të shumta, nëpër pjerrësi lëshohen përrenj të rrëmbyer me ujëra të shumta. Ato vijnë deri në qytet. Vetë qyteti ka shumë përrenj dhe çdo lagje ndahet nga njëra-tjetra me një të tillë. Gjirokastra ka qenë dhe vazhdon të mbetet një nga qendrat kryesore të pjesës jugore të Shqipërisë. Ajo ka pasur lidhje jugore me Janinën, me bregdetin shqiptar, Vlorën dhe pellgun e Delvinës. Nëpërmjet grykës së Këlcyrës lidhet me qendra të tjera të Shqipërisë jugore. Është e lidhur gjithashtu me Kurveleshin e Sipërm dhe të Poshtëm, Lunxhërinë, Dropullin e Poshtëm, Pogonin, Zagorinë etj. Mali i Gjerë në rrëzë të së cilit është vendosur Gjirokastra, e ndan qytetin nga bregdeti.

Nga veriu qyteti Gjirokastër kufizohet me fshatin Mashkullorë, nga jugu me Lazaratin, nga lindja me lumin Drino dhe me fshatrat e Lunxhërisë dhe nga perëndimi me Malin e Gjerë. Gjirokastër ka këto lagje: Cfake, Dunavat i I-rë, Dunavat i II-të, Hazmurat, Manalat i I-rë, Manalat i II-të, Meçite, Palorto, Pazar i Vjetër, Pllakë, Teqe, Varosh, Zinxhire.

#### **Parimet e auditimit financiar:**

Në punën tonë jemi mbështetur në parimet e mëposhtme:

*Etika dhe pavarësia;*

*Kontrolli i cilësisë*

*Menaxhimi i grupit të auditimit dhe aftësive të tyre*

*Parimet lidhur me konceptet bazë të auditimit.*

#### **Pohimet rreth klasave të transaksioneve dhe ngjarjeve për periudhën nën auditim:**

*Përkatësia:* Transaksionet dhe ngjarjet që janë të regjistruara kanë ndodhur dhe i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha transaksionet dhe ngjarjet që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Saktësia:* Shumat dhe të dhëna të tjera lidhur me transaksionet e regjistruara dhe ngjarjet janë regjistruar në mënyrë të përshtatshme.

*Periudha:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në periudhën e saktë kontabël.

*Klasifikimi:* Transaksionet dhe ngjarjet janë regjistruar në llogaritë e duhura.

*Ligjshmëria dhe rregullsia:* Janë në përputhje me ndarjet buxhetore në dispozicion.

#### **Pohimet rreth gjendjeve të llogarive në fund të periudhës**

*Ekzistenca:* asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto ekzistojnë.

*Të drejtat dhe detyrimet:* Subjekti mban ose kontrollon të drejtat për asetet, detyrimet dhe janë obligimet e subjektit.

*Plotësia:* Të gjitha asetet, detyrimet dhe interesat e kapitalit neto që duhet të ishin regjistruar janë regjistruar.

*Vlerësimi dhe alokimi:* Aktivët, pasivët dhe interesat e kapitali janë të përfshira në pasqyrat financiare dhe shumat përkatëse dhe ndonjë vlerësim ose alokim, rregullimet që rezultojnë janë të regjistruara.

#### **- Pohimet rreth prezantimit të shënimeve shpjeguese.**

*Transaksionet, të drejtat dhe detyrimet:* Ngjarjet e shpalosura, transaksionet, si dhe çështje të tjera që kanë ndodhur i përkasin subjektit.

*Plotësia:* Te gjitha informacionet shpjeguese që duhet të ishin përfshirë në pasqyrat financiare janë përfshirë.

*Klasifikimi dhe kuptueshmëria:* Informacioni financiar është paraqitur në mënyrë të përshtatshme dhe të përshkruara dhe shënimet e kanë shprehur qartë.

*Saktësia dhe vlerësimi*: Informacioni financiar dhe të tjera është dhënë në mënyrë të drejtë dhe në sasi të duhur.

- **Objekti i këtij auditimi**, është raportimi financiar dhe paraqitja e drejtë dhe e sinqertë e pasqyrave financiare për vitin 2022. Gjithashtu, sipas programit të auditimit, objekt i këtij auditimi është edhe vlerësimi i përputhshmërisë së aktivitetit të subjektit të audituar me kriteret e vlerësimit në procedurat e prokurimit dhe menaxhimit e të ardhurave nga taksat/tarifat vendore.

- **Qëllimi i auditimit**, është dhënia e opinionit dhe hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrin ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit e njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (**ISSAI 1315**)<sup>2</sup>.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të **ISSAI 1700**, ne synojmë të japim një opinion mbi pasqyrat financiare bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

- **Fushëveprimi i këtij auditimi**, përfshin të gjithë aktivitetin e Bashkisë. Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, duke vlerësuar evidencat e grumbulluara përse i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditimit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditimi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditim besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Gjirokastër.

- **Misioni**, për njësinë që auditohet është kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (*të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin*).

- **Objektivat**, burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.*

Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.

<sup>2</sup>Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

Organi përfaqësues i Bashkisë është Këshilli Bashkiak.

Organi ekzekutiv i Bashkisë është Kryetari i Bashkisë

Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor: krijon, mbledh të ardhura dhe bën shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre, vendos taksa e tarifa për shërbimet si dhe nivelin e tyre në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe interesat e bashkësisë, harton, miraton dhe ndjek zbatimin e buxhetit të tyre.

Bashkia kryen funksione të veta, të përbashkëta dhe funksione të deleguara.

## **2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të pikave të programit të auditimit nr. 519/1, datë 20.06.2023.**

### **Pika 1.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditim e brendshëm.**

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor dhe shpeshësia e këtyre raporteve, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shpresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori, si dhe në nivel institucioni dhe në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre në punë.

**Kriteri:** Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II “Rolet dhe aktorët në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, pika 2.2.6 “Grupi i menaxhimit strategjik”, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, Kapitulli III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, hapi 5.

**Ndikimi/Efekti:** Mos njohja e plotë si dhe sa duhet e koncepteve të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

**Shkaku:** Mungesa e trajnimeve të dedikuara për të gjithë stafin menaxhues në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit financiar.

**Rëndësia:** E lartë.

**1.1. Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mbahet ky aktkonstatim me :** z. F.G.me detyrë Kryetar i Bashkisë në cilësinë e nëpunësit autorizues, znj. A.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së

*Financës në cilësinë e nëpunësit zbatues dhe znj. E.LL. në cilësinë Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatori i Riskut për vitin 2022.*

**Më hollësisht rezultatet e auditimit paraqiten si më poshtë:**

Identifikimin dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK: Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi, Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të institucionit.
2. Urdhrat për caktimin e nëpunësit autorizues dhe nëpunësit zbatues.
3. Kod sjellje, etike ose udhëzim mbi zbatimin e etikës.
4. Urdhrat për caktimin e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit strategjik.
5. Deklaratën e cilësisë të dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar dhe Publik në Ministrinë e Financave.
6. Pyetësorë të vetëvlerësimit të dorëzuar pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Kontrollit të Brendshëm Financiar Publik në Ministrinë e Financave.
7. Dokumentacion tjetër mbështetës.

**Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:**

Auditimi u krye në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, akteve ligjore e nënligjore të dala në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë, kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike si dhe ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- i. Pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- ii. Informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- iii. Mbrojtjes së informacionit e të aktiveve;

Referuar të dhënave të paraqitura në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Gjirokastër si dhe duke u bazuar në përgjigjet e pyetësorit, më poshtë paraqesim punën e bërë nga ky institucion dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të MFK-së nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testimeve të kryera, tregon se aspektet e MFK-së kuptohen dhe funksionojnë jo mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë pavarësisht përpjekjeve të këtij institucioni për të shkuar drejt konsolidimit.

Konkluzioni në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në mënyrë të detajuar argumentohen si më poshtë:

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

**1- Mjedisi i kontrollit** Në zbatim të kërkesave të nenit 20 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar“ rezultoi se:

Nga Bashkia Gjirokastër nuk disponohet Kodi i Etikës por në nenet 20 “Etika për punonjësit e Bashkisë Gjirokastër dhe Kodi i Veshjes” të secilës Rregullore të Brendshme të miratuar me Vendimin nr. 68, datë 04.08.2022, të Kryetarit të Bashkisë janë të përfshirë rregulla të etikës në të cilat përcaktohen dhe rastet e konfliktit të interesit për zbatim nga stafi i punonjësve të bashkisë gjatë veprimtarisë në këtë institucion.



Për sa i përket programeve të trajnimit dhe përmirësimit të anës profesionale, të punonjësve në Bashkinë Gjirokastrë rezultojnë se nuk janë përfshirë në programe trajnimi specifike sipas natyrës dhe legjislacionit që i përket detyrave funksionale që ato mbulojnë.

Në lidhje me ankesat dhe kërkesat e ndryshme të paraqitura pranë Bashkisë, ato regjistrohen pranë Zyrës së Protokollit të institucionit me një ndalesë, nga ku më pas bëhen raportimet e nevojshme në drejtoritë përkatëse dhe dhënia e përgjigjeve sipas afateve të përcaktuara, në përputhje me Ligjin nr. 119/2014, datë 18.09.2014, “Për të drejtën e informimit” dhe Urdhrin e Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale “Për miratimin e programit model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore”.

Referuar Ligjit nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, VKM nr. 109, datë 26.02.2014, “Për vlerësimin e rezultateve në punë” si dhe Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, çdo drejtori ka kryer vlerësimin e punonjësve të saj 6 muajor dhe vjetor, vlerësim i cili nënshkruhet nga zyrtari përgjegjës, nëpunësi përkatës si dhe zyrtari i autorizuar.

Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësive mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë të përcaktuara në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë të saj.

Në Rregulloren e Brendshme është përcaktuar mënyra e hartimit, miratimi, ndjekja e raportimi i realizimit të planeve mujore nga Drejtorët në Aparatin e Bashkisë, Administratorët e NJA si dhe Drejtorët e Njësive të Varësisë drejtuar Nënkrjetarëve të bashkisë sipas fushave që ato mbulojnë.

Titullari merr opinione për performancën e institucionit dhe funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm nga Auditi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë audituese, Njësia e Harmonizimit në MFE.

Këshilli Bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së Bashkisë.

Është hartuar dhe miratuar deklarata e misionit dhe dokumenti i PBA, por këto nuk janë përfshirë në rregulloren e brendshme. Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, si dhe plan veprimeve të menaxhimit të financave, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse. Referuara të dhënave të paraqitura nga pyetëtori, në hartimin e planit strategjik, konfirmohet se kanë marrë pjesë drejtorët e drejtorive dhe të sektorëve (menaxherët e programeve), për të cilat nuk disponohen procesverbale të takimeve të tyre, me palët e treta si me grupet e interesit, si dhe për dëgjesa me publikun.

Mënyra e informimit të stafit punonjës me rregulloren e brendshme, është kryer me metodën shkresore dhe elektronike.

-Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 24.12.2021 me numër 617 punonjës ku konstatohet se nuk ka tejkalime të saj.

Nëpunësit e Bashkisë Gjirokastrë i rregullojnë marrëdhëniet e punës në nivel drejtorie, përgjegjës sektori apo specialist me Ligjin nr. 152/2013, datë 17.10.2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të tij, për sa i përket punonjësve administrativ dhe terrenit i rregullojnë marrëdhëniet e punës me Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

Referuar Kreut II, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, ku përcaktuar që:

- Një procedurë transparente për rekrutim;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi;

➤ Një sistem për vlerësimin e performancës;

Në rregulloren e brendshme të institucionit për punonjësit të cilët i rregullojnë marrëdhëniet me Kod Pune nuk është përcaktuar mënyra e rekrutimit të tyre si dhe nuk janë përcaktuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen/rekrutimin në pozicionet e lira.

Mbi politikat dhe praktikën e ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregulloren e brendshme të institucionit janë përcaktuar detyrat sipas drejtorive dhe sektorëve si dhe ka një ndarje detyrash dhe përgjegjësish deri në nivel përgjegjës sektori dhe specialisti.

Çdo titullar i njësisë publike duhet të krijojë Grupin e Menaxhimit Strategjik, (në vijim GMS) me pjesëmarrjen e nivelit menaxherial ekzistues të njësisë. GMS është një element integral i përgjegjshmërisë dhe qeverisjes publike, si dhe luan një rol kyç për integritetin të informacionit financiar të njësisë publike, sistemit të saj të kontrollit të brendshëm, si dhe sjelljes etike. Ai ofron mbështetje dhe këshilla për titullarin e njësisë si dhe përkujdeset për performancën e njësisë publike.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Me Urdhrin nr. 169, datë 11.03.2022, të Kryetarit të Bashkisë është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik për vitet 2022-2023 i përbërë nga 13 punonjës në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, germa "b", neni 24, pika 2.

-Duke u bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion ky grup (GMS) nuk është mbledhur për hartimin e planit strategjik dhe PBA-së, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 8, pika 8, germa "b", neni 27, pikat 1-2, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, pika 2.2.6, dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike", pika 2.2.4, nën pikat 1-5.

-Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, kanë të drejtë të delegojnë disa nga të drejtat dhe detyrat e tyre. Nga Bashkia Gjirokastrë nuk ka rregullave të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, neni 15, pikat 1-4, dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli II, "Delegimi i detyrave".

**2- Menaxhimi i riskut.** Në zbatim të kërkesave të nenit 21 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar rezultoi se:

Menaxhimi i riskut përfshin identifikimin, vlerësimin, kontrollin dhe monitorimin e këtyre ngjarjeve të mundshme apo situatave që mund të kenë një efekt negativ në arritjen e objektivave të njësisë dhe është projektuar për të dhënë siguri të arsyeshme se objektivat do të arrihen.

Titullari i njësisë publike është përgjegjës për zhvillimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e riskut brenda njësisë së tij. Analizimin dhe rifreskimin e kontrolleve që synojnë minimizimin e riskut, sipas strategjisë së riskut.

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatori i Riskut është kompetencë e cila është deleguar nga Kryetari i Bashkisë për vitin 2022 sipas Urdhrit nr. 169, datë 11.03.2022, znj. E.LL.. Bashkia Gjirokastrë nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk

është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 21, pika 2, si dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II, pika 2.5.2, “Menaxhimi i riskut”.

**3-Veprimtaritë e kontrollit** Në zbatim të kërkesave të nenit 22 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar rezultoi se:

Sistemi me dy firma është një procedurë e cila kryhet për të vërtetuar saktësinë e të dhënave të përfshira në dokument. Detyrimet financiare si nënshkrimi i kontratave, urdhër-shërbimet dhe kryerja e pagesave, sistemi i firmës së dyfishtë jep garancinë se marrja përsipër e detyrimit financiar apo pagesa bëhet nga personi i autorizuar dhe se nuk ka shkelje të disiplinës financiare për pagesa.

Qëllimi i kësaj procedure është të garantojë se personi përgjegjës për regjistrimet në kontabilitet është i informuar për detyrimin financiar që do të merret përsipër apo që do të paguhet dhe do të kryejë saktë veprimet e kontabilitetit.

Likuidimet e transaksioneve nënshkruhen nga nëpunësi autorizues z. F.G. me detyrë Kryetar i Bashkisë dhe nëpunësi zbatues znj. A.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës të cilët janë konfirmuar nga MFE për autorizimin/kryerjen e veprimeve me Degën e Thesarit Gjyrokastër konkretisht sipas shkresës nr. 14794/1 prot., datë 15.08.2019, dhe rikonfirmuar me email-in e datës 05.08.2019, dhe shkresën nr. 4908/1 prot., datë 12.04.2017.

Gjurma e auditimit është një instrument menaxhimi që mundëson nga njëra anë ndjekjen e ecurisë së një procesi nga fillimi në fund dhe në anën tjetër, ndjekjen e ecurisë së këtij procesi përgjatë strukturave të njësisë, apo ndërmjet vetë njësisë dhe institucioneve të jashtme.

Përveç kësaj gjurma e auditimit jep informacione për të rindërtuar transaksione dhe operacione të veçanta në kuadër të një procesi të caktuar si dhe për t'i verifikuar këto transaksione dhe operacione.

Titullarët e njërive publike miratojnë gjurmët e auditimit për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurmëve të auditimit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditimit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Duke u bazuar në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016, “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” përcaktohet se, “Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës.

Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuar të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit: Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës”.

-Për periudhën objekt auditimi Bashkia Gjyrokastër nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar gjurmët e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet, veprime këto në kundërshtim Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 16, pika 2-3 dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III, “Procesi i implementimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, hapi 5.

Titullarët e njësive kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi. Procedurat antikorrupsion, përfshijnë:

- Kontrollat parandaluese;
- Një sistem për investigim të brendshëm të paralajmërimeve të hershme për korrupsion, mashtrime dhe parregullsi;
- Një sistem për zbulimin e mashtrimeve dhe parregullsive;
- Një sistem për raportimin e parregullsive të gjetura, që duhet të përshkruajë qartësisht linjën e brendshme dhe të jashtme të raportimit, pa rënë ndesh me të drejtën kushtetuese të individit;
- Procedurat e sinjalizimit;

-Bashkia Gjirokastrë nuk ka procedura të përcaktuara anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Gjirokastrë nuk ka procedurë të veçantë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave për analizën e tyre, identifikimin e shkaqeve dhe për eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

**4- Informacioni dhe komunikimi** Në zbatim të kërkesave të nenit 23 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar“ rezultoi se:

Titullarët e njësive publike miratojnë dhe vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që sigurojnë:

- Identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e një informacioni të vërtetë dhe të besueshëm në një format të përshtatshëm, brenda afateve të duhura, duke bërë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë përkatëse.
- Një komunikim efektiv, si vertikal, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë së njësisë.
- Ngritjen dhe zhvillimin e një sistemi të përshtatshëm të informacionit për menaxhimin e njësisë që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe urdhrave të qartë dhe të saktë për rolet e çdo punonjësi të përfshirë në menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Ngritjen e një sistemi për dokumentimin dhe qarkullimin e dokumenteve, që përmbajnë rregullat për përgatitjen, formatimin, lëvizjen, përdorimin dhe arkivimin e dokumenteve, në bazë të rregullave të nxjerra nga Ministri i Financave.
- Dokumentimin e të gjitha këtyre veprimtarive, proceseve dhe transaksioneve, me qëllim që të sigurohet gjurma e duhur e auditimit për vijueshmërinë dhe monitorimin.

Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet.

Menaxhimit duhet t’i jepen raporte të nevojshme mbi performancën (përmbushjen e detyrave) e njësisë në raport me objektivat e caktuara, për të bërë të mundur që ata të marrin përsipër përgjegjësitë e tyre me efikasitet dhe efektivitet.

Zhvillimi ose rishikimi i sistemeve të informacionit duhet të bazohet në një plan strategjik për sistemet e informacionit të lidhur me strategjinë e njësisë dhe që ti përgjigjet përmbushjes së objektivave si në nivel aktiviteti ashtu edhe objektivave të përgjithshme të mbarë njësisë publike. Mbështetja e menaxhimit për zhvillimin e sistemeve të nevojshme të informacionit duhet të shfaqet me angazhimin e burimeve të përshtatshme njerëzore dhe financiare. Informacioni është i dobishëm vetëm nëse arrin në kohën e duhur, përmban hollësi të mjaftueshme dhe është i përshtatshëm për përdoruesin.

Shkëmbimi i informacionit në Bashkinë Gjirokastrë dhe kanalet e komunikimit të institucionit, si horizontalisht ashtu dhe vertikalisht, funksionojnë, sipas nivelit të hierarkisë në mënyrë shkresore dhe elektronike. Sistemi aktual i komunikimit të institucionit ka nevojë për përmirësim, pavarësisht se informacioni është i mjaftueshëm për zbatimin e detyrave.

**5- Monitorimi** Në zbatim të kërkesave të nenit 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar“ rezultoi se:

Kontrolli i brendshëm mbulon vlerësimin e efektivitetit të sistemeve të kontrollit të brendshëm. Sistemi dhe komponentët e tij të veçantë mund të vlerësohen nëpërmjet procesit të vazhdueshëm të monitorimit dhe nëpërmjet një sistemi vlerësimesh të shkëputura.

Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon monitorim të vazhdueshëm për të mundësuar vlerësimin sa më të mirë të funksionimit të këtij sistemi, për të bërë përditësimet në kohën e duhur në rast të ndryshimit të rrethanave dhe mënyrave të operacioneve, si dhe për të identifikuar masat që synojnë një zhvillim të vazhdueshëm të sistemit.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten eficientë me kalimin e kohës.

Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: monitorimit të vazhdueshëm, vetëvlerësimit, Auditit të Brendshëm.

Procedura nëpërmjet vetëvlerësimit, një përdorues i buxhetit ka nevojë për të përcaktuar nëse ka apo jo një sistem të përshtatshëm të menaxhimit financiar dhe kontrollit, me rregullat dhe procedurat që sigurojnë se operacionet janë duke u kryer rregullisht, në mënyrë etike, ekonomike, efikase dhe efektive.

Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit bëhet duke plotësuar pyetësonin e vetëvlerësimit. Çdo nëpunës autorizues për çdo vit duhet të përgatisë një deklaratë “Deklarata për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në të cilën ai do të deklarojë se si sistemi i kontrollit të brendshëm mbështet arritjen e politikave të njësisë, qëllimeve dhe objektivave, ndërsa ruan fondet publike dhe pasurinë e njësisë ekonomike. Kjo deklaratë duhet të mbulojë vitin financiar paraardhës.

Në deklaratë, nëpunësi autorizues i njësisë publike duhet të përshkruajë dobësitë e sistemit të kontrollit dhe planet për trajtimin e tyre. Me nënshkrimin e deklaratës, drejtuesi i njësisë merr përgjegjësinë për vërtetësinë e informacionit të deklaruar.

Qëllimi i kësaj deklarate është për të rritur llogaridhënien e menaxhimit dhe për të inkurajuar përpjekjet për përmirësime në sistemin e kontrollit të brendshëm. Raporti vjetor i cilësisë dhe gjendjes së sistemeve të kontrollit të brendshëm. Çdo vit, nëpunësi autorizues i çdo njësie publike duhet të kryejë një vetëvlerësim mbi gjendjen dhe cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm të njësisë, dhe të paraqesë një raport mbi gjetjet e këtij vetëvlerësimi te nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave.

Me shkresën nr. 2029 prot., datë 28.02.2023, nga Bashkia Gjirokastrë është hartuar dhe dërguar në MFE Deklarata për Cilësinë e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në përputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të

menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 18, pika 1, dhe Udhëzimi nr. 28, datë 15.12.2011, “Mbi paraqitjen e deklaratës dhe raportit vjetor për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm në njësinë publike”, pika 15.

Me shkresë nr. 2029 prot., datë 28.02.2023, Bashkia Gjirokastrë ka plotësuar dhe dërguar në ministri pyetësorin e vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, në funksion të realizimit të pesë fushave në të cilat funksionon MFK në përputhje me Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010 Kapitulli V, Shtojca 2 “Pyetësori i vetë vlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit”.

-Nuk ka raportime të menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakt dhe produkti kjo situatë është konstatuar kryesisht në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, ku nga kjo drejtori nuk janë paraqitur raporte pranë Titullarit të institucionit dhe Drejtorisë së Financës mbi situatën debitore në lidhje me taksat dhe tarifatat vendore.

-Nuk ka rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

-Nuk ka një plan të veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli III.

## 1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.

Në zbatim të VKM nr. 83, datë 03.02.2016, “Për miratimin e kriterëve të krijimit të Njësisë të Auditit të Brendshëm në Sektorin Publik” si dhe VKB nr. 141, datë 28.12.2020, VKB nr. 103, 24.12.2021, është miratuar struktura organizative e Bashkisë Gjirokastrë ku pjesë e saj është e Njësia e Auditimit të Brendshëm (në vijim NJAB ) e përbërë si më poshtë:

Nr.	Viti	Emër Mbiemër	Funksioni	Arsimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Certifikimi	Trajnime të vijueshme
1	2022	A.SH.	Përgjegjës i Njësisë (i larguar në korrik)	I lartë	20	16	2016	3 ditë
2	2022	A.K.	Audituese	I lartë	16	6	2016	3 ditë
3	2022	K.T.	Përgjegjës i Njësisë	I lartë	7	1	2023	3 ditë
4	2022	B.I.	Auditues	I lartë	19	0	Në pritje të procedurës	0

Burimi i të dhënave: Bashkia Gjirokastrë.

Për sa trajtuar më sipër konstatohet se struktura e NJAB Bashkia Gjirokastrë është e plotësuar me numrin maksimal të punonjësve sipas VKB të sipërpërmendura konkretisht një prej dy pozicioneve specialist auditit dhe një përgjegjës i Njësisë së Auditit të Brendshëm

1. Karta e Auditimit të Brendshëm për NJAB të Bashkisë Gjirokastrë për vitin 2022 është miratuar me shkresën 112/1 prot., datë 12.02.2022, në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli II, pika 2.5.

2. Plani Strategjik është përgatitur dhe dërguar në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm Ministria e Financave dhe Ekonomisë për vitet 2022-2024 me shkresë nr. 11669 prot., datë 19.10.2021, si dhe për vitet 2023-2025 me shkresën 11253 prot., datë 17.10.2022, në përputhje me standardin e përcaktuar në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.2. Referuar planit strategjik për vitin 2022 synohen të realizohen 6 auditime.

3. Raportimi vjetor në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditit të Brendshëm për vitin 2022, është dërguar në DHAB me shkresën nr. 683/1prot., datë 15.02.2023, bashkëngjitur dhe pasqyrat shoqëruese. Dokumentacioni është dërguar në afat shoqëruar edhe me pjesën përshkuese të raportit i përgatitur sipas standardeve që përcakton Manuali i Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli III, pika 3.6.

4. Struktura e Projekt Raporteve dhe e Raporteve Përfundimtare të Auditimit për vitin 2022 është hartuar e plotësuar sipas standardit të vendosur në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12, Hapi 11.

5. Dosjet koherente të NJAB për auditimet e realizuara për periudhën objekt auditimi në përgjithësi janë mbajtur të plotësuar në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, në to është i përfshirë i gjithë informacioni dhe dokumentet e nevojshme.

Të dhënat e detajuara paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 1/1, bashkëlidhur.

### 1.3. Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.

Duke u bazuar në planin vjetor për vitin 2022 për auditimet të cilat do të realizohen nga NJAB, i cili është miratuar me shkresën nr. 10983 prot., datë 30.09.2021, kanë qenë objekt auditimi subjektet si më poshtë:

1. Auditimi në Drejtorinë e Shërbimeve Komunitare, Utilitare;
2. Auditimi në Drejtorinë e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave;
3. Auditimi i Detyrimeve të prapambetura në Drejtorinë e Financës;
4. Auditimi në Drejtorinë e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit;
5. Auditim në Drejtorinë e Turizmit Trashëgimisë dhe Sporteve;
6. Trajtimi i Studentëve Sh.a. dhe Akademia e Futbollit Luftëtari;
7. Zbatim i rekomandimeve për periudhën 6/mujori 2021 deri 01.09.2022.

Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 (seksioni VI, kreu III, pika 1), programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e misionit, drejtimet dhe grupin e punës. Referencat ligjore të vëna në programet e auditimit kanë reflektuar dispozitat dhe kuadrin ligjor në fuqi.

-Për vitin 2022 referuar planifikimit vjetor janë planifikuar për t'u kryer 7 auditime nga të cilat deri më datën 31.12.2022, kanë përfunduar 6 auditime në masën 85% si dhe janë në proces realizimi 2 auditime.

Gjithashtu vlen të theksohet se për periudhën objekt auditimi konstatohet se, NJAB nuk është referuar auditimit të procedurave të prokurimit apo procedurave të pronësisë të cilat janë fusha me risk të lartë pra nuk është kryer një vlerësim real mbi shkallën e riskut për zgjedhjen e subjekteve të cilat do të auditohen në kushte të tilla nuk mund të ofrohet një siguri mbi mënyrën e monitorimit të procesit.

*Pasqyra e rekomandimeve të dhëna nga auditimet e realizuara nga NJAB për vitin 2022, si dhe faza e zbatueshmërisë së tyre paraqitet në mënyrë të hollësishme si më poshtë:*

VITI 2022						
Nr.	Subjekti i Audituar	Numri I rekomandimeve	Pranuar	Zbatuar	Në proces	Pa zbatuar
1	Drejtoria e Zh.B. Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit	11	11	9	1	1
2	Drejtoria e Shërbimeve Komunitare , Utilitare	14	14	3 dhe 5, zbatuar pjesërisht	3	3
3	Drejtoria e Turizmit Trashëg dhe e Sporteve	7	7			
4	Auditimi në Drejtorinë e të Ardhurave	3	3			

5	<b>Auditimi i në Drejtorinë e Financës.</b>	5	5		
6	<b>Trajtimi i Studentëve sh.a</b>	18	18		
7	<b>Akademia e Futbollit Luftëtarë (Fondacion)</b>	8	8		
	<b>Totali</b>	<b>66</b>	<b>66</b>		

Burimi i të dhënave: Bashkia Gjirokastrë.

### **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm.**

Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura në përgjithësi janë zbatuar kërkesat e Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, por në disa raste janë konstatuar parregullsitë si më poshtë:

-Në 3 raste për vitin 2022, nga NJAB nuk është hartuar memorandumi, veprime këto në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", pika 6.3, "Dosja e përhershme".

-Subjektet e audituara nuk kanë paraqitur Planin e Veprimit për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 114/2015, datë 22.10.2015, "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli IV, pika 4.1.12. Hapi 11, "Raportet e auditimit dhe plotësimi i plan veprimit nga njësia e audituar".

-Vlerësojmë se sipas përcaktimeve të bëra në Manualin e Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016, Kapitulli VI, "Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese", në përgjithësi programet kanë përmbledhur orientimet kryesore të veprimit në përputhje me risqet dhe problematikat e subjekteve, dhe përmbajnë në mënyrë të qartë emërtimin e subjektit, llojin e auditimit, periudhën dhe afatin e auditimit, drejtimet që do të ndiqen, dhe grupin e auditimit. Në përgjithësi referencat ligjore të vëna në programet e auditimit reflektojnë kuadrin ligjor në fuqi.

-Hartimi i Projekt Raporteve dhe Raporteve Përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit. Për çdo rast si Projekt Raportet edhe Raportet Përfundimtare të Auditimit janë dërguar pranë subjekteve të audituara me shkresa të protokolluara dhe brenda afateve ligjore të përcaktuara në manual. Në dosje janë të administruara komentet në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet.

### **Pika 2.1 e programit. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

#### ***Programimi i PBA 2022-2024 dhe programimi i buxhetit vjetor 2022.***

- Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2022-2024 rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës Grupi i Menaxhimit Strategjik me Urdhër të Titullarit të Institucionit nr. 217, datë 16.04.2021, të cilat kanë përcaktuar tavanet e shpenzimeve sipas programeve të cilat janë miratuar përkatësisht me VKB nr. 29, datë 31.03.2021, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë me shkresën nr.3622, datë 09.04.2021 dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresë nr. 229, datë 12.01.2022.

Projekt buxheti për vitin 2022-2024 është hartuar në përputhje me kriteret dhe kërkesat e ligjit 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, ligji nr. 68-2017, "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore", ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", në hartimin dhe formulimin e deklaratave të politikave të programeve buxhetore, janë mbajtur në konsideratë objektivat e politikave të programeve buxhetore dhe janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me



shkresë nr. 229, datë 12.01.2022 me relacionin shpjegues, si për fazën e parë dhe për fazën e dytë të PBA 2022-2024.

Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA 2022-2024, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm e të huaj, si dhe raportet e projekteve të investimeve.

Struktura buxhetore për Programin Buxhetor Afatmesëm të këtij institucioni, paraqitet në 13 programe buxhetore.

Gjatë hartimit të PBA për vitet 2022-2024 janë përcaktuar “Përshkrimi” i çdo program, “Politika e programit”, “Qëllimi i Politikës së programit”, “Objektivat e politikës së programit”. Gjithashtu çdo program ka të përcaktuar produktet e programeve buxhetore, në të dy fazat e përgatitjes së tij, shpërndarja e fondeve sipas programeve paraqitet në pasqyrën aneks 2/1, bashkëlidhur.

**Për vitin 2022** buxheti është miratuar me VKB nr. 107, datë 24.12.2021 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresën nr. 187 prot., datë 11.01.2022.

Miratimet e buxhetit fillestar të Bashkisë Gjirokastër, për vitin 2022 paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2022	
		Të Ardhurat	Shpenzimet
1	<b>Të ardhurat</b>		
1.1	Të ardhurat e veta të planifikuara për 2022	210,370	
1.2	Të trashëguara pa destinacion	154,474	
2	<b>Transferta</b>		
2.1	Transferta e përgjithshme e pakushtëzuar (grandi)	219,985	
2.2	Transferta e pakushtëzuar sektoriale	188,506	
2.3	Transferta e kushtëzuar	213,075	
	<b>Shpenzimet</b>		
1	Paga (600+601)		429,050
2	Shpenzime Operative (602)		142,304
3	Subveçione (603)		1,614
4	Transferta të brendshme (604)		17,250
5	Transferta tek individët (606)		1,200
6	Fondi rezervë (609)		4,710
7	Fondi kontigjencës (609)		4,710
8	Fondi emergjencës nga të ardhurat e veta (602)		4,000
9	Shpenzime kapitale (230-231)		381,572
	<b>Totali i buxhetit</b>	<b>986,410</b>	<b>986,410</b>

Duke u nisur nga burimi i financimit **për vitin 2022** shpenzimet buxhetore janë planifikuar për tu përballuar nga të ardhurat e veta në shumën 584,829 mijë lekë (*Të ardhura të vitit në shumën 210,370 mijë lekë, të trashëguara të vitit paraardhës në shumën 154,474 mijë lekë dhe grandit 219,985 mijë lekë*) ose në masën 59 %, nga transferta e pakushtëzuar sektoriale në shumën 188,506 mijë lekë ose në masën 19 %, dhe transferta e kushtëzuar në shumën 213,075 mijë lekë ose në masën 22 %.

Për sa i përket shpenzimeve rezultojnë se për vitin 2022 shpenzimet për paga e sigurime zënë 43 % ose në vlerën 429,050 mijë lekë, shpenzime korrente zënë 14 % ose për vlerën 142,304 mijë lekë dhe shpenzime për investime zënë 39 % ose në vlerën 381,572 mijë lekë.

Struktura organizative për vitin 2022, është miratuar me VKB nr. 103, datë 24.12.2021, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër me shkresë nr. 187, datë 11.01.2022, ndërsa numri i punonjësve është miratuar me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 383/8, datë 08.06.2022, të dhënat si më poshtë:

Nr	Emërtimi	Viti 2022			
		Plani	Fakti	Status	Kontratë
1	Planifikim, menaxhim dhe administrim	107	103	61	42
2	Shërbimet e policisë vendore	16	16	0	16
3	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	33	30	3	27
4	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit	10	10	7	3
5	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	10	10	9	1
6	Rrjeti rrugor rural	10	10	9	1
7	Zhvillimi i turizmit	24	21	0	21
8	Shërbimet publike vendore	178	176	0	176
9	Sport dhe argëtim	6	5	0	5
10	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	24	24	0	24
11	Arsimi parashkollor përfshirë arsimin bazë	133	133	0	133
12	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	49	47	0	47
13	Kujdesi social për personat e sëmurë dhe me aftësi të kufizuara	9	9	7	2
14	Gjendja civile	6	6	0	6
15	QKB	2	2	0	0
	<b>Totali</b>	<b>617</b>	<b>602</b>	<b>96</b>	<b>504</b>

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr. 103, datë 24.12.2021, në zbatim të ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i punës në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM-së nr. 177, datë 08.03.2017, “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 165, datë 02.03.2016, “Për grupin e njësisve të vetëqeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur të emëruar, të punonjësve civil, të punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, VKM-së nr. 234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, VKM-së nr. 175, datë 08.03.2017, “Për trajtimin me pagë të punonjësve mësimor në arsimin parauniversitar” i ndryshuar, VKM-së nr. 350, datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”. Paketa fiskale për vitin 2022 është miratuar me VKB nr. 94, datë 01.12.2021. Të ardhurat gjithsej për të financuar buxhetin e vitit 2022, janë planifikuar në vlerën 210,372 mijë lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 228,694 mijë lekë.

*Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura;*

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet, që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit Gjyrokastër dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve.

Si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare dhe ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj, të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

Për vitin 2022 buxheti shtesë gjithsej është **në vlerën 313,374 mijë lekë**, e analizuar si më poshtë:

- Fonde të kushtëzuara për ndihmën ekonomike në vlerën 206,283 mijë lekë,

- Fonde të kushtëzuara për Gjendjen Civile në vlerën 4,948 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për Qendrën Kombëtare Biznesit në vlerën 1,770 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për emergjencat civile në vlerën 10,549 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për subvencionimin e qirave të banesave në vlerën 1,257 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për investimin “Përmirësimi i kushteve të banimit” në vlerën 3,745 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për investimin “Rikonstruksioni i palestrës shkollës “Asim Zeneli” dhe shkolla “Drita” në vlerën 18,062 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuara për trajtimin e bursave në vlerën 952 mijë lekë,
  - Fonde për projektin me financim të huaj “Zhvillimi ekonomik alternativ në zonat me risk të lartë të veprimeve ilegale, informale si mbjellja e kanabisit në Gjirokastrë dhe Dropull” në vlerën 42,061 mijë lekë,
  - Fonde të përfituara nga rimbursimit i shpenzimeve pas vlerësimit të performancës të projekteve IPA në vlerën 8,665 mijë lekë,
  - Fonde të përfituara nga zhbllokimi i 5% të garancisë së punimeve në vlerën 11,810 mijë lekë.
  - Fonde të kushtëzuara për pagesën e TVSH-së së projekteve me financim të huaj në vlerën 4,800 mijë lekë,
  - Fonde të kushtëzuar për investimin “Rehabilitimi i kanalit vaditës Zhulat” në vlerën 13,405 mijë lekë.
  - Fonde të kushtëzuara për investimin “Ujësjellësi Lazarat” në vlerën 61,077 mijë lekë.
  - Fonde të trashëguara nga viti 2021 në vlerën 9,076 mijë lekë.
  - Fonde të pakushtëzuara specifike për investimin “Rikonstruksioni i pallatit të sportit” në vlerën 100,000 mijë lekë.
  - Fonde të pakushtëzuara specifike për ndihmë financiare me qëllim zbutjen e krizës në vlerën 2,380 mijë lekë.
- Gjatë planifikimit të buxhetit fondet e pritshme të kushtëzuara për investimin “Ujësjellësi Lazarat” janë në vlerën 187,466 mijë lekë, ndërkohë që gjatë zbatimit, të buxhetit fondet e çelura nga AKUM-i janë në vlerën 61,077 mijë lekë.

**Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit. Mënyra e përdorimit të të ardhurave.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordime përkatëse, janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv të realizuar me vendimin e këshillit Bashkiak, ose të diktuar nga transfertat e deleguara nga pushteti qendror si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi buxhetin dhe detajimin e tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli, nën artikulli u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin në fakt është respektuar disiplina buxhetore. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha viti 2022 referuar aktrakordimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

N r	Emërtimi	Viti 2022							
		Plani fillim Viti Sipas VKB	Çelja në Thesarit sipas akt rakordimit	Fakti sipas aktrakor dimit	Te ardh veta	Grand	Trans. pakush tez Spec.	Tran. Kusht. Funk Deleg.	Tra. Kush Per Inv.
1	Paga (600)	369,814	366,254	350,489	111,395	85,553	148,344	5,197	0
2	Sigurime (601)	59,236	60,144	58,354	16,221	16,518	24,745	868	0
3	Shpenzime (602)	146,304	184,729	155,688	22,583	93,626	38,628	851	0
4	Subvecion qeraje (603)	1,614	1,614	923	0	923	0	0	0
5	Transferta (604)	17,250	28,300	25,464	14,502	2,500	0	8,461	0
6	Fondi kontigjenc dhe rezerve	9,420	4,885		0	0	0	0	0
7	Inv(230 +231)	381,572	431,729	185,300	30,065	59,395	0	0	95 840
8	Transferta tek individet (606)	1,200	222,131	219,438	4,800	5,857	4,114	204,666	0
	<b>Totali</b>	<b>986,410</b>	<b>1,299,784</b>	<b>995,656</b>	<b>199,566</b>	<b>264,372</b>	<b>215,831</b>	<b>220,043</b>	<b>95,840</b>

**1. Titulli gjetjes:** Mbi programimin, realizimin dhe zbatimin e buxhetit për periudhën objekt auditimi

**Situata:** Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakor dimit me thesarin për vitin 2022, nga 1,299,784 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 995,656 mijë lekë ose në masën 77 %, (Pagat (600) nga 366,254 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 350,489 mijë lekë, me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 111,395 mijë lekë, grand në vlerën 85,553 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar në vlerën 148,344 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar në vlerën 5,197 mijë lekë) ose 96%, sigurime shoq. (601) nga 60,144 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 58,354 mijë lekë, me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 16,221 mijë lekë, grand në vlerën 16,518 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar në vlerën 24,745 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar në vlerën 868 mijë lekë) ose 97%, Shpenzime operative (602) nga 184,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 155,688 mijë lekë, me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 22,583 mijë lekë, grand në vlerën 93,626 mijë lekë, transferta e pakushtëzuar në vlerën 38,628 mijë lekë dhe transferta e kushtëzuar në vlerën 851 mijë lekë) ose 84% dhe shpenzime për investime (230-231) nga 431,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 185,300 mijë lekë, me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 30,065 mijë lekë, grand në vlerën 59,395 mijë lekë, dhe transferta e kushtëzuar në vlerën 95,840 mijë lekë) ose 43%, përse i përket likuidimit të shpenzimeve operative dhe shpenzimeve për investime paraqiten sipas pasqyrave **Aneks 2/2** bashkëlidhur. Konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për investime, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky zë është planifikuar në vlerën 431,729 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 185,300 mijë lekë, ose në masën 43 %.

**Kriteri:** ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak.

**Impakti:** Realizim jo të kënaqshëm të shpenzimeve në disa zëra buxheti si dhe realizim jo shumë të mirë të të ardhurave.

**Shkaku:** Mos programimi i buxhetit mbi bazë prioritesh dhe nevojash reale dhe ndryshimet e shpeshta e bëjnë të paqëndrueshëm dhe jo efektiv procesin e buxhetimit.

**Rëndësia:** I mesëm

**Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i të ardhurave të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

Raportet e monitorimit të buxhetit për vitin 2022, janë dërguar MFE me shkresat nr. 5888, datë 31.05.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 4/mujorin e parë”, nr. 10618, datë 30.09.2022 “Mbi raportin e monitorimit për 8/mujorin e vitit 2022” dhe shkresa nr. 2042, datë 23.02.2023 “Mbi raportin e monitorimit për 12/mujorin e vitit 2022”, brenda afateve ligjore.

Buxheti faktik i vitit 2022 është miratuar me VKB nr. 35, datë 28.04.2023, dhe është dërguar në MFE me shkresë nr. 4718, datë 19.05.2023.

**Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e palikujduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj, sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZHR, Ministrinë e linjës etj.)**

Detyrimet e palikujduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të MFE rubrika “Detyrimet e prapambetura” sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>			
<b>a</b>	<b>Hua sfatgjatë</b>			
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>			
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
<b>II</b>	<b>Detyrime (a+b+c)</b>			
<b>a</b>	<b>Shpenzime korrente</b>			
a,1	Mallra dhe shërbime			
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera			
<b>b</b>	<b>Shpenzime kapitale</b>	8 236		
b,1	Insituacione buxhetore			
b,2	Subjekte private	8 236		
<b>c</b>	<b>Vendime gjyqësore</b>	963		
c,1	Marrëdhënie pune	963		
c,2	Mallra dh e shërbime			
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>9 199</b>	<b>1 225 060.65</b>	<b>0.75%</b>

Nga të dhënat e bilancit rezulton se detyrimi i faturave të palikujduara dhe vendime gjyqësore në fund të vitit 2022, që i përkasin llogarisë (467) “Kreditorë të ndryshëm”, janë për vlerën gjithsej 10,889,181 lekë sipas të dhënave të pasqyrave **aneks nr. 2/3 bashkëlidhur**.

**2. Titulli gjetjes:** Mbi totalin e detyrimeve të palikujduara nga Bashkia Gjirokastrë deri më datë 31.12.2022.

**Situata:** Nga auditimi i rezultoi se nga totali i detyrimeve, sipas bilancit është për vlerën 10,889,181 lekë, janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë **për vlerën 9,199,181 lekë** (detyrime shpenzime kapitale në vlerën 8,236,219 lekë dhe detyrime për vendime gjyqi në vlerën 962,962 lekë). Diferenca për vlerën 1,690,000 lekë që nuk është raportuar MFE ka të bëjë me paradhëniet për kopshte e çerdhe në fund të vitit. Detyrime të papaguara më datë 31.12.2022, janë në vlerën gjithsej 9,199,181 lekë (detyrime për investime në vlerën 8,236,219 lekë dhe detyrime për vendime gjyqi në vlerën 962,962, nuk janë likujduar për mungesë të fondeve, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe ligjit nr. 10269 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” neni 12, germa “gj”.

**Kriteri:** ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91.

**Impakti:** Ndikim në buxhetin e vitit pasardhës, duke rënduar shpenzimet e vitit, nuk janë analizuar shkaqet për detyrimet e prapambetura.

**Shkaku:** Analizat e faturave të papaguara për mallrat, shërbimet dhe detyrimet për vendime Gjykate nuk janë bërë të plota në buxhetet paraardhëse, duke mos nxjerrë konkluzione të sakta për krijimin dhe akumulimin e detyrimeve të prapambetura dhe analizimin e të gjitha detyrimeve.

#### **Rëndësia: E lartë**

**-Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Financës , të paraqesë në mbledhjen e këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbartimore, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që, ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbartuesit gjyqësor.

*-Dokumentacioni mbi çeljen dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes Ministrisë, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;*

*Nga të dhënat e paraqitura për periudhën objekt auditimi rezulton se Bashkia Gjirokastrë ka detyrime për kontrata të cilat janë mbuluar me fonde të Ministrisë (AKUM) në vlerën 19,273 lekë për objektin “Mbikëqyrje punimesh në Ujësjellësin Lazarat:*

#### **Nënpika 2.2.6 e programit. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore për vitin 2022 .**

**- Struktura për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore.**

-Për vitin 2022 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 103, datë 24.12.2021, ku pjesë e saj përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të

Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave. Kjo drejtori ka në përbërje të saj 25 punonjës konkretisht: 1 drejtor, 3 punonjës në Sektorin e Kontabilizimit dhe Shërbimit ndaj Taksapaguesve, 4 punonjës në Sektorin e Lejeve, Licencave dhe Administrimit të Pronave Publike, 6 punonjës në Sektorin e Menaxhimit të Ndërmarrjeve dhe Tregjeve Publike, 4 punonjës Inspektor për kontrollin në terren dhe ndjekjen e debitorëve në qytet dhe 6 punonjës Inspektor vjelje taksash për njësitë administrative dhe ndjekjen e debitorëve.

## 2. Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve.

-Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Gjirokastrë është miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 94, datë 01.12.2021, “Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2022”.

Nga të dhënat e paraqitura rezulton se për periudhën objekt auditimi, subjekte që kanë ushtruar aktivitetet dhe për të cilat janë planifikuar taksa dhe tarifa vendore, paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Lloji Biznesit	Viti 2022			
	Gjendja fillim	Biznese të reja	Biznese të mbyllur	Gjendja në fund
B. Vogël	1135	44	67	1112
B. Madh	255	6	16	245
<b>Gjithsej</b>	<b>1390</b>	<b>50</b>	<b>83</b>	<b>1357</b>

Për vitin 2022, kanë ushtruar aktivitetet 1357 subjekte (1112 subjekte të biznesit të vogël dhe 245 subjekte të biznesit të madh)

Referuar planit vjetor të miratuar dhe akt akordimeve me Degën e Thesarit Gjirokastrë parashikimi dhe realizimi i të ardhurave vendore për vitin 2022 paraqitet në pasqyrën Aneks 2/4, bashkëlidhur.

Për vitin 2022, të ardhurat nga taksat e tarifave vendore gjithsej, nga 210,370 mijë lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 206,928 mijë lekë ose 80 %, **me një mosrealizim në vlerën 3,442 mijë lekë, mungesë të ardhurash** në buxhetin e bashkisë.

-Për vitin 2022 me tejkallim paraqiten zërat si më poshtë:

“Taksa e trualli” planifikuar në vlerën 127 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 788 mijë lekë ose realizuar në masën 547% duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 i cili është në vlerën 703 mijë lekë.

“Tatimi nga shitja e pasurisë së paluajtshme” planifikuar në vlerën 724 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 3,966 mijë lekë ose realizuar në masën 734% duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 i cili është në vlerën 2,913 mijë lekë.

“Të ardhura nga TAP” planifikuar në vlerën 6,000 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 9,622 mijë lekë ose në masën 160% duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2021 i cili është në vlerën 8,531 mijë lekë.

Si dhe disa prej zërave fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave konkretisht, “Të ardhura jo tatimore” planifikuar në vlerën 95,147 mijë lekë ndërsa arkëtimet janë në vlerën 90,822 mijë lekë ose realizuar në masën 95%.

### - Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2022.

<b>Titulli i gjetjes:</b> Mos ndjekje e plotë e procedurave ligjore për mbledhjen e detyrimeve debitorë.
--

**Situata:** Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2022 për mos pagesën e detyrimeve të taksave dhe tarifave vendore **në vlerën gjithsej 181,012,983 lekë**, nga të cilët 1032 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 70,197,983 lekë, 64 subjekte

për qira objekte të tregut në vlerën 2,526,000 lekë dhe 11,345 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën 108,289,000 lekë, pasqyra si më poshtë:

EMËRTIMI	01.01.2022		31.12.2022	
	Vlera	Nr. Subjekte e familje	Vlera	Nr. Subjekte e familje
<b>Debitorë ne total</b>	<b>180,883</b>	<b>10 064</b>	<b>181,012</b>	<b>12 441</b>
Biznesi i madh	18,782	94	21,550	104
Biznesi i vogël	41,056	823	48,647	928
Qira objekti tregu	2,748	70	2,526	64
Familje për taksa tarifa	118,297	9 077	108,289	11 345

Ndërsa sipas statusit të subjekteve gjendja e borxhit paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Statusi i subjekteve debitore	2022	
	Vlera	Nr. Subjekte
<b>Totali</b>	<b>70,198</b>	<b>1 032</b>
Aktiv, QKB, Tatime, Abulant, OJF	45,033	591
Pasiv	25,185	441

Referuar të dhënave të pasqyrës, konstatohet se borxh i keq për vitin 2022 është për vlerën 25,158 mijë lekë ose 36% e totalit.

Ndërsa **vlera prej 108,289,000 lekë janë** debitorët 11 345 familje të për taksat e tarifatat vendore dhe debitorë të ardhur nga UK Gjirokastër me datë 31.12.2022, për mospagesën e detyrimeve sipas pasqyrës si më poshtë:

000/lekë					
Nr	Debitorë familjarë	Taksa vendore Taksë Toke	Tarifa Vendor	Shuma taksa tarifa	Numri i familjev e
1	Familje bujqësore	22,062	0	<b>22,062</b>	<b>4974</b>
2	Nga abonent familjarë qyte	0	71,876	<b>71,876</b>	<b>3948</b>
3	Nga abonent familjarë Nj/Ad	0	14,351	<b>14,351</b>	<b>2423</b>
	<b>Shuma</b>	<b>22,062</b>	<b>86,227</b>	<b>108,289</b>	<b>11 345</b>

Nga totali prej 12 441 debitorë në vlerën gjithsej **181,012,983 lekë**, nga të cilët 1032 subjekte të biznesit të vogël dhe biznesit të madh në vlerën 70,197,983 lekë, 64 subjekte për qira objekte të tregut në vlerën 2,526,000 lekë dhe 11,345 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën 108,289,000 lekë, nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në zbatim të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka vijuar me procedurat e arkëtimit të detyrimeve në zbatim të kreut XI-“Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, janë dërguar për bllokim të llogarive bankare subjekteve të cilat janë debitorë, për rrjedhojë është rritur dhe arkëtimi në krahasim me vitin 2021, por akoma rezultojnë 591 subjekte aktive për vlerën 45,033,000 lekë, që nuk kanë likuiduar detyrimet në fund të vitit 2022.

U konstatua se nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, në fund të periudhës datë 31.12.2022, Drejtorisë së Financës i janë dërguar për kontabilizim vetëm vlera e debitorëve të vitit në shumën 15,931,835 lekë kur në fakt debitorë progresiv për subjekte të biznesit të madh e të vogël me datë 31.12.2022, janë 1032 subjekte në vlerën 70,197,983 lekë. Gjithashtu u konstatua se nuk janë dërguar me shkresë Drejtorisë së Financës



debitorët për 64 subjekte për qira objekte të tregut në vlerën 2,526,000 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

**-Kriteri:** Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar, Ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Vendimet e Këshillit Bashkiak për miratimin e paketës fiskale, etj.

**-Impakti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifave vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

**-Rëndësia: E lartë**

**-Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, bazuar në nenin 70 pika 3 “E drejta për të nxjerrë njoftimin e vlerësimit tatimor”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore në R.SH”, i ndryshuar, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në fund të periudhës në vlerën **181,012,983 lekë**, si më poshtë vijon:

*a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimit e llogarive bankare, sipas nenit 90, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”.*

*b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës sigurorese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme), sipas nenit 91, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore Republikane e Shqipërisë” me ndryshime.*

*c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.*

*d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal bazuar në Kodin Penal të R.SH, miratuar me ligjin nr.7895, datë 27.1.1995 i ndryshuar neni 181 “Mospagimi taksave dhe tatimeve”.*

*Nga auditimi për likuidimin e detyrimeve për lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Titulli i gjetjes:** *Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga lejet legalizimit të ngarkuar për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI Gjirokastrë janë dërguar zyrtarisht me shkresë lista e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Gjirokastrë.

Konkretisht për periudhën deri më 31.12.2022, nga grupi i auditimit sipas listave të vënë në dispozicion me leje legalizimi dhe kryqëzimi i tyre me personat që kanë bërë të mundur likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturës, rezulton nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për **84 persona** me vlerë **1,854,317 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, sipas Aneks nr. 2/5 bashkëlidhur,

rezulton se nga Drejtoria Urbanistikës Bashkisë Gjirokastrë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,854,317 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

**-Kriteri:** -Ligji nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore” i ndryshuar, neni 27 “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*”, pika 3, VKM nr.860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5.

**-Impakti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinonjnë strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore, për realizimin e të ardhurave.

**Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria Urbanistikës, të marrë masa që të dërgohen në zyrën e Financës për kontabilizim vlera e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për **84 persona** me vlerë **1,854,317 lekë**, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, sipas pasqyrës Aneks nr.2/3 bashkëlidhur.

*Auditimi mbi likuidimin e detyrimeve nga dhënia me qira e tokave bujqësore, për periudhën viti 2022.*

**Titulli i gjetjes:** *Burimi krijimit të të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre, vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga qiratë e tokave bujqësore.*

**Situata:** Nga Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike për periudhën objekt auditimi administrohen **46 kontrata qiraje për toka bujqësore** të pandara me sipërfaqe **106.433 ha**, amë afate 30, 35 dhe 99 vjeçare (Njësia Administrative Odrie ka lidhur 3 kontrata për sipërfaqen 8.27 ha, Njësia Administrative Picar ka lidhur 3 kontrata për sipërfaqen 10.2 ha, Njësia Administrative Cepo ka lidhur 7 kontrata për sipërfaqen 36.18 ha, Njësia Administrative Lazarat ka lidhur 2 kontrata për sipërfaqen 2.307 ha dhe Njësia Administrative Lunxhëri ka lidhur 34 kontrata për sipërfaqen 49.476 ha).

Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e tokave bujqësore të pandara, për kontratat e vitit 2022 e para, u konstatua se 24 fermer, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, në vlerën **1,072,105 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë, sipas pasqyrës Aneks nr. 2/6**, bashkëlidhur.

Nga Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës me fermerët sipas pasqyrës si më sipër, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,072,105 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

**Kriteri:** ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale.

**-Impakti:** Mungesa e të ardhurave sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njesisë së Qeverisjes Vendore.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore.

**-Rëndësia: E lartë**

**-Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në zyrën e Financës për kontabilizim vlera e qirave të papaguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës **1,072,105 lekë**, sipas të dhënave në pasqyrën **Aneks nr. 2/4**, bashkëlidhur.

**Pika. 2.3 e programit. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

**Nxjerrja e pasqyrave financiare për vitin 2022.**

**Për vitin 2022**, Në përputhje me kërkesat e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” si dhe të UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, dërguar Degës së Thesarit me shkresën nr. 3193 prot., datë 30.03.2023, të përbëra si vijon:

Format nr. 1 –Pasqyra e pozicionit financiar.

Format nr. 2 –Pasqyra e performancës financiare (Klasifikimi sipas natyrës ekonomike).

Format nr. 3 – Pasqyra e flukseve monetare (Caush-Flou).

Format nr. 4 –Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto.

**Format nr. 5 –Pyetësor dhe shënimet shpjeguese.**

Format nr. 6 –Investimet dhe burimet e financimit.

Format nr. 7/a –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (kosto historike).

Format nr. 7/b –Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve afatgjata (vlera neto).

Format nr. 8 –Numri i punonjësve dhe fondi i pagave.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga znj. A.K. si nëpunës zbatues dhe Kryetar i Bashkisë z. F.G., Nëpunës autorizues.

- **Inventarizimi i aktiveve për vitin 2022 Bashkia Gjirokastrë.**

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se, Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 të Ministrisë së Financave “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 73-106, ka dalë Urdhri i Kryetarit të Bashkisë nr. 1053, datë 30.12.2022 “Për inventarizimin e aktiveve afatgjatë, afatshkurtër e materiale për periudhën 01.01.2022-31.12.2022” dhe është ngritur komisioni për të kryer inventarizimin fizik të aktiveve në përdorim, si dhe për të krahasuar gjendjen fizike të aktiveve me gjendjen kontabël, i përbërë nga 5 anëtarë, me afat përfundimi në datë 15.02.2023.

Sa më sipër rezulton se llogaritë e aktiveve afatgjatë e afatshkurtër materiale për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 në pasqyrat financiare janë raportuar për gjendjen e tyre kontabël. Në këto kushte, llogaritë e pasqyrave financiare, nuk janë të rakorduar me gjendjen fizike gjë e cila nuk krijon besueshmëri mbi vërtetësinë e tyre.

Në këtë rast, nxjerrja e pasqyrave financiare vetëm për vlerën e tyre kontabël pa krahasuar me inventarin fizik, është shkelje e kërkesave të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, neni 4, pika 24, të Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, ku citohet: *...Inventarizimi i aktiveve është një element i rëndësishëm kontrolli në kuadrin e menaxhimit të aktiveve të njësisë, i cili kryhet për të vërtetuar saktësinë, cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve në një kohë të caktuar si dhe përdorimin në mënyrën e duhur dhe me eficiencë të tyre. Inventarizimi kryhet nën përgjegjësinë dhe sipas procedurave të miratuara me këtë udhëzim dhe nga titullari i njësisë publike, pika 74, ku citohet:.... Cdo njësi publike duhet të kontrollojë të paktën një herë në vit ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementeve dhe dokumentacionit mbështetës, të UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme” **Kreu III, pika 30 ku citohet: “Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementeve të tjera, konformë kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabël për llogari të vitit kontabël që mbyllet.”***

#### **Mbajtja e kontabilitetit v. 2022.**

Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale. Janë hapur ditarët përkatës për bankën, ditari i arkës, magazinën, ditari i veprimeve të ndryshme etj. Gjendja e llogarive të evidentuara në bilanc në fund të periudhës raportuese ushtrimore viti 2022, të pozicionit financiar Bashkia Gjirokastër; Formati nr.1, paraqitet në pasqyrat e mëposhtme:

Nga procesi i auditimit mbi referencat e llogarive të aktivitetit dhe pasivitetit, në lidhje me verifikimin e vlerave të pasqyruara në llogaritë e pasqyrave të pozicionit financiar të periudhës raportuese ushtrimore 2022, të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre paraqiten si në vijim;

**Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet= 3,078,472,708 lekë.**

Aktivet	3,183,145,543 lekë
Pasivet	104,672,835 lekë
Aktivet neto	3,078,472,708 lekë

#### **Aktivet afatshkurtra**

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **440,023,987 lekë** dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekujvalentet e tyre” në shumën 288,591,964 lekë,  
Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 69,845,108 lekë,  
Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 81,586,815 lekë,

### Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
531	Mjete monetare ne arkë	0	0	0
56	Mjete monetare ne bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	288,591,964	216,176,000	72,415,964
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	0	756,000	(756,000)
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizijone zhvlerësimi	0	0	0
Totali		288,591,964	216,932,000	71,659,964

Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 288,591,964 lekë, sipas aktrakordimit me Thesarin përbëhet nga: gjendja e Llogaria 85 "Rezultati i vitit ushtrimor" në pasqyrën 1 “Pasqyra e pozicionit financiar” paraqitet në vlerën 273,267,532 lekë (të ardhura të trashëguara të paçelura 265,506,044.35 lekë, grand papërdorur në vlerën 189,837,526 lekë dhe të ardhura të papërdorura në vlerën 75,68,517.43 lekë) dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 23,085,920 lekë, minus Ndryshimin e gjendjeve të inventarit që në fund të vitit paraqitet me shtesë në vlerën 7,761,476 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën VI “Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” në Formatin nr.3 “Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte” (Teprica në fillim të vitit në vlerën 216,175,995 lekë + Transferta të tjera në vlerën 3,752,579 lekë + Veprimtaritë e investimeve në vlerën 116,529,887 lekë+ Fondet buxhetore për shpenzime korrente në vlerën 537,726,418 lekë + arkëtimet e hyra cash në vlerën 238,184,433 lekë – Pagesa për detyrime e shpenzime korrente në vlerën 823,777,348 lekë), të paraqitur më poshtë:

Numër Rreshti	Numër Rubrike	Përmbajtja	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	-47,866,497	493,468,450
2	1	Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)	537,726,418	582,544,936
3	2	Arkëtime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor	238,184,433	209,628,068
4		Te hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shëndeti(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	114,013,224	79,249,812
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)	9,954,906	255,037
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	9,491,369	9,846,435
10		Te tjera, arketuar(+)	104,724,934	120,276,784
11	3	Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente	-823,777,348	-526,300,876
12		Per detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detyrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-589,054,910	-176,415,580
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)	(13,422,398)	(13,413,643)
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara ( - )	-221,300,040	-691,294,576
18	II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	116,529,887	298,553,987
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)	301,830,623	298,553,987
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhënies dhe nenhuadhenie(+)		
23		Pagesa per detyrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detyrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-185,300,736	
25		Huadhënie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividend te paguar(-)	0	
28	III	TRANSFERTA E TE TJERA	3,752,579	-24,011,351
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		

Numër Rreshti	Numër Rubrike	Përmbajtja	Periudha Raportuese	Periudha Paraardhëse
30		Transferime ne buxhet te Fondeve të pa përdorura(-)	-4,909,370	-24,011,351
31		Lëvizje e brendshme e transferta te tjera(+/-)	8,661,949	
32	IV	Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare	72,415,969	768,011,086
33	V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	216,175,995	
34	VI	Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor	288,591,964	216,932,000

Llogaritë e klasës 5, kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

### **Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
31	Materiale	27,064,235	21,087,202	5,977,033
32	Inventar i imët	42,780,873	40,996,430	1,784,443
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambritura ose pranë të tretëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Shuma te parashikuara për zhvlerësim te inventarit(-)	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>69,845,108</b>	<b>62,083,632</b>	<b>7,761,476</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Gjirokastrë në 31.12.2022 paraqitet në vlerën 69,845,108 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 27,064,235 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Inventar i imët” në vlerën 42,780,873 lekë. Diferencat me vitin e mëparshëm përfaqësojnë lëvizjen e inventarit në shumën 7,761,476 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën –(7,761,476) lekë.

**Llogaria 312 “Materiale”,** ka vlerën 27,064,235 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	21,087,202
Hyrje me pagesë gjatë vitit 2022	141,453,393
Dalje nga magazina gjatë vitit	135,476,360
Gjendja në 31.12.2022	27,064,235

**Llogaria 32 “Inventarë i imët”,** ka vlerën 42,780,873 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2022	40,996,430
Hyrje gjatë vitit 2022	1,797,279
Dalje gjatë vitit 2022	12,836
Gjendja në 31.12.2022	42,780,873

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

**Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra”  
përbëhet nga:**

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 2022-2021
	Llogari të arkëtueshme	81,586,915	62,564,265	
411	Klientë e llogari te ngjashme	90,000	257,000	(167,000)
423,429	Personeli, paradhënie, deficite e gjoba	0	0	0
431	Tatime e taksa	0	0	0
432	Tatime mbledhur nga shteti për llog. Pushtetit Lokal	0	0	0
433	Shpenzime fatkeqësi natyrore qe mbulon shteti	0	0	0
435	Sigurime Shoqërore	0	0	0
436	Sigurime Shëndetësore	0	0	0
437,438	Organizma te tjerë shoqërore	0	0	0
44	Institucione te tjera publike	0	0	0
465	Efekte per t'u arkëtuar nga shitja letra me vlere vendosjes	738,000	0	738,000
468	Debitorë të ndryshëm	33,986,115	14,664,580	19,321,535
4342	Te tjera operatione me shtetin(debitor)	46,772,800	47,642,685	(869,885)
45	Marrëdhënie me instit. brenda dhe jashtë sistemit	0		
49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)	0		
	Të tjera aktive afatshkurtra	0		
409	Furnitore(Debitorë),parapagime pagesa pjesore	0		
473	Llogari të pritjes të marrëdhënieve me thesarin	0		
477	Diferenca konvertimi aktive	0		
481	Shpenzime për t'u shpërndarë në disa ushtrime	0		
486	Shpenzime të periudhave të ardhshme	0		
	<b>Totali</b>	<b>81,586,915</b>	<b>62,564,265</b>	<b>19,022,650</b>

**Llogaria 411 “Klientë e llogari të ngjashme”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 90,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e taksave të pullës nga aktiviteti i punonjësive të Gjendjes Civile.

**Llogaria 465 “Efekte për tu arkëtuar nga shitja e letrave me vlerë”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 738,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën e letrave me vlerë (taksë pulle) të pashpërndarë.

**Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,986,115 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
<b>Gjendja në 01.01.2022</b>	<b>14,664,580</b>
Shtesa gjatë vitit 2022 (D)	19,821,535
Pakësime gjatë vitit 2022 (K)	500,00
<b>Gjendja në 31.12.2022</b>	<b>33,986,115</b>

Vlera e debitorëve ne vitin 2022 në krahasim me vitin 2021 ka pësuar një rritje prej 19,821,535 lekë në të cilën ka ndikuar rritja e debitorëve të tatim taksave në vlerën 15,931,835 lekë, nga IKMTV në vlerën 3,850,000 lekë dhe nga individ në vlerën 39,700 lekë.

Analiza e gjendjes së llog. “Debitorë të ndryshëm” dhe lëvizjet e pësura në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/1, bashkëlidhur.

**Situata:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,986,115 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, është paraqitur më pak për vlerën 59,718,570lekë (nuk janë përfshirë vlera e plotë e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore për diferencë në vlerën 54,266,148

lekë, detyrimet për qira objekti në vlerën 2,526,000 lekë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve në vlerën 1,854,317 lekë dhe detyrimet për qira tokë bujqësore në vlerën 1,072, 105 lekë) në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30, ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, germa “g”.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë**

**-Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa tarifa vendore, qira tokash dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit si dhe, të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.

**Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”,** në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 46,772,800 lekë e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, për detyrime paga, tatime taksa, sigurime shoqërore në vlerën 35,055,619 lekë kreditorë të ndryshëm dhe detyrime për tu paguar në vlerën 11,717,181 lekë.

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 46,772,800 lekë, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare për vlerën 275,277,960 lekë, pasi kjo llogari është pasqyruar në vlerën 322,050,760 lekë, në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 59.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

**Aktivet Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20 “Aktivet Afatgjata Jo materiale”,** përbëhen nga llog.202 “Studime dhe kërkime”, në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën



prej 24,289,594 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,969,655 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 36,435,713 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 40,345,713 lekë, ku diferenca në rritje prej 3,910,000 lekë është krijuar gjatë vitit 2022, e analizuar paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/2, bashkëlidhur.

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “*Studime dhe projekte*”, e pasqyruar në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 40,345,713 lekë, konstatohet se në këtë llogari ka projekte për ndërtim e rikonstrukcion ujësjellësi, ndërtesa dhe rrugë e rrjete , në vlerën 36,435,713 lekë, të cilët janë trashëguar nga ish-Komunat sot Nj/Administrative të Bashkisë Gjirokastër, për të cilat nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në përdorim dhe vlerat e tyre të sistemoheshin në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më pak për vlerën 36,435,713 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”, *Aneksi 1 “Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik” Pika 2. Klasa 2, “Aktivet afatgjata” (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: “Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivitetit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm: a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicioni financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivitetit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera që i shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivitetit (kosto projektimi, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivitetit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastër, të kryejë zberthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivitet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

### **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llog 210 “Toka, Troje Terrene”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, paraqiten në vlerën 13,743,625 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,743,625 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2021, paraqiten në vlerën 13,743,625 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 13,743,625 lekë, e analizuar paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/3, bashkëlidhur.

**Llog 211 “Pyje, Plantacione”** paraqitet me vlerë neto si në mbyllje të vitit 2021 dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 0 lekë.

**Llog 212 “Ndërtesa konstruksione”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, paraqiten në vlerën 855,263,204 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 816,939 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 1,101,157,656 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën

1,096,484,563 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 4,673,093 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

- 1- Objekti “Mbikëqyrje “Rikonstruksioni i fushës së vjetër” në vlerën 102,932 lekë
- 2- Objekti “Mbikëqyrje “Ndërhyrje në shkollën “Koto Hoxhi” në vlerën 45,816 lekë
- 3- Objekti “Mbikëqyrje “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Lazarat” në vlerën 126,249 lekë
- 4- Objekti “Kolaudim “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Lazarat” në vlerën 15,222 lekë
- 5- Objekti “Kolaudim “Ndërhyrje në shkollën “Koto Hoxhi” në vlerën 5,498 lekë
- 6- Objekti “Ndërhyrje në shkollën “Koto Hoxhi” në vlerën 2,051,508 lekë
- 7- Objekti “Rikonstruksioni i shkollës 9-vjecare Lazarat” në vlerën 1,267,732 lekë
- 8- Objekti “Mbikëqyrje “Ngritja e dy parcelave për të shërbyer si herbarium na funksion të zhvillimit të trajnimeve dhe rehabilitimi i zonës përreth” në vlerën 124,894 lekë.
- 9- Objekti “Kolaudim “Ngritja e dy parcelave për të shërbyer si herbarium na funksion të zhvillimit të trajnimeve dhe rehabilitimi i zonës përreth” në vlerën 12,909 lekë.
- 10- Objekti “Ngritja e dy parcelave për të shërbyer si herbarium na funksion të zhvillimit të trajnimeve dhe rehabilitimi i zonës përreth” në vlerën 920,334 lekë, e analizuar sipas artikujve kontabël, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/4, bashkëlidhur.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 162 artikuj kontabël, në vlerën 50,552,353 lekë, nuk është e analizuar sipas ndërtimeve dhe konstruksioneve, nuk ka informacioni për çdo objekt, në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit por janë trajtuar si aktive më vete, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30,31.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuara.

**Llog 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, paraqiten në vlerën 1,500,757,766 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 1,497,754,617 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto

historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 2,019,415,999 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 1,943,589,958 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 75,826,041 lekë, që përbëhet shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si:

- 1- Objekti “Mbikëqyrje "Zgjerim i ndriçimit rrugor në fshatra" në vlerën 145,530 lekë.
- 2- Objekti “Mbikëqyrje "Rikonstruksion i rrugës" Zeman Haska" në vlerën 372,343 lekë.
- 3- Objekti “Mbikëqyrje "Rehabilitimi i kanaleve vaditëse" në vlerën 219,597 lekë.
- 4- Objekti “Kolaudim "Rikonstruksion i rrugës" Zeman Haska" në vlerën 55,826 lekë.
- 5- Objekti “Mbikëqyrje “Rikonstruksion i kanalit vaditës të fshatit Zhulat” në vlerën 1,220,530 lekë.
- 6- Objekti “Kolaudim “Rikonstruksion i kanalit vaditës të fshatit Zhulat” në vlerën 32,939 lekë.
- 7- Objekti “Rikonstruksion i kanalit vaditës të fshatit Zhulat” në vlerën 64,784,718 lekë.
- 8- Objekti “Rehabilitimi i kanaleve vaditëse” në vlerën 8,994,558 lekë, e analizuar sipas artikujve kontabël, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/5, bashkëlidhur.

**Situata:** Nga auditimi u konstatua se për llogaria 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*” e analizuar në kontabilitet për 261 artikuj kontabël, në vlerën 2,019,415,999 lekë, nuk është e analizuar sipas objekteve, nuk ka informacioni për çdo objekt, në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit por janë trajtuar si aktive më vete, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30,31.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 213 “*Rrugë rrjete vepra ujore*”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuar.

**Llog 214 “Instalime teknike, makineri, paisje, vegla pune”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, paraqiten në vlerën 12,962,738 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 19,036,695 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 87,324,165 lekë dhe në vitin

2021 në vlerën 86,288,352 lekë. Kjo llogari është shtuar për vitin 2022 në vlerën 16,292,016 lekë për blerje me pagesë si më poshtë:

1. Set kompjuterësh në vlerën 1,096,280 lekë.
2. Skaner në vlerën 2,876,401 lekë.
3. Panele fotovoltaik në vlerën 1,174,680 lekë.
4. Mjete fonie në vlerën 534,000 lekë.
5. Vegla pune vinç në vlerën 200,000 lekë.
6. Kontenierët në vlerën 3,947,400 lekë.
7. Mjete pune furnele gazi në vlerën 12,000 lekë
8. Mjete bolier në vlerën 16,800 lekë.
9. Dhome tharje në vlerën 4,800,000 lekë.
10. Shtesa në aktive në vlerën 1,634,455 lekë.

Është pakësuar për vlerën 15,256,203 lekë për objekte si më poshtë:

1. Skrep në vlerën 5,515,165 lekë.
2. Eskavator në vlerën 8,438,260 lekë
3. Lëvizje brenda aktiveve në vlerën 1,302,778 lekë, e analizuar sipas artikujve kontabël, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/6, bashkëlidhur.

**Llogaria 215 “Mjete transporti”** paraqitet me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 29,706,166 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 42,790,538 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” në mbyllje të vitit 2022 në vlerën prej 81,378,031 lekë dhe në vitin 2021 në vlerën 54,398,861 lekë.

Kjo llogari është shtuar për vitin 2022 në vlerën 29,077,872 lekë për blerje me pagesë si më poshtë:

1. Minifugon për teatrin në vlerën 1,306,447 lekë.
2. Automjet teknologjik për mbetjet në vlerën 10,134,000 lekë.
3. Autovinc me kosh në vlerën 2,520,000 lekë.
4. Automjet me nr. shasia LŴ5L1E467KMC0125 në vlerën 1,164,000 lekë.

Shtesa brenda sistemit të aktiveve

1. Skrepi në vlerën 5,515,165 lekë.
2. Eskavator në vlerën 8,438,260 lekë

Është pakësuar për vlerën 2,098,702 lekë për mjete si më poshtë:

1. Transferuar Xhip Pajero, në vlerën 1, 415, 882lekë,
2. Sistemim brenda sistemit të aktiveve si rezultat i dublikimit në kontabilitet “Kamionçinë vit 2012”, në vlerën 682,820 lekë, e analizuar sipas artikujve kontabël, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/7, bashkëlidhur.

**Llogaria kontabël 218 “Inventar ekonomik”.** Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga shkollat, kopshtet, çerdhet, njësitë administrative të Bashkisë. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarisë 218 “Inventar ekonomik” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 73,504,918 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 67,158,683 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 130,608,965 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën kontabël 141,052,401 lekë.

Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 13,337,611 lekë.

1. Materiale zyre (kompjuterat), në vlerën 1,397,400lekë,
- Materiale zyre (tavolina, karrige etj), në vlerën 9,844,240lekë,
3. Materiale zyre (panele ekspoziti), në vlerën 795,000lekë,

Shtesa brenda sistemit të aktiveve

1. Materiale zyre (tavolina, karrige), në vlerën 1,300,971 lekë,

Është pakësuar për vlerën 2,894,175 lekë si më poshtë:

1. Materiale zyre (tavolina, karrige), në vlerën 2,894,175lekë, e analizuar sipas artikujve kontabël, paraqitet në pasqyrën Aneks nr. 3/8, bashkëlidhur.

**Gjendja e aktiveve afatgjata në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2022 paraqiten në Formatin nr.7/A “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata ( kosto historike)” të PF si më poshtë:**

Nr Refn Ilog	EMERTIMI	Gjendje ne fill viti	Shtesa gjate vitit ushtrimor, Kosto Historike				Pakësime gjate vitit , Kosto Historike			Gjendja ne mbyllje te ushtrimor
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese jashtë sistemit	Lëvizje brenda aktiveve	Gjithësej	Nx.jasht përdorimit	Pakësime të tjera	Gjithsej	
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	36,435,713	1,990,000	1,920,000	0	3,910,000	0	0	0	40,345,713
201	Prime te emision e rimbursimit te huave					0			0	
202	Studime dhe kërkime	36,435,713	1,990,000	1,920,000		3,910,000			0	40,345,713
203	Koncesion, patenta ,licenca e ngjashme					0			0	
21- 28	II. TAAGJ/ MATERIALE	3,325,114,324	123,952,237	0	15,254,396	139,206,633	0	20,249,080	20,249,080	3,444,071,877
210	Toka,troje, Terene	13,743,625				0			0	13,743,625
211	Pyje, Kullota Plantacione					0			0	0
212	Ndërtime e Konstruksione	1,096,484,563	4,673,093			4,673,093			0	1,101,157,656
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	1,943,589,958	75,826,041			75,826,041			0	2,019,415,999
214	Instalime tek,makiner,paisje, vegla pune	86,288,352	16,292,016			16,292,016	0	15,256,203	15,256,203	87,324,165
215	Mjete transporti	54,398,861	15,124,447			29,077,872		2,098,702	2,098,702	81,378,031
216	Rezerva shtetore					0			0	0
217	Kafshe pune e prodhimi					0			0	0
218	Inventar ekonomik	130,608,965	12,036,640		1,300,971	13,337,611		2,894,175	2,894,175	141,052,401
24	Aktive te Qend.te trupezua te demtuara					0			0	0
28	Caktime					0			0	0
	TOTALI (I + II)	3,361,550,037	125,942,237	1,920,000	15,254,396	143,116,633	0	20,249,080	20,249,080	3,484,417,590

**Aktiveve afatgjata materiale, pa titull pronësie.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se, nga 431 artikuj kontabël të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 31,343,317,280 lekë, Bashkia Gjirokastrë, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 , Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35.

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia:** E lartë.

**Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë duhet të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Gjirokastrë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Mbi rivlerësimin e aktiveve materiale afatgjata.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në

periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 12 objekte variojnë nga 3,907 lekë deri në 86,215 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”, sipas të dhënave në pasqyrën si më poshtë:

Nr	Objekti	Vlera me kosto historike lekë
1	Vater kulture Nj Ad Lunxheri	7,140
2	Godina e zdruktarise	84,112
3	Godina e magazinës	52,570
4	Ofiçina Zyrat	8,411
5	Godina Bateri-Saldim	20,298
6	Godina e Rojeve	3,907
7	Magazina e Çimentos / Anekset	15,000
8	Godina ish Agjensia	26,785
9	Godina e Varrezave te Dëshmoreve	12,617
10	Godina e ofiçinës	86,215
11	Kopështi Kakoz	70,000
12	Kopështi Zyra e pleqërisë	50,000

**Kriteri:** Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”.

**-Impakti:** Ndikim në informacionin kontabël dhe paraqitje jo e saktë e vlerave të llogarive.

**-Shkaku:** Mungesa e zbatimit me rigorozitet i udhëzimit për procedurat e paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare.

**-Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastër duhet të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

**Llogaria 219 “Amortizimi i AAGJM & AAJM:** Kjo llogari sipas pasqyrave financiare të Bashkisë Gjirokastër në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën (1,003,024,296) lekë. Krahasuar me vitin 2021 llogaria 219 “Amortizimi i aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara” paraqitet me shtesë prej (165,992,201) lekë, shtesë e cila ka ardhur si rezultat:

Llogaria 202 Amortizim i studimeve e kërkimeve 4,229,939 lekë

Llogaria 212 Ndërtime e konstruksione 42,996,815 lekë

Llogaria 213 Rruge rrjete vepra ujore 78,829,190 lekë

Llogaria 214 Instalime teknike,pajisje,vegla pune 7,313,689 lekë

Llogaria 215 Mjete transporti 15,254,062 lekë

Llogaria 218 Inventari ekonomik 17,368,506 lekë

### Pasqyra statistikore nr. 7.b “Akivet afatgjata me vlerë neto”

Nr. Reference Llogarie	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	3	4	5	6	7	8	9	10

Nr. Reference Llogarie	Teprica Neto	Shtesat gjate vitit		Pakësimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizimi	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
20	24,289,594	3,910,000	4,229,939	0	0	40,345,713	16,376,058	23,969,655
201	0					0	0	0
202	24,289,594	3,910,000	4,229,939			40,345,713	16,376,058	23,969,655
203	0					0	0	0
21- 28	2,811,173,401	139,206,633	161,762,262	20,249,080	14,289,931	3,444,071,877	986,648,238	2,457,423,640
210	13,743,625					13,743,625	0	13,743,625
211	0					0	0	0
212	855,263,204	4,673,093	42,996,815			1,101,157,656	284,218,174	816,939,482
213	1,500,757,766	75,826,041	78,829,190			2,019,415,999	521,661,382	1,497,754,617
214	12,962,738	16,292,016	7,313,689	15,256,203	12,351,832	87,324,165	68,287,471	19,036,695
215	29,706,166	29,077,872	15,254,062	2,098,702	1,359,264	81,378,031	38,587,493	42,790,538
216	0		0			0	0	0
217	0		0			0	0	0
218	73,504,918	13,337,611	17,368,506	2,894,175	578,835	141,052,401	73,893,718	67,158,683
24	0					0	0	0
28	0					0	0	0
Totale	325,234,984							

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivit të llogaritura nga Bashkia Gjirokastrë, janë si më poshtë:

ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5 %
inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20 %
për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25 %
për mjetet e transportit	20 %

**Llogaria 231 “AAGJM Investime në proces”** paraqitet në mbyllje të vitit 2021, në vlerën 187,811,983 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 261,728,261 lekë, të cilat përfaqësojnë investime për kontrata të cilat nuk kanë përfunduar brenda vitit ushtrimorë 2022.

Analiza e këtyre investimeve sipas llogarive dhe kontratave paraqiten në pasqyrën si më poshtë:

Analizave llogarisë 231 “AAGJM Investime në proces”, sipas objekteve.	Çelja 01.01.2022	Shtesa gjatë vitit 2022	Pakësime gjatë vitit 2022	Gjendja me 31.12.2022
Shtëpi e Kadaresë ( 30.05.2000 )	4,991,272			4,991,272
Rikonstruksion i varrezave të dëshmorëve dhe rruga hyrëse	978,420			978,420
Lyerje dhe riparime në shkolla 2014	2,141,784			2,141,784
Lyerje dhe riparime të ndryshme në shkolla e kopeshte 2015	935,280			935,280
Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit	15,999,953			15,999,953
Ujësjiellësi Lazarat	101,671,474	60,632,000		162,303,474
Kanali vaditës Zhulat (Ministri linje)	51,383,290	13,401,428	64,784,718	-
Rikonstruksioni i rrugicës "Kapo Baco"	3,300,000	3,352,728		6,652,728.00
Rehabilitimi i kanaleve vaditëse	3,967,433	5,027,125	8,994,558	-
Modernizimi i ndriçimit rrugor publik Gjirokastrë	2,443,077	4,227,177		6,670,254.00
Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës , pranë rrugës nacionale Gjirokastrë - Kakavi				
		39,247,169		39,247,168.60
Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara		3,745,434		3,745,434
Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme "Asim Zeneli" dhe shkolla		18,062,493		18,062,493

Analizave llogarisë 231 "AAGJM Investime në proces", sipas objekteve.	Çelja 01.01.2022	Shtesa gjatë vitit 2022	Pakësime gjatë vitit 2022	Gjendja me 31.12.2022
"Drita"				
TOTALI	187,811,983	147,695,554	73,779,276	261,728,261

### Sipas burimeve të financimit, sipas Formatit nr. 6, paraqiten si më poshtë:

I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	325,234,983	147,695,554	211,202,276	261,728,261
230	Shpenzime per Aktive Afatgjata jo materiale	0			0
231	Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale	187,811,983	147,695,554	73,779,276	261,728,261
25,26	Shpenzime per Aktive Afatgjata Financiare	137,423,000	0	137,423,000	0
25	Huadhenie dhe nenhuadhenie				
26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet	137,423,000		137,423,000	
II.	BURIMET PER INVESTIME	187,811,983	73,779,276	147,695,554	261,728,261
105	1.Grante te brendshme kapitale	187,811,983	73,779,276	147,695,554	261,728,261
1050	Grante kapitale nga Buxheti	0	8,994,558	51,854,199	42,859,641
1051	Grante kapitale nga nivele te tjera	0	64,784,718	95,841,355	31,056,637
1052	Kontribute te te treteve per investime	0	0	0	0
1059	Grante te brendshme kapitale ne natyre		0	0	0
106	2.Grante te huaja Kapitale	0	0	0	0
1060	Nga qeveri te huaja	0	0	0	0
1061	Nga institucione ndërkombëtare	0	0	0	0
1069	Grante te huaja ne natyre	0	0	0	0
14	3.Grante kapitale per investime per te trete	0	0	0	0
145	Grante brendsh. kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
146	Grante te huaja kapitale per pjesm. ne invest. ne te trete	0	0	0	0
11	4.Fonde te tjera te veta.	0	0	0	0
111	Fonde rezerve	0	0	0	0
115	Caktim fondi per investime nga rezultati I vitit				0
116	Te ardhura nga Shitja e aktiveve te qëndrueshme	0	0	0	0
12	5.Rezultati I Mbartur				
16,17	6.Huamarrje	0	0	0	0
16	Huamarrje e Brendshme	0	0	0	0
17	Huamarrje e Huaj	0	0	0	0
III.	BALANCA	-137,423,000	-73,916,278	-63,506,722	0

### PASIVET (DETYRIMET)

#### Pasivet Afatshkurtra

Llogaritë e klasës 4, në pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme ato paraqesin detyrimet e Bashkisë Gjirokastër më 31.12.2022, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2022, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2022, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., si më poshtë:

Llogaritë		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca/ndryshimi
401-408	Furnitorë e llogari të lidhura me to			
42	Detyrime ndaj personelit	25,380,054	23,693,898	1,686,156
431	Detyrime ndaj shtetit tatim taksa	1,204,062	1,315,614	(111,552)
435	Sigurime shoqërore	7,449,684	7,028,666	421,018
436	Sigurime shëndetësore	1,021,819	963,121	58,698
464	Detyrime për tu paguar për bl. letrave me vlerë	828,000	1,013,000	
466	Kreditorë për mjete në ruajtje	23,085,920	27,016,953	
467	Kreditorë të ndryshëm	10,889,181	13,628,386	
4341	Të tjera operatione me shtetin (detyrime)	34,814,115	15,677,580	
475	Të ardhura për tu regjistruar vitet pasardhëse			
	Gjendja më fund të periudhës	104,672,835	90,337,218	



**Llogaria 42, “Detyrime ndaj personelit”,** sipas pasqyrave financiare, paraqitet në vlerën 25,380,054 lekë dhe përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

<b>Llog. 42 "Detyrime ndaj personelit"</b>	
Çelje e vitit 2022	23,693,898
Shtesa (K)	297,713,221
Pakësime (D)	296,027,065
Gjendja në 31.12.2022(K)	25,380,054

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
1	06.01.2023	1,824,616.00
10	06.01.2023	6,125,809.00
11	06.01.2023	877,931.00
12	06.01.2023	158,286.00
13	06.01.2023	108,323.00
14	06.01.2023	111,709.00
15	06.01.2023	513,947.00
16	06.01.2023	5,212,238.00
17	06.01.2023	249,526.00
18	06.01.2023	43,013.00
19	06.01.2023	9,290.00
2	06.01.2023	1,132,802.00
20	06.01.2023	12,000.00
21	06.01.2023	10,000.00
3	06.01.2023	2,224,121.00
4	06.01.2023	1,829,240.00
5	06.01.2023	45,317.00
6	06.01.2023	3,291,232.00
7	06.01.2023	224,934.00
8	06.01.2023	64,722.00
9	06.01.2023	1,310,998.00
<b>Totali</b>		<b>25,380,054</b>

**Llogaria 431, “Detyrime ndaj shteti për tatim taksa”,** paraqitet në vlerën 1,204,062 lekë dhe përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor.

<b>Llog. 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa"</b>	
Çelje e vitit 2022	1,315,614
Shtesa (K)	14,466,063
Pakësime (D)	14,577,615
Gjendja në 31.12.2022 (K)	1,204,062

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2023, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
22	10.01.2023	1,204,062
<b>TOTALI</b>		<b>1,204,062</b>

**Llogaria 435, “Sigurime shoqërore”** dhe llogaria 436 “Sigurime shëndetësore” paraqet vlerën e pa paguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor 2022 që paguhen në muajin janar 2023 dhe janë përkatësisht në vlerat 7,449,684 lekë dhe 1,021,819 lekë.

<b>Llog. 435 "Sigurime shoqërore"</b>	
Çelje e vitit 2022	7,028,666
Shtesa	88,715,883
Pakësime	88,294,865
Gjendja në 31.12.2022	7,449,684
<b>Llog. 436 "Sigurime shëndetësore"</b>	
Çelje e vitit 2022	963,121
Shtesa	12,008,562
Pakësime	11,949,864
Gjendja në 31.12.2022	1,021,819

Konkretisht, sipas dokumenteve të bankës të muajit Janar 2022, ka rezultuar:

Urdhër shpenzimi		Vlera
Numër	Datë	
22	10.01.2023	3,010,387
Totali		3,010,387

**Llogaria 464 “Detyrime për tu paguar për bl. e letrave me vlerë”**, përfshin detyrimet e letrave me vlerë që janë furnizuar dhe nuk janë përdorur deri në fund të vitit 2022, për .....në vlerën 828,000 lekë, lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten si më poshtë:

<b>Llog. 464 " Detyrime për tu paguar për bl. e letrave me vlerë "</b>	
Çelje e vitit 2022	1,013,000
Shtesa (K)	1,053,000
Pakësime (D)	1,2380,00
Gjendja në 31.12.2022 (K)	828,000

**Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”**, përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogaritje paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 27,016,953 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 23,085,920 lekë. Për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit në mënyrë analitike, e cila paraqitet, në pasqyrën Aneks nr. 3/9, bashkëlidhur.

**Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm”**, paraqiten detyrimet për fatura të palikujduara dhe vendime gjykate të cilat për vitin 2022 paraqiten në shumën 10,889,181 lekë, në mënyrë analitike paraqiten në pasqyrën Aneks nr. 3/10, bashkëlidhur.

**Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”**, përfaqëson detyrime për tu derdhur nga debitorë të ndryshëm që për vitin 2022 është e pasqyruar, për vlerën 34,814,115 lekë.

**Fondi i konsoliduar për vitin 2022, sipas formatit nr.1 paraqitet në pasqyrën si më poshtë:**

D	FONDI I KONSOLIDUAR :	3,078,472,708	3,086,705,674
101	Teprica(Fondi i akumuluar)/Deficiti i akumuluar	2,543,476,915	2,715,828,715
12	Rezultatet e mbartura	0	0
85	Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore	273,267,532	183,064,976
111	Rezerva	0	0
115	Nga Fondet e veta te investimeve	0	0
15	Shuma te parashikuiara per rreziqe e Zhvleresime	0	0
105	Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme	261,728,261	187,811,983
106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja	0	0
107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim	0	0
109	Rezerva nga Rivlersimi i Aktiveve Afatgjata	0	0
	Te Tjera	0	0

**Analizë: Formati nr.2 “Pasqyra e performancës financiare” paraqet llogaritë e të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike.**

**Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2022**, të cilat në total janë në vlerën 1,266,071,100 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarin Gjirokastër paraqitet më poshtë:

**Gjendja e llogarisë sintetike 70 “Të ardhurat nga taksat dhe tatimet”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 88,142,289 lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7000 “Tatim mbi të ardhurat personale”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 9,621,485 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**- Gjendja e llogarisë 7002 “Tatim mbi biznesin e vogël”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 225,665 lekë, e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7020 “Tatim mbi pasurinë së paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 34,354,227 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7021 “Tatim mbi shitjen e pasurisë së paluajtshme”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,965,636 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7035 “Taksë vendore mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 39,975,276 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7204 “Pjesmarrje në tatimet nacionale”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 21,475,548 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**Gjendja e llogarisë sintetike 71 “Të ardhurat jo tatimore”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 97,310,003 lekë, i cili kuadron me Aktrakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7109 “Të tjera nga ndërmarrja dhe pronësia”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 6,504,845 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7110 “Tarifë administrative dhe rregullatore”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 45,026,653 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7111 “Të ardhura sekondare e pagesa shërbimesh”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 35,757,589 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7113 “Të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 5,347,185 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7114 “Të ardhura nga biletat”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 3,916,800 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7115 “Gjoha kamatëvonesa, sekuestri zhdëmtime”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 756,931 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 7207 “Sponsorizime”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 9,954,906 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**-Gjendja e llogarisë analitike 787 “Tërheqje nga seksioni i investimeve”** pasqyrohet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 11,810,318 lekë e cila e cila rakordon me të njëjtin zë në aktrakordimin me thesarin.

**Analiza e shpenzimeve në vitin 2022 , të cilat në total janë në vlerën 992,803,568 lekë paraqitet më poshtë:**

**Gjendja e llogarisë 600 ‘Paga, shpërblime e të tjera personeli’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 350,488,979 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 350,488,979 lekë diferenca nuk ka.

**Gjendja e llogarisë 601 ‘Kontribute për sigurime’** për vitin 2022, paraqitet në bilanc në vlerën 58,353,598 lekë dhe sipas aktrakordimit me thesarin është në vlerën 58,353,598 lekë , diferenca nuk ka.

**Gjendja e llogarisë 602 “Blerje mallra e shërbime”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 155,688,001 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 155,688,001 lekë , diferenca nuk ka.

**Gjendja e llogarisë së fondeve 603 “Subvencione”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 923,000 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 923,000 lekë, diferenca nuk ka.

**Gjendja e llogarisë së fondeve 604 “Transferime korente të brendshme”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 25,463,673 lekë dhe sipas aktrakordimit me Thesarin është në vlerën 25,463,673 lekë, diferenca nuk ka.

**Gjendja e llogarisë së fondeve 606 “Transferime për Buxhetet familjare të Individëve”** paraqitet në bilanc për vitin 2022 në vlerën 219,437,682 lekë, e cila rakordon me Aktrakordimin me Thesarin.

Për vitin 2022 totali i të ardhurave në vlerë është 1,266,071,100 lekë dhe totali shpenzimeve është 992,803,568 lekë. Diferenca e tyre në vlerën 273,267,532 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 “Rezultatit të ushtrimit”.

**Për vitin 2022**, numri i punonjësve është miratuar me vendimi të Këshillit të Bashkisë në total 623 punonjës nga të cilët 32 drejtues, 31 specialistë, 59 teknik dhe 462 nëpunës të thjeshtë dhe punëtorë, me fond page gjithsej 351,238,134 lekë.

#### **Rregullariteti i veprimeve të kryera nëpërmjet bankës**

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve.

Në përgjithësi përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listë pagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. U krye verifikimi i likuidimeve të kontratave për mallra, shërbime e punime ndërtimi ku rezultoi se ato janë kryer brenda afateve të paraqitjes së faturës për të cilën Drejtoria e Financës ka plotësuar urdhër-shpenzime për likuidimin e tyre.

#### **Nënpika 2.3.4 e programit. Auditim mbi administrimin e aseteve, procedura e inventarizimit si dhe regjistrimin e tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës.**

**Situata:** Nga auditimi ka rezultuar se: **Bashkisë Gjirokastër**, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Gjirokastër, të Qarkut Gjirokastër”, i është miratuar lista inventarit me 240 fletë dhe përfundon me numër rendorë 1713.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Gjirokastër. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 1700 (njëmijë shtatëqind) dhe përbëhet me 242 (dyqindedyzetedy) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastër, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

**Ish Komunës Cepo sot Njësia Administrative Cepo e Bashkisë Gjirokastër**, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Cepo, të Qarkut Gjirokastër”, i është miratuar lista inventarit me 83 fletë dhe përfundon me numër rendorë 612.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësisë Administrative Cepo, në Bashkinë Gjirokastër. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe

mbaron me nr. 612 (gjashtëqindedybëdhjetë) dhe përbëhet me 83 (tetëdhjetetë) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

**Ish Komunës Lazarat sot Njësia Administrative Lazarat e Bashkisë Gjirokastrë**, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lazarat, të Qarkut Gjirokastrë”, i është miratuar lista inventarit me 31 fletë dhe përfundon me numër rendorë 157.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se me VKB nr. 28, datë 13.10.2017, ka vendosur miratimin e listës së pronave të paluajtshme shtetërore që ndodhen në territorin e Njësies Administrative Lazarat, në Bashkinë Gjirokastrë. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr. 157 (njëqindpesëdhjeteshtatë) dhe përbëhet me 31 (tridhjetenjë) fletë, vendim ky i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Gjirokastrë, me shkresë nr. 969/1, datë 19.05.2017 dhe ky vendim me shkresë nr. 3376, datë 14.06.2017 është dërguar, Ministrisë së Punëve të Brendshme, Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike.

**Ish Komunës Lunxheri sot Njësia Administrative Lunxheri e Bashkisë Gjirokastrë**, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Lunxheri të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 701 prona.

Numrat rendorë 1-5, 701 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 16953 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 1670 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë ,6-7 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e kulturës, në pronësi, me sipërfaqe totale 6928 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 88 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë , 8 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 32 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë ,10-14 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13763 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë , 15-19, 21, 29, 30, 38, 62, 63, 66-68, 80-82, 85, 89, 91-101, 113-116, 147, troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 43607 m<sup>2</sup>

Numrat rendorë , 20, 24, 25, 28, 34-37, 39-46, 48-53, 57-59, 61, 64, 65, 69-79, 83, 84, 86-88, 90, 102-112, 118, 121-146, 149, 150, 154-446 Infrastrukturë (rrugë vendore, sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, sheshe me sipërfaqe 202969 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë, 22, 23, 26, 27, 31-33, 47, 54-56, 60, 117, 148, 151-153 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 15952 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 2704 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë , 447-449 Prona që përdoren për realizimin e programeve në fushën e mbrojtjes civile, në pronësi, me sipërfaqe totale 1520 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 834 m<sup>2</sup>

Numrat rendorë 450-451 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për pronat si më sipër nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

**Ish Komunës Picar sot Njësia Administrative Picar e Bashkisë Gjirokastrë**, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Picar të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 439 prona. Numrat rendorë, 1-4 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1501 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 5-8 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 269 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 10,20-25,27,28,30,34-38,302- 406 Infrastrukturë (sheshe, lulishte

dhe shërbime publike), rrugë vendore, në pronësi, shesh me sipërfaqe 79629 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë 11-19,26,29,31-33,39 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 10329 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 40-50,55-58,60-67,69-70,72-79 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 3986 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 81-85 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 469 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 86-87 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe totale 5181 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 113 m<sup>2</sup>. Numrat rendorë, 88-92 Varrezat publike, në pronësi. Numrat rendorë, 263-271 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive arë , vreshta dhe pemëtoje), në përdorim, me sipërfaqe 233.6 ha. Numrat rendorë 272-276,281,282,285,286,294, 295,299 (vetëm kanale të treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 546 ha. Numrat rendorë 408-409 Prona që përdoren në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për pronat si më sipër nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

**Ish Komunës Antigone sot Njësia Administrative Antigone e Bashkisë Gjirokastrë**, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Antigone të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 259 prona.

Numri rendor, 20-27, 252 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe totale 12225 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 1408 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 28-30 Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore , në pronësi, me sipërfaqe totale 5720 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 440 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 31-33 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik në pronësi, me sipërfaqe totale 340 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 300 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 34 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative, në pronësi, me sipërfaqe totale 220 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 216 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 35, 36, 38 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe totale 690 m<sup>2</sup>, nga kjo ndërtesë 270 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 37 Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim, me sipërfaqe 480m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 39 Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 4250 m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 40-43 Varrezat publike, në pronësi, me sipërfaqe 13815m<sup>2</sup>.

Numri rendor, 45-55 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Sip. 24.9 ha i është dorëzuar AKKP-së, në përdorim, me sipërfaqe 770.5 ha.

Numri rendor, 56-60, 64, 72, 75 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive), në pronësi, me sipërfaqe 370 ha.

Numri rendor, 80-220 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.

Numri rendor, 221-226, 253-259 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për pronat si më sipër nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

**Ish Komunës Odrie sot Njësia Administrative Odrie e Bashkisë Gjirokastrë**, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunës Odrie të Qarkut të Gjirokastrë”, i janë kaluar 136 prona.

Numrat rendorë 1,2,4,5,6,8,9,11,12,13,15,16 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive), në përdorim, me sipërfaqe 791 ha.

Numrat rendorë 3,7,10,14,17,75,76,83,84, 89, 92, 95, 96, (vetëm kanalet e treta) Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta), në pronësi, me sipërfaqe 375 ha. Numrat rendorë 18-23 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 563 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë 24-26 Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive, në pronësi, me sipërfaqe ndërtesë 696 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë 27-29 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik, në pronësi, me sipërfaqe 329 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë 30 Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës, në pronësi, me sipërfaqe 250 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë 31-38 Varrezat publike, në pronësi.

Numrat rendorë 39-44 Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore, në pronësi, me sipërfaqe 1218 m<sup>2</sup>.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm trojet) Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji, në përdorim.

Numrat rendorë 45-62 (vetëm sheshet) Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), në pronësi, me sipërfaqe 39958 m<sup>2</sup> Numrat rendorë 98-100 Infrastrukturë (rrugë vendore), në pronësi.

Numrat rendorë 101-102 Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në pronësi.

Për pronat si më sipër nga Sektori i Menaxhimit të Aseteve, **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë.

**Kriteri:** Ligji nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, nenin 12, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”.

**Impakti:** Mungesë të ardhurash nga dhënia me qira e asetëve dhe mungesë informacioni në lidhje me statusin juridik të pronave të transferuara.

**-Shkaku:** Mospërfundim i strukturave përgjegjëse të cilat janë ngarkuar për menaxhimin e asetëve.

**-Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastrë, Cepo dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

**Pika 2.4 e programit: Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

- *Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.*

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, sipas Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Projekt Raporti Auditimit.

- *Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.*

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.10.2022 – 31.12.2022 nga subjekti Bashkia Gjirokastrë, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej **12** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit **168,061** mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

Periudha viti 202	Proc me vlere te larte			Diferenca me fond limit	
	Nr.	Fond limit	Vlere kontrate	Vlera	%
<b>I. Procedura te realizuara gjithsej, nga e cila</b>	<b>12</b>	<b>168,061</b>	<b>139,034</b>	<b>29,026</b>	<b>82.7</b>
- Të hapura	3	133,764	120,944	12,819	90.2
- E hapur e thjeshtuar	9	34,296	18,090	16,206	52.75
<b>Vlerësuar për auditim</b>	<b>4</b>	<b>145,257</b>	<b>120,944</b>		
Shprehur ne %	33	86.4	86.9		

Diferenca midis fondit limit dhe vlerës së kontratave të lidhura është me një diferencë për verën 29,026 mijë lekë ose 82.7% e vlerës së fondit.

Mbi bazën e materialitetit të bërë nga grupi i KLSH, nga **12** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 168,061 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim nga **4 procedura** me fond limit **145,257** mijë lekë ose 86.4% e totalit të procedurave.

Nga auditimi i **4 procedura** me fond limit **145,257** mijë lekë janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **3** procedura me vlerë të fondit limit **89,202** mijë lekë ose 61.4 % e vlerës së fondit limit të audituar. Shkeljet kanë konsistuar në këto drejtime:

**Titulli i gjetjes 1:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP për hartimin e kriterëve të pjesëmarrjes kundrejt operatorëve ekonomikë, duke përdorur kriterë të ekzagjeruar, të panevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe të pa-argumentuara, konstatuar kjo në **2** procedura prokurimi.

**Situata:** Nga auditimi i **4** procedura me fond limit **145,257** mijë lekë të vlerësuar për auditim për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore në **aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me procedurat e zhvilluara, konkretisht:



**1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstrukcion rruga Zhulat 1”, me fond limit 48,561,521 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “E.I.” shpk me vlerë kontrate 38,296,731 lekë.**

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 9.9.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 667, datë 22.9.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 24.10.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në auditimin e kriterëve të vendosura janë konstatuar kriterë jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, respektivisht:

**Pika 2.4 e DST, për kategoritë e licencave N.P – 12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit) dhe N.S – 18 A (Punime topogjeodezike), pasi të dy këto kategori licensë janë ezauruar gjatë fazës së hartimit të projektit dhe nuk janë të nevojshme në zbatimin e kontratës.**

**Në pikën 2.4 të DST është kërkuar që OE të kenë Ing mjedisi 1 ( një ) dhe në pikën 2.7 të DST është kërkuar që OE të ketë në listëpagesat e muajit Qershor 2022- Gusht 2022, Hidraulik 1 (një).**

Aplikimi i këtyre kriterëve është jo mirëargumetuara, pasi referuar zërave të preventivit nuk ka punime që kërkojnë ing. Mjedisi dhe hidraulik, ku ky i fundit aplikohet zakonisht në kontrata ndërtimi për objekte social kulturore.

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: **zj. A.LL me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Procedurave (juriste), zj. L.SH me detyrë specialist në Sektorin e procedurave (ekonomist) dhe z. A.P.me detyrë specialist në Sektorin e Projekteve në DPZHT (ing. Ndërtimi).**

Nga subjekti audituar Bashkia Gjirokastrë me shkresën nr. 9136prot, datë 26.09.2023 janë paraqitur kundërshti nga NJP (L.SH, A.LL., A.P.), për Projektraport Auditimin, duke kundërshtuar se:

**Pretendimet e subjektit:**

*Në lidhje me pikën e licensave sqarojmë se referuar VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret e procedurave të dhënies së licensave profesionale...”, janë përcaktuar punimet që përfaqësojnë këto zëra, të cilat gjejnë zbatim dhe në preventiv e paraqitur .*

R.Nr	Q	Nr.An	Emertimi i Punimeve	Njesi	Sasia
1	NS 1	An 39	Prisje strukturore prej betoni	m3	180.00
2	NP 1	3.138	Germine dheu me ekskavator goma 0.25 m3 ne themelegjeresi toke zak kategori 111 me shkerkim ne toke	m3	3.345.00
3	NP1	3.702b	Germine dheu (gropa) sip 10-30 m, shkerim toke, R=4.5 m, mak. pran uqendarsi rrymes)	m3	250.00
4	NP2	3.287	F.V hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm	ton	4.50
5	NP2	3.284	F.V hekur metalike ne b/z	ton	0.67
6	NP2	3.287	F.V hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm	ton	4.50
7	NP2	3.285	F.V hekur betoni i zakonshem Ø >=12	ton	3.30
8	NS5	3.097b	Prisje hekur - T - b/z C - 25/30 me H.D =15-20 M per uqa	m3	39.90
9	NS5	3.097	Prisje hekur - T - b/z C - 25/30 me H.D =15-20 M per uqa	m3	4.00
10	NP2	3.284	Struktura monolite betoni C 20/25 shtesa B trotuar	m3	45.00
11	NP2	3.625	Platini me shkerim 18.000, 10000, shtesa 1	m2	1.200.00
12	NP2	3.319	Kallap me panele shuri per shtesa e trape	m2	1.200.00
13	NS7	A003	Qendrimi i shkrerave per ure me 3 vete ne 1 ana -Vshkrerimet lart e aksesore	m1	80.00
14	NP2	3.22	F.V kopshteruese metalike te shjeshta per fuge shkrerimi	m1	0.85
15	NP2	3.22	F.V kopshteruese metalike te shjeshta per fuge shkrerimi	m1	33.00
16	NP5	3.618	F.V kopshteruese metalike te shjeshta per fuge shkrerimi	m1	11.00
17	NS7	3.638	Panake ure metalik i gatshem	m2	50.00
18	NP2	3.237	Struktura monolite betoni C 12/15 me 20% gurndarsi rrymes)	m3	92.00
19	NP1	3.702b	Germine dheu (gropa) sip 10-30 m, shkerim toke, R=4.5 m, mak. pran uqendarsi ure)	m3	250.00
1	NP1	3.138	Germine dheu me ekskavator goma 0.25 m3 ne themelegjeresi toke zak kategori 111 me shkerkim ne toke	m3	3.345.00
2	NP4	3.211	Shtrese cakelli mbeturine kave t=20cm, derhapur e ndeshur makineri	m3	800.00
<b>QENDRIMI I SHKRERAVE</b>					
1	NP1	3.138	Germine dheu me ekskavator goma 0.25 m3 ne themelegjeresi toke zak kategori 111 me shkerkim ne toke	m3	3.200
2	NP2	3.287	F.V hekur betoni i zakonshem Ø 6 - 10 mm	ton	2
3	NP2	3.285	F.V hekur betoni i zakonshem Ø >=12	ton	2
4	NP2	3.284	F.V hekur metalike ne b/z	ton	2
5	NP4	3.311	Struktura monolite betoni C 12/15 me 20% gurndarsi rrymes)	m3	200
6	NP4	3.311	Struktura monolite betoni C 12/15 me 20% gurndarsi rrymes)	m3	200
7	NP4	3.335	Struktura monolite betoni C 12/15 me 20% gurndarsi rrymes)	m3	200
8	NP2	3.237	Struktura monolite betoni C 12/15 me 20% gurndarsi rrymes)	m3	1.500

*Në lidhje me ing. Mjedisit sqarojmë se përderisa është kërkuar kategori linecës NP-12, kërkohet dhe ing. Mjedisi. Gjithashtu në projekt është parashikuar germën në shtratin e lumit për themele e urës po ashtu dhe mbushje me inerte për të krijuar shtrat të ri lumi. Të dyja këto faktorë ngacmojnë ekuilibrat hidrogjenetik hidrografik botanik dhe zoologjik.*

### **Qëndrim i grupit të KLSH:**

Për sa keni argumentuar, nga subjekti (personat përgjegjës), nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e akt konstatimeve. Referuar dokumentacionit që ju paraqisni (pjesës së situacionit), asnjë nga zërat e punimeve nuk justifikojnë aplikimin e kritereve për kategoritë NP-12 dhe NS-18, pasi nuk ka punime që përfaqësojnë këto zëra. Gjithashtu siç dhe jemi shprehur këto dy kategori janë zbaruar gjatë fazës së hartimit të projektit, duke përfshirë dhe ing, mjedisi, pasi siç dhe vetë ju jeni shprehur në observacion thoni që në projekt është parashikuar ....

*Në projekt është parashikuar zërat në skemat e lumit për shembull e urës po ashtu dhe mbushje me treri për të krijuar shtrat të ri lumit. Të cilat këto faktor ngacmojnë ekuilibrat hidrografiko-ekologjik*

*hidrografik botanik dhe zoologjik sic citohet. Në momentin që këto ekuilibra prishen është e nevojshme që të shpëtohen rekomandimet e dhëna në projektin VNM-30 të cilat lëshohen nga Institut me licencë profesionale të mjedistit rrethmishi është një kriter i mbështetur ligjorisht.*

Nga samësipër pretendimet **nuk qëndrojnë.**

**2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita”,** me fond limit 73,079,408 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “**N.J.B.**” shpk me vlerë kontrate pa TVSh 71,217,249 lekë.

Nga NjP është mbajtur PV nr. --, datë 9.9.2022 për hartimin e dokumenteve të tenderit referuar urdhrin të prokurimit 584, datë 25.8.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, data e zhvillimit të tenderit (datë 5.10.2022), kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarte të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit.

Në auditimin e kritereve të vendosura janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës. Gjithashtu me gjithë ndërhyrjen e NJP, sipas sugjerimeve të APP, nga NJP nuk janë reflektuar të gjitha, duke mos bërë në PV argumentimin e aplikimit të kritereve, konkretisht:

- Pika 2.11 e DST. Është kërkuar që OE të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë: Një inxhinier i pajisur me certifikatë trajnimi për “Përgjegjësinë për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara dhe në mbështetje të nenit 78 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk është domosdoshmërisht që të jenë inxhinier, **por mund të jetë dhe punonjës i thjeshtë por i pajisur me certifikatë.**

Veprime dhe mosveprimet e mësipërme ngarkojnë me përgjegjësi anëtarët e NJP, respektivisht: **zj. A.LL me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Procedurave (juriste), zj. L.SH me detyrë specialist në Sektorin e procedurave (ekonomist) dhe z. A.P. me detyrë specialist në Sektorin e Projekteve në DPZHT (ing. Ndërtimi).**

**Kriteri:** Nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve* dhe 78 *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

### **Ndikimi/Efektiviteti:**

Aplikimi i kritereve jo të mirëargumetuara, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë ose në skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme, veprime të cilat ndikojnë në mos përdorimin e fondeve me efektivitet nga mungesa e konkurrencës.

### **Shkaku:**

Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (*Njësia e Prokurimit*).

### **Rëndësia: E lartë.**

### **Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (*Njësia e Prokurimit*), për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i economicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriterë të vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfituar kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**Titulli i gjetjes 2:** Mos zbatim i akteve ligjore e nënligjore të LPP-së në vlerësimin e ofertave duke kualifikuar OE të cilët nuk i plotësojnë të gjitha kushtet dhe kriteret e pjesëmarrjes, konstatuar kjo në 3 procedura prokurimi.

**Situata:** Nga auditimi i **4 procedura** me fond limit **145,257** mijë lekë të vlerësuara për auditim për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022, janë konstatuar në shkëlqje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej **3** procedura me vlerë të fondit limit **133,764** mijë lekë, ku OE e shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK dhe në përputhje me dispozitat e LPP, konkretisht procedurat:

**1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përmisimin i kushteve të banimit për komunitetin e varfëra dhe të pafavorizuara”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Përmisim i kushteve të banimit për komunitetin e varfëra dhe të pafavorizuara”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 561, datë 16.8.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 561, datë 16.8.2022	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 583, datë 24.8.2022
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur”,	A.LL. L.SH A.P.	A.L. E.T. K.N.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> <b>12,123,198 lekë</b> , financimi nga buxheti shtetit 9,699,113 lekë dhe nga Bashkia 2,424,085 lekë. Financimi në dy buxhete 2022/2023	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “A.” ShPK me vlerën e ofertës 11,430,265 lekë pa TVSh, me afat 84 ditë.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 5.7 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 14.9.2022 REF -39629-08-24-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Financës + Bashkia Gjirokastrë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 3 OE:</b> a- Skualifikuar 2 OE b- Kualifikuar 1 OE:
<b>11. Ankimim</b> Nr. 1103, dt. 12.10.2022 në bashki	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K Nr. 1158, dt. 24.10.2022	<b>13. Përgjigje KPP</b> Nr. 1185/2, dt. 01.12.2022
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 13277, datë 5.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> <b>11,430,265</b> lekë me afat 84 ditë	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Sipas dokumentacionit në dosje, konstatohet se me datë 28.8.2022 është mbajtur PV i hapjes dhe vlerësimi të procedurës. Sipas këtij PV, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrës	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
1	T.	0	<b><u>Skualifikohet:</u></b> Formulari i ofertës ekonomike nuk është sipas shtojcës 1 të DST, pasi keni ofertuar me dy vlera të ndryshme, me një diferencë me të madhe se 2%. Bazuar në nenin 92 të LPP pika 1, nuk lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, si dhe në mbështetje të VKM nr. 285/2021 nëni 82 pika 3 Oferta me gabim aritmetik refuzohen kur shuma absolute ete gjitha korrigjimeve është me e madhe se 2% e vlerës së ofertës ekonomike.
2	Z.	11,827,236	Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare të paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi si me poshtë: Mungon sigurimi I ofertës sipas shtojcë nr.3 të DST. Formulari përmbledhës I vetdeklarimit sipas shtojcës nr.8 nuk është I plote, pasi mungojnë vetdeklarim për punonjësit: 4 Elektracist, 4 Hidraulik; 6 Suvaxhi; 4 Hekurkthyes; 4 Betonist; 2 Hidroizoluese dhe 4 Pllakashtrues
3	A.	<b>11,430,265.35</b>	<b><u>Kualifikohet</u></b>

Në vlerësimin e dokumentacionit të OE të skualifikuar, konfirmojmë se KVO ka vepruar saktë, pasi OE pjesëmarrjes kishin mangësi.

Në përfundim KVO ka vlerësuar si të rregullt shoqërinë “A.” ShPK me Nipt K.....C me vlerë të ofertës **11,430,265.35** leke pa TVSh, kjo sipas shkresës nr. 10459prot, datë 28.9.2022.

Me shkresën nr. 10460prot, datë 28.9.2022 nga AK Bashkia Gjirokastrë është kërkuar subjektit për paraqitje dokumentacioni.

Me shkresën nr. 10954prot, datë

7.10.2022 është plotësuar formular njoftim fituesi, shpallur në buletin e APP nr. 143, datë 17.10.2022.

#### - **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga shoqëria “A.” ShPK në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.3.4 të DST, pasi nga verifikimi për disa nga specialistet kodi sipas listpagesës nuk përputhet me llojin e profesionit të deklaruar, konkretisht bazuar në listëpagesat FDP të ngarkuara në sistem si dhe në Strukturën e Listës Kombëtare Te Profesioneve kemi: z. D.C.i deklaruar si “Hidroizoluese”, sipas kodit të listpagesës është “elektrik”; z. E.D.i deklaruar si “betonist”, sipas kodit të listpagesës është “elektracist”; z. L.R.i deklaruar si “betonit”, sipas kodit të listpagesës është “elektracist”; z. M.F.i deklaruar si “hidraulik”, sipas kodit të listpagesës është “elektracist”; z. V.C. i deklaruar si “pllakashtrues”, sipas kodit të listpagesës është “shofer”;

Nisur nga kodet e listpagesave, rezulton se shoqëria nuk plotëson kriterin për numrin e specialistëve për: Elektracist 4, hidraulik 4, suvaxhi 6, hekurkthyes 4, betonist 4, shofer 3, hidroizolues 2 dhe pllakashtrues 4.

- Sipas të dhënave në dosjen e procedurës, konstatohet se shoqëria nuk plotëson kriterin e pikës 2.3.4 të DST, për 4 pllakashtrues, pasi sipas dokumentacionit nga shoqëria janë paraqitur 3 pllakashtrues, konkretisht: **K.G.J., V.C. dhe XH.XH.**

Nga sa trajtuar më sipër shoqëria “A.” ShPK nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte më favorizues për rritjen e numrit të OE në procedurë për një përdorim më efektiv të fondeve, duke ngarkuar me përgjegjësi me përgjegjësi anëtarët e KVO, *respektivisht: zj. A.L. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve Publike në DPZHT, z. K.N. me detyrë Inspektor i IMT dhe z. E.T. me detyrë ish- specialist në sektorin Prokurimeve.*

**2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion rruga Zhulat 1”, me këto të dhëna:**

<b>Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion rruga Zhulat 1”.</b>		
<b>1. Urdhër Prokurimi</b> nr. 667, datë 22.9.2022	<b>3. Njësia e Prokurimit</b> nr. 667, datë 22.9.2022 A.LL. L.SH A.P.	<b>4. Komisioni VO</b> nr. 720, datë 30.9.2022 A.L. E.T. K.N.
<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur, punë”,		
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> <b>48,561,521 lekë. Financimi:</b> 22,362,740 lekë viti 2022. 20,970,593 lekë viti 2023 15.228.187 lekë viti 2024	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “E.I.” ShPK me vlerën e ofertës 38,296,731 lekë pa TVSh, me afat 133 ditë.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) .</b>
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 24.10.2022 REF -44178-10=03-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Bashkia Gjirokastrë.	<b>10. Operatorë Ekonomike 7:</b> a- Skualifikuar 4 OE b- Kualifikuar 3 OE:
<b>11. Ankimim po</b>	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K po	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 13460, datë 7.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh) 71,217,249 lekë me afat 133 ditë</b>	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Sipas dokumentacionit në dosje, konstatohet se me datë 20.12.2022 është mbajtur PV i hapjes së procedurës. Sipas këtij PV, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy OE, konkretisht:

Kanë marrë pjesë në procedurë 7 OE, si më poshtë vijon:

<b>Nr.</b>	<b>OE pjesëmarrës</b>	<b>Nipti</b>	<b>Oferta paraqitur</b>	<b>Kualifikuar/Skualifikuar</b>
1	A.	J.....R	38,382,966	<b><u>Skualifikohet:</u></b> Nuk plotëson kriterin 2.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij një mjek të përgjithshëm pasi nuk e keni deklaruar ne shtojcën 8 në formularin përmbledhës të vetdeklarimit. Mbështetur ne LPP nr.162/2020 nenin 92 pika 1 oferta juaj ekonomike është me ndryshime ne përmbajte nga Preventivi i AK si me poshtë: Preventivi i punimeve ka gabim ne zërin 1 te Kapitullit PUNIME SHTRESASH RRUGORE pasi keni ndryshuar sasinë e zërit me analize nr.3.138 nga 1345 m <sup>3</sup> duke e zvogëluar ne 7.414m <sup>3</sup> .
2	B.	J.....V	40,005,472	Kualifikohet

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
3	B. G.	K.....E J.....V	38,086,682,40	<p><b><u>Skualifikohet:</u></b>  <i>Formulari përmbledhës i deklaramit, shtojca 8 ka pasaktësi pasi nuk është deklaruar nga OE "G." SHPK nuk ka paraqitur OE pjese te BOE-se</i></p> <p>a) <i>Nuk plotësoni kriterin 2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme, Bazuar ne neni 39 pika 5 a) te VKM 285/2021 "Për Miratimin e Rregullave Te Prokurimit Publik".</i></p> <p>b) <i>punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, pasi :</i></p> <p>c) <i>Kontrata me nr.1718/10 date 20.04.2017 është realizuar me pare se pese vjet, nga data e shpalljes se njoftimit te kontratës dt 04.10.2022.</i></p> <p>d) <i>Kontrata e lidhur midis T. dhe B. SHPK është e datës 20.12.2016.</i></p> <p><i>OE G. Nuk plotësoni kriterin 2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2022-Gusht 2022 pasi ne listëpagesat e shoqërisë punonjësit e mëposhtëm sigurohen ndryshe nga vetëdeklarim ne shtojcën 8, referuar kodeve te miratuara ne VKM nr.514 date 20.09.2017, si me poshtë:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li><i>1. Z. E.H.,me profesion hidraulik, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hidraulikut sigurohet mekanik automjetesh.</i></li> <li><i>2. Z. E.B.,me profesion montator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e montatorit sigurohet elektrikist.</i></li> <li><i>3. Z. R.K.,me profesion montator, i punësuar pranë shoqërisë.</i></li> <li><i>4. sonë, në rolin e montatorit sigurohet shofer</i></li> <li><i>5. Z. G.J.M. me profesion montator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e montatorit sigurohet shofer.</i></li> <li><i>6. z. S.X., me profesion montator, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e montatorit sigurohet punetor krahu ndërtimi.</i></li> <li><i>7. Z. P.J.me profesion karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e karpentierit sigurohet hidraulik.</i></li> <li><i>8. z. B. K. me profesion karpentier ,i</i></li> </ol>

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
				<p><i>punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e karpentierit sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>9. z. T. K., me profesion karpentier , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e karpentierit sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>10. z. A. H., me profesion karpentier, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e karpentierit sigurohet hidraulik.</i></p> <p><i>11. z. R. Sh., me profesion hekurkthyes, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyes sigurohet punëtor krahu për transportin e materialeve ne ndërtim.</i></p> <p><i>12. z. F. H., me profesion hekurkthyes , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyes sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>13. z. Q. B. me profesion hekurkthyes , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyes sigurohet punëtor krahu mirëmbajtje digash.</i></p> <p><i>14. z. E. T. me profesion hekurkthyes , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e hekurkthyes nuk sigurohet ne muajin qershor 2022, dhe sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>15. z. K D. me profesion murator ,i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e murator sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>16. z. G. S., me profesion murator , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e murator sigurohet shofer kamioni.</i></p> <p><i>17. z. K. A., me profesion murator , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e murator sigurohet përdorues rulash ne rruge.</i></p> <p><i>18. z. K. Sh., me profesion murator/suvatues , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e murator/suvatues sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</i></p> <p><i>19. z. R. A. ,me profesion Hidroizoluese , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e Hidroizoluese sigurohet punëtor krahu ndërtimi</i></p> <p><i>20. z. Xh. H., me profesion përgatitës i konstruksioneve metalike , i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e përgatitës i konstruksioneve metalike sigurohet shofer.</i></p> <p><i>21. z. D. B.. , me profesion manovratorë, i punësuar pranë shoqërisë sonë, në rolin e manovratorë</i></p>



Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
				<p>sigurohet punëtor krahu ne ndërtim.</p> <p>OE B. Nuk plotësoni kriterin 2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Qershor 2022-Gusht 2022 pasi ne listëpagesat e shoqërisë punonjësit e mëposhtëm sigurohen ndryshe nga vetëdeklarim ne shtojcën 8, referuar kodeve te miratuara ne VKM nr.514 date 20.09.2017,si me poshtë:</p> <p>1. Z.. B.- me profesion Hidraulik i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e Hidraulikut sigurohet punëtor krahu ndërtimi</p> <p>2. Z.F. B. - me profesion Hekurkthyes i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e hekurkthyesit sigurohet punëtor krahu</p> <p>3. Z.A..- me profesion Murator i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e muratorit. sigurohet punëtor krahu</p> <p>4. Z.. A.- me profesion Murator i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e muratorit. sigurohet makinist hapes kanalesh / ekskavatorist</p> <p>5. Z.. B. - me profesion Teknik Ndërtimi i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e teknikut te ndërtimit sigurohet punëtor krahu ndërtimi.</p> <p>6. Z.. A.- me profesion Manovrator i punësuar pranë shoqërisë B. ShPK ne rolin e manovratorë sigurohet përgjegjës ne sektorin e ndërtimit.</p>
4	C.	K.....M	46,279,532	Kualifikohet
5	E. I.	K.....W	38,296,731	Kualifikohet
6	L.N.	L.....I	35,150,986	<p><b><u>Skualifikohet:</u></b></p> <p>Nuk plotëson kriterin, 2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, pasi nuk e keni deklaruar ne shtojcën 8 në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, si më poshtë: <input type="checkbox"/></p> <p>Montator 4</p> <p>OE “L.”, nuk plotëson kriterin 2.10 Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të stafit të tij <b>një mjek</b> të përgjithshëm. Nuk plotëson kriterin 2.14 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet, pasi nuk e keni deklaruar ne shtojcën 8 në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, e mëposhtme <input type="checkbox"/> Prese betoni 35m 45 m 1 copë Në pronësi ose</p>



Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
				me qira. 2.11 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar, si mëposhtëm: OE "N.", nuk plotëson kriterin Një punonjës i pajisur me Certifikatë trajnimi për "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë " i dhënë nga një organizëm i licencuar certifikimi shqiptar ose i huaj, pasi nuk e keni deklaruar ne shtojcën 8 në formularin përmbledhës të vetdeklarimit <b>BOE L.ShPK &amp; N. ShPK s'kualifikohet.</b>
7	N. K.	KT KC	<u>0</u>	Nga shqyrtimi dhe kontrolli i dokumenteve administrative-ligjor, teknike-ekonomike e financiare te paraqitura rezultoi se ky operator ekonomik kishte mangësi dhe nuk plotëson te gjithë kriteret e përgjithshme dhe te veçanta te kualifikimit te përcaktuara ne DST. Tërhequr me shkresën nr.13141 prot date 30.11.2022.

Pas vlerësimit të dokumentacionit nga KVO janë skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 3 OE.

Me shkresën nr. 953,prot, datë 31.01.2023 është hartuar raporti përmbledhës.

Me vendim nr. 10, datë 31.01.2023 (prot AK nr. 954), është miratuar shpallja fitues e BOE "E.I." ShPK me ofertë 38,296,731 lekë.

Midis BOE "E.I." ShPK me ofertë 38,296,731 lekë dhe bashkisë Gjirokastrë është lidhur kontrata nr. 1363prot, datë 13.02.2023 me afat 4 muaj nga data e fillimit të punimeve.

#### **Ankesa.**

Me shkresë ankesa nr. --, datë 23.12.2022 (prot AK nr. 14274, dt. 29.12.2022), JV "B. + G." ShPK është paraqitur kundërshti par skualifikim të padrejtë, duke argumentuar dhe arsyet për skualifikim të padrejtë.

Me urdhër nr. 1061 (prot AK nr. 14623), datë 30.12.2022 është bërë pezullimi i procedurës deri në shqyrtimin e ankesës nga KSHA.

Me urdhër nr. 1062 (prot AK nr. 14624), datë 30.12.2022 për shqyrtimin e ankesë është ngarkuar znj. A.R..

Me relacion nr. 133prot, datë 9.01.2023 nga KSHA është bërë argumentimi dhe shqyrtimi i ankesës së JV "B. + G." ShPK, **ka vendosur refuzimin e ankesës.**

Me vendim nr. 133/1prot, datë 9.01.2023 është marrë vendimi për mos marrjen në konsideratë të ankesës.

Me shkresën nr. 14274/1, datë 9.01.2023 është kthyer përgjigje JV "B. + G." ShPK.

Me shkresën nr. 04/1, datë 12.01.2023 (prot AK nr. 417, datë 16.01.2023), shoqëria "G." është tërhequr nga procedura, pasi është shpallur fitues në procedura të tjera.

Me shkresën nr. 2881/6prot, datë 19.01.2023 KPP kërkon informacion mbi procedurën e zhvilluar.

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “E. + I.” ShPK në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

Referuar marrëveshjes së bashkëpunimit përqindja e punimeve është në nivelet 50% për çdo shoqëri.

- Nga shoqëria “E.” ShPK, në formularin e vetëdeklarim nuk janë deklaruar specialistët sipas pikës 2.7.

- Nga shoqëria “I.” ShPK, nuk plotësoni kriterin 2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar në listëpagesat e muajit Qershor 2022- Gusht 2022, pasi në listëpagesat e shoqërisë punonjësit e mëposhtëm sigurohen ndryshe nga vetëdeklarim në shtojcën 8, referuar kodeve të miratuara në VKM nr.514 date 20.09.2017, si me poshtë: **Z. S. K.- me profesion Hidroizoluese I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Hidroizoluese sigurohet “murator”, Z. E. Ll.- me profesion Hekurkthyes I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Hekurkthyes sigurohet “karpirtjer për çati”, Z. I. H.- me profesion karpentier I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Karpentier sigurohet “mbulues çatise”, Z. E. Ll., K. M., D. S.- me profesion Hekurkthyes I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Hekurkthyes SIGUROHET karpentier për çati, Z. R. Sh.- me profesion Hekurkthyes I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Hekurkthyes sigurohet “mbulues çatish”, Z. G. Sh., M. L., B. C., I. Sh.- me profesion Montator I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Montator sigurohet “copëtues gurësh”.**

**Z. G. G.- me profesion Montator I punësuar pranë shoqërisë I. ShPK në rolin e Montator sigurohet shofer,** - Nga auditimi, konstatohet se 2 prej shofereve (L. T. dhe E. J.), nuk rezulton të jetë regjistruar në listëpagesës e muajve Qershor-Gusht 2022.

Nga sa trajtuar më sipër bashkimi i OE “E. + I.” ShPK nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE e tjerë në garë, **veprime për të cilën ngarkohet me përgjegjësi anëtarët e KVO: zj. A.L. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve Publike në DPZHT, z. K.N. me detyrë Inspektor i IMT dhe z. E.T. me detyrë ish- specialist në sektorin Prokurimeve.**

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 9159, datë 27.9.2023 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, nga anëtarët e KVO (A.L., K.N. dhe E.T.), ku janë shprehur si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Në lidhje me mangësinë e pikës 2.7 të DST se nga shoqëria “R.” shpk nuk deklaroi asnjë specialist, sqarojmë se kjo pikë do të përmbushet nga shoqëria ‘I.’ shpk bazuar në aktmarrëveshjen.*

**Qëndrim i grupit të KLSH.**

Argumentet që ju paraqisni në lidhje me këtë mangësi **nuk qëndron**, pasi çdo njëri nga BOE duhet të paraqesë specialist për realizimin punimeve që ka marrë përsipër sipas përqindjes së marrëveshjes së bashkëpunimit. Në fragment pjesë të akt-marrëveshjes që ju paraqisni, bëhet fjalë për mjetet dhe jo specialistët.

**3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita”, me këto të dhëna:**

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita”.		
1. Urdhër Prokurimi nr. 584, datë 25.8.2022	3. Njësia e Prokurimit nr. 584, datë 25.8.2022	4. Komisioni VO nr. 645, datë 14.9.2022

<b>2. Lloji i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur”,	A.LL. L.SH A.P	A.L. E.T. K.N.
<b>5. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 73,079,408 lekë	<b>6. Oferta fituese (pa TVSh)</b> “N.J.B.” ShPK me vlerën e ofertës 71,217,249 lekë pa TVSh, me afat 133 ditë.	<b>7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 97 %.
<b>8. Data e hapjes së tenderit</b> 5.10.2022 REF -4165-09-14-2022	<b>9. Burimi Financimit</b> Ministria e Financës + Bashkia Gjirokastër.	<b>10. Operatorë Ekonomike 2:</b> a- Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 2 OE:
<b>11. Ankimim</b> JO	12. Përgjigje Ankesës nga Ak\K JO	<b>13. Përgjigje KPP</b>
<b>b. Kontrata</b>		
<b>13. Lidhja e kontratës</b> Nr. 13460, datë 7.12.2022	<b>15. Vlera e kontratës (me TVSh)</b> 71,217,249 ë me afat 133 ditë	

**Burimi të dhënave:** Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Me shkresën nr. 4254/4prot, datë 18.7.2022 Ministria e Arsimit, është miratuar fondi gjithsej në shumën 73,079,407 lekë, nga e cila: me fondet e ministrisë vlera 58,463,526 lekë dhe me financim të të ardhurave të bashkisë në vlerën 14,615,881 lekë. Ky financim do të realizohet në buxhetet e dy viteve 2022 në vlerën 21,334,625 lekë dhe diferenca në vitin 2023, pavarësisht se projekti do realizohet për një periudhë 4.5 muaj.

Sipas dokumentacionit në dosje, konstatohet se me datë 8.11.2022 është mbajtur PV i hapjes së procedurës. Sipas këtij PV, konstatohet se në këtë procedurë kanë marrë pjesë dy OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
	N. J. B.	L.U J.K J.....G	71,217,249	Kualifikohet
	L.K.	K.....I	70,156,708	<b><u>Skualifikohet:</u></b> - Nuk plotësoni kriterin e DST (2.7 Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjës të specializuar/ të kualifikuar si më poshtë duhet të jetë në listëpagesat e muajit Maj 2022-Korrik 2022), konkretisht bazuar ne listëpagesat FDP te ngarkuara ne sistem si dhe ne Strukturën e Listës Kombëtare Te Profesioneve kemi: z.F. F. si etricist ndërkohë sigurohet murator, z.R. K. Specialist Kondicionimit sigurohet Mekanik Servisi, z.F. M. Specialist Kondicionimit sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, z.A. Sh. Suvatues sigurohet Hekurkthyes, z.Xh. G. Suvatues sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, z. F. E. Suvatues sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, z.S. Gj. Suvatues sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, z.R. Sh. Hidraulik sigurohet Murator për konstruksion, z.P. V. Hidraulik sigurohet Murator për konstruksion, z.A. K. Karpentier sigurohet Murator për konstruksion, z. F. K. Karpentier sigurohet Teknik Ndërtimi, z.B. C. Betonues sigurohet

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta paraqitur	Kualifikuar/Skualifikuar
				<p>Karpentier për skela, z.J. G. Betonues sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, z.Dh. C. Betonues sigurohet saldator, z.E. C. Betonues sigurohet hekurkthyes, B. K. Bojaxhi sigurohet murator, Z. L. Bojaxhi sigurohet Punëtor lartësish, A. K. Shofer sigurohet Mekanik servisi, A. K. shofer sigurohet kopshtar, G. J. shofer (dëshmia e skaduar me 23.01.2022) sigurohet Menaxher logjistik, J. L. shofer (mungon dëshmia) sigurohet Punëtor krahu ne ndërtim, Nd. B. Hidroizoluese, sigurohet Bojaxhi.</p> <p>- <b>Katër mjetet</b> Autobetonier me targë AA693RV dhe AA694RV, Autopompë betoni me targe AA691JC, Ekskavator me goma 0.5m3 me targe AA904JA me kontratë qiraje nr. Nr.3073 Rep, nr.1037 Kol, datë 18.09.2020, Nr.664 Rep, nr.220 Kol, datë 11.02.2022 me subjektin "A.SHPK", <b>konstatohet se leja e transportit nuk është për të tretë por për përdorim vetjak.</b> Veprime në kundërshtim me ligjin nr.8378, datë 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", Neni 58 Makinat teknologjike; Neni 113 Qarkullimi në rrugë i makinave teknologjike, VKM 153 datë 07.04.2000, neni 201. Automjetet për transport dhe për përdorim të veçantë (Neni 54 i Kodit Rrugor)Neni 244. Përcaktimi i targave të regjistrimit, të përsëritjes, të provës dhe të njohjes (Neni 99 i Kodit Rrugor)Neni 282. Regjistrimi dhe vendosja e targës e makinave teknologjike (Neni 113 i Kodit Rrugor ).</p> <p>- <b>Mungon dokumentacioni</b> provues për Makineri për realizimin e kanalizimeve me jacking sistem si dhe kon nr.1162 rep, nr.396 kol date 02.04.2021-02.04.2026.</p> <p>- Mjeti me targë AA693RV për vitin 2022 i ka kaluar vlefshmëria e taksës vjetore me date 19/10/2022. Mjeti me targa AA694RV për vitin 2022 i ka kaluar vlefshmëria e taksës vjetore me date 19/10/2022. Mjeti me targe AA691JC është me Certificate për transport mallrash për te trete dhe me qira te skaduar me date 16.06.2022. Mjeti me targe AA904JA i ka kaluar vlefshmëria e taksës vjetore me date 13.07.2022 si dhe siguracioni me date 12.07.2022</p>

Nga dokumentacioni bashkëshoqërues i observacionit të subjektit Bashkia Gjirokastrë, rezulton se skualifikimi është në përputhje me dispozitat e LPP.

Sipas dokumentacionit në dosje, KVO ka shpallur fitues me kritere të plotësuar bashkimin e OE “N.” me Nipit- LU “J.” me Nipit JK dhe “B.” ShPK me Nipit J....G me vlerë të ofertës 71,217,249 lekë pa TVSh, kjo sipas PV nr. 12519 prot, datë 14.11.2022.

Formulari i njoftim fituesit nr. 12537prot, datë 14.11.202. shpallur në buletin e APP nr. 160, datë 21.11.2022.

Me shkresën nr. 1279prot, datë 24.11.2022 është hartuar dhe mbajtur raporti përmbledhës i nënshkruar dhe në personi i autorizuar z. N.N., ku me vendim nr. 124, datë 24.1.2022 (prot 1298), shpallur fitues bashkimin e OE “N.J.B.” ShPK me vlerë të ofertës 71,217,249 lekë pa TVSh.

Midis bashkimin e OE “N.J.B.” ShPK dhe Bashkia Gjirokastrë, është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 13460, datë 7.12.2022 për “Rikonstruksion I palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita” me vlerën 71,217,249ë pa TVSh. me afat punimesh 133 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

#### - **Vlerësimi i procedurës:**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga bashkimin e OE “N.J.B.” ShPK në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezulton se dhe kjo shoqëri nuk plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK, konkretisht:

- Nga shoqëria “N.” ShPK, nuk janë deklaruar ing. Mekanik dhe ing. Elektrik, kjo sipas pikës 2.6 të DST.

- Në formularin e vetdeklarimit nuk ka deklaruar asnjë nga specialistet sipas profesioneve dhe mjetet sipas kërkesave të DST, pavarësisht se mbulon 53% të punimeve.

- Nisur nga kontrata e bashkëpunimit (ndarja e punimeve), nga shoqëria nuk janë paraqitur kategoritë e licencave NP-3/C dhe NS-12/A, pavarësisht se ka marrë përsipër këto punime.

- Nga shoqëria nuk janë paraqitur kontratat për specialistët sipas profesioneve. Kështu sipas dokumentacionit në dosje shoqëria ka deklaruar **11 specialist**, por që kontrata kanë **vetëm 4 specialist**, sipas pasqyrës si vijon:

NR	kodi	EMRI	Datë kontrate
1	3114.01	A. C.	8.4.2021
2	7114.04	M. B.	
3	7115.02	V. B.	
4	7122.07	Y. M.	
5	7123.03	M. B.	
6	7124.01	E. B.	
7	7126.03	E. H.	28.6.2022
8	7131.07	F. L.	
9	7411.01	J. H.	
10	7411.01	E.Z.	28.6.2022
11	7412.11	K. K.	8.4.2021

Gjithashtu konstatohet se për asnjërin nga këto specialist nuk vërtetohet me dokumentacion sipas kërkesave të DST (**dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik nga ISHTI ose ekuivalente**).

- Sipas të dhënave në listëpagesat e muajve Maj 2022 dhe Korrik 2022, disa nga specialistët nuk janë të regjistruara në listëpagesës e muajt Majë 2022, konkretisht për specialistët punonjës A. C., E. H., E. Z. dhe K. K.

- **Nga të dhënat**, konstatohet se nga të tre bashkimi i OE, nuk është plotësuar kriteri për **4 specialist Montues kondicionimi**, sipas pikës 2.7. nga të tre shoqëritë është paraqitur vetëm një nga shoqëria “J.”, duke deklaruar z. E. Z., por që sipas dokumentacionit nuk ka kontratë

dhe nuk ka dëshmi kualifikimi. Ndërsa nga dy OE tjera nuk janë paraqitur specialist të këtij lloj.

Nga sa trajtuar më sipër bashkimin e OE "N.J.B." ShPK nuk është në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST. Në kushtet kur në garë nuk ka OE të tjerë, KVO duhej t'i propozonte titullarit të AK, anulimin e procedurës dhe vijimin e një procedurë tjetër me kritere më favorizues për rritjen e numrit të pjesëmarrësve dhe për një përdorim më efektiv të fondeve të prokuruar, **duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e KVO: zj. A.L. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Projekteve Publike në DPZHT, z. K.N. me detyrë Inspektor i IMT dhe z. E.T. me detyrë ish- specialist në sektorin Prokurimeve.**

**Kriteri:** Në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", i ndryshuar me ligjin neni 3, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76 "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit".

**Ndikimi/Efektiviteti:** KVO, ka kryer vlerësimin dhe kualifikimin e BOE në paligjshmëri të LPP, pasi nuk plotëson kriteret e DT.

**Shkaku:** Mos zbatimi i kuadrit ligjor në aplikimin e kriterëve nga personat përgjegjës (Komisioni i Vlerësimit të Ofertave).

**Rëndësia: E lartë.**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditmit, nga subjekti i audituar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 9159, datë 27.9.2023 "Mbi Projektraportin e Auditmit", nga anëtarët e KVO (A.L., K.N. dhe E.T.), ku janë shprehur si më poshtë:

**Pretendim i subjektit:**

*Në lidhje me mangësinë se asnjë nga BOE nuk paraqet 4 specialist me profesion montues kondicioneri, ju informojmë se shoqëria "N." shpk si pjesë e BOE fitues në formularin e vetëdeklarim (shtojca 8), e mbështet këtë kapacitet specialist Hidrosistem.*

**Qëndrim i grupit të KLSH.**

Argumentet që ju paraqisni në lidhje me këtë mangësi nuk qëndron, pasi specialist hidrosistem, nuk ka lidhje me specialistin montim kondicioner, pasi hordosistemi ka lidhje me ujë (hidro).

**Titulli gjetjes 3:** Mos padisja me leje ndërtimi të investimeve publike si dhe të oponencës teknike.

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit në dosjet e procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, konstatohet se në procedurën me objekt “Rikonstruksion rruga Zhulat 1” me vlerë kontrate pa TVSh të lidhur prej 38,296,731 lekë, nga AK (Bashkia Gjirokastrë), zbatimi i kontratës është realizuar pa bërë më parë oponentin teknik dhe lejen e ndërtimit/infrastrukturës.

**Kriteri:** Zbatimi i kontratës, në rastin konkret, është kryer në kundërshtim me nenin 39 të ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, përcakton se:

*“Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji”.*

pikën 3 e nenit 39, përcakton se:

*“Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit”.*

Mungesa e oponentin teknik, në rastin konkret, rezultojnë në kundërshtim me nenin 6<sup>3</sup> të ligjit nr. 120/2020, datë 07.10.2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe linin nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikim dhe zhvillim territori”, i ndryshuar, **për të cilën ngarkohet me përgjegjësi z. F.G.me detyrë Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë.**

**Ndikimi/Efekt:** Mos miratimi i oponentin teknik dhe lejes së ndërtimit, bën që investimi të mos japë garanci në zbatim.

**Shkaku:** Përgjegjësi e personave përgjegjës në zbatimin e kuadrit ligjorë.

**Rëndësia: I lartë**

**Rekomandimi:**

Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit në periudhat në vijim, të marrë masa që:

- Të mos realizohet asnjë procedurë prokurimi të investimeve publike të çdo lloji pavarësisht vlerës pa oponentin teknik të projektit që do vihet në zbatim.
- Të mos lidhet kontrata me subjektin fitues pa miratuar më parë lejen e ndërtimit.

**Nënpika 2.4.4 e programit: Mbi zbatimin e kontratave të punimeve.**

Nga ana e Audituesve të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit 01.10.2022 – 31.12.2022, nga ku rezultojnë se janë realizuar **7** procedura në investime për punë publike me Fond Limit në vlerën **155,927 mijë lekë pa TVSH** dhe vlerë kontrate **129,288 mijë lekë pa TVSH**. Diferenca e FL me vlerën e kontratave është **26,639 mijë lekë pa TVSH**.

<sup>3</sup> Oponentin teknik për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtimet publike; b) ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; c) objektet me akses publik. 2. Për çdo rast, institutet shtetërore ose entet e tjera, që kryejnë oponentin teknik, janë solidarisht përgjegjëse me projektuesin për çdo dëm që rrjedh si pasojë e gabimeve ose të metave të oponentin teknik, si dhe mbajnë përgjegjësi administrative ose penale, sipas rastit, për shkeljen e legjislacionit në fuqi. Rregullat për projektet, që duhet t'i nënshtrohen oponentin teknik sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Nga analiza e bërë, u vlerësuar për auditim 2 kontrata për punë publike në vlerën **109,513 mijë** lekë pa TVSH ose 85% e vlerës së kontratave të lidhura. Kontratat janë përzgjedhur në bazë të vlerës më të lartë të kontratës, llojit të objekteve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk në zbatimin e veprave ndërtimore, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve.

Nga Auditimi kanë rezultuar mangësi trajtuar si vijon:

**Titulli gjetjes:** Zbatimi i punimeve të kontratës me objekt “Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit Gjirokastër “ me vlerë kontrate 38,296,731 lekë pa TVSh.

**Situata:** Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës nr. 4049 prot., datë 10.05.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër , të përfaqësuar nga Zyrtari i Autorizuar i autoritetit Kontraktor z. N.N. dhe bashkimi OE **N.K." ShPK** , përfaqësuar me prokurë nga " N." me përfaqësues ligjor z. Skënder Kendezi me licencë profesionale NZ.4116/3. Vlera e kontratës baze 28,757,171 lekë pa TVSh me afat 10 muaj. Është bere modifikim kontrate për kontrate shtese Nr. 4452 Prot date 09.05.2023 ne vlere 4,778,319 lekë pa TVSh me afat 2 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës, me nr. 5855prot., datë 03.06.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe shoqërisë “E.” ShPK me përfaqësues me prokurë E.C. me licencë profesionale MK.3574. me vlerë të kontratës së shërbimit 568 359.59 lekë pa TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 12480 prot., 14.11.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër dhe kolaudatorit " O.” ShPK me përfaqësues ligjor O.G.me licencë profesionale MK.3709/1. me vlerë të kontratës së shërbimit 58 785/63 lekë pa TVSh.

Akti i kolaudimit është hartuar në datën 23.06.2023.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen e përkohshme në dorëzim të objektit nga Bashkia Gjirokastër me datë 29.06.2023, e hartuar nga grupi i punës, me **përbërje Ark. J.M., ing. A.P.dhe ing. F.M. .**

- Nga auditimi i dosjes teknike, konstatohet se si “leje ndërtimi” për këtë objekt, është me nr.70 date 02.06.2021. Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “E.” ShPK.

- Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se, punimet kanë nisur me datë 28.07.2021 dhe kanë përfunduar me datë 12.06.2023.

Është bërë amendim te afatit te punimeve nr. 2902/2prot, datë 28.04.2022 , sipas të cilit janë shtyrë punimet me 6 muaj . Ky amendim e çon përfundimin e objektit me date 28.11.2022

Është bërë pezullimi i punimeve date 24.11.2022 nga mbikëqyrësi i punimeve protokolluar me shkresë nr. 13160 prot date 30.11.2022, për shkak të problematikave për zbatimin e punimeve deri ne miratimin e fondit shtese. -

Fillimi i punimeve në objekt është bërë me shkresën 4516 prot date 10.05.2023

Pas kërkesë propozimit të sipërmarrësit të punimeve " N." me shkresën nr. 7prot, datë 24.03.2022, dhe shkresë përcjellëse te mbikëqyrësi i punimeve “E.” SHPK dhe Zyrtari i Autorizuar i autoritetit Kontraktor, për te realizuar objektin, kanë miratuar fondin rezerve ne vlerën 697,989.<sup>58</sup> lekë pa TVSH ,ndryshime volumesh, me punime që shtohen e hiqen dhe kontrate shtese 4,778,318.<sup>64</sup> lekë pa TVSH.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit Gjirokastër		
14.Lidhja e kontratës	15.Vlera e kontratës (pa TVSh) baze	16.Likuiduar deri



4704, me nr. 4049 prot., datë 10.05.2021	28757170.8 lekë pa TVSh Modifikim kontrate. 4778318.64 lekë pa TVSh <b>BOE</b> dhe <b>BOE N.K.</b> " sh.p.k	
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> Kontrate baza 23963368.58 lekë pa TVSh Kontrate shtese 4776965.43lekë pa TVSh	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Parashikuar 1+18muaj, . Fillimi punimeve: 28.07.2021 Përfundimi punimeve : 12.06.2023	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Mendim kontrate nr. nr. 2902/2, datë 28.04.2022
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> " ShPK E." ShPK	Licenca Nr.: MK3574	Kontrata nr. 5855prot., datë 03.06.2021
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> " O." ShPK	Licenca Nr.: MK 3709/1	Kontrata nr. me nr. 12480 prot., 14.11.2022
<b>22. Akt Kolaudimi</b> Datë 23.06.2023	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim</b> dt 26.06.2023	<b>24.</b>

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librit të masave, ditarit të punimeve, projektit dhe preventivit bazë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **43,300 lekë pa TVSh**.

Tabela nr. 1

B. Punime Ndërtimi I Trotuarit dhe Kangjellave									
NR	Nr.an	Zëri i Punimeve	Njësia	Çmimi I ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri I masave	Fakti	Diferenca ne	
								vol	Vlera
2	3.62	Trotuar me 6cm beton, me pllaka	m2	1450	700	700	692	8	11,600
3	3.183/b	Shtrese zhavorri lumi t=15cm	m2	250	700	700	650	50	12,500
4	3.212/c	Shtrese stabilizanti t=15cm	m2	250	700	700	650	50	12,500
5	3.211	Shtrese cakelli mbeturine kave t=20 com përhapur me makineri	m2	320	420	420	400	20	6,400
<b>Totali</b>									<b>43,300</b>

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

### **B.2. Trotuar me 6cm beton, me pllaka**

**1. Zëri 2. Trotuar me 6cm beton, me pllaka.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 700 m<sup>2</sup>. Në situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se ky zë pune nuk është realizuar në sipërfaqen e trotuarit. Nga rillogaritja, rezulton se volumi i këtij zëri pune është 692 m<sup>2</sup>, ose 8 m<sup>2</sup> më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

### **B.3. Shtrese zhavorri lumi t=15cm**

**1. Zëri 3. Shtrese zhavorri lumi t=15cm.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 700 m<sup>2</sup>. Në situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se ky zë pune nuk është realizuar në sipërfaqen e trotuarit. Nga rillogaritja, rezulton se volumi i këtij zëri pune është 650 m<sup>2</sup>, ose 50 m<sup>2</sup> më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

### **B.4. Shtrese stabilizanti t=15cm**

**1. Zëri 4. Shtrese stabilizanti t=15cm.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 700 m<sup>2</sup>. Në situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë 700 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se ky zë pune nuk është realizuar në sipërfaqen e trotuarit. Nga

rillogaritja, rezulton se volumi i këtij zëri pune është 650 m<sup>2</sup>, ose 50 m<sup>2</sup> më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

#### **B.5. Shtrese cakelli mbeturine kave t=20 com përhapur me makineri.**

**1. Zëri 5. Shtrese cakelli mbeturine kave t=20 com përhapur me makineri.** Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 420 m<sup>2</sup>. Në situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 420 m<sup>2</sup>. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune figuron në sasinë 420 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i librit të masave dhe verifikimit në terren, rezulton se ky zë pune nuk është realizuar në sipërfaqen e trotuarit. Nga rillogaritja, rezulton se volumi i këtij zëri pune është 400 m<sup>2</sup>, ose 20 m<sup>2</sup> më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 22,000 lekë pa TVSh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Kriteri:** Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “E.” ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se:

*“Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë periodikisht dhe në fazat më kryesore, librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit.”*

Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5855 prot., datë 3.6.2022.

**Nga ana e kolaudatorit të punimeve “O.”** ShPK nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore dhe kontraktuale të bëra në:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 12, ku përcaktohet se:

*“Të gjitha objektet e përkufizuara në nenin 3 duhet t'i nënshtrohen kolaudimit tekniko ekonomik, i cili ka për qëllim të verifikojë nëse: 1. objekti është realizuar në kushtet teknike; 2. objekti është realizuar në përputhje me kontratën dhe anekset e saj; 3. çmimet e aplikuara janë sipas përcaktimeve të kontratës; 4. në këtë akt verifikohen edhe kërkesat e zbatuesit të paraqitura gjatë zbatimit të punimeve”.*

Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3 ku përcaktohet se:

*Kolaudatori ose grupi i kolaudimit duhet të verifikojë me përgjegjësi:*

*a. Realizimin e objektit, në përputhje me projektin, lejen e ndërtimit, standardet dhe rregullat teknike.*

*b. Realizimin e objektit, në përputhje me kontratën e nënshkruar.*

*c. Përputhjen e dokumenteve me të dhënat nga matjet në dimension, formë, sasi dhe cilësi.*

*ç. Përputhjen e vlerës së preventivuar dhe të kontraktuar me atë të paraqitur në situacionin përfundimtar, si dhe sqarimet përkatëse, në rastet e mospërputhjes.*

Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve sipas aktit me nr. 12480 prot., datë 14.11.2022.

**Ndikimi/Efekti:** Si rezultat i mos zbatimit të zërave sipas preventivit, është krijuar një efekt negativ me dëm në shumën **43,300 lekë**.

**Shkaku:** Përgjegjësi e personave përgjegjës (mbikëqyrësit, kolaudatorit dhe grupit të marrje në dorëzim, për mos verifikimin e punimeve sipas zërave të preventivit.

**Rëndësia: E lartë**

**Rekomandimi:**

Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe

arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **JV N.K." ShPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit

**2. 1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për zbatimin e kontratës me objekt: "Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme "Asim Zeneli", baza prodhuese dhe shkolla "Drita"**, Bashkia Gjirokastrë viti 2023, konstatohet:

- Projekti parashikon rikonstrukcionin e fasadave të objekteve, në pjesën e parapetëve të dritareve dhe stehave në hyrjet e objekteve, për shkak të dëmtimeve në suvanë e jashtme. Parashikohen riparime të çatave të ndërtesave dhe ndryshimi i ulluqeve. Në brendësi të godinave është parashikuar për rikonstrukcion total të suvatimeve, shtresave, dyer e dritare. Ndërhyrjet sipas projektit, përfshijnë punimet në sheshin e shkollës, sistemimi i oborrit dhe veshje me pllaka graniti. Projekti është realizuar nga shoqëria "M." shpk, me administrator B. A.. Nga Bashkia Gjirokastrë është aplikuar për leje ndërtimi më datë 24.11.2022 tek IKTK (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore) ku është refuzuar me vendimin e saj nr. 1927 datë 15.12.2022. Nga Bashkia Gjirokastrë me vendimin nr. 09 datë 30.01.2023, refuzohet leja e ndërtimit. Nga AK është riaplikuar përsëri për leje ndërtimi më datë 02.03.2023 tek IKTK (Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore), ku janë miratuar nga të gjitha Institucionet përgjegjëse dhe nga Bashkia është miratuar leja e ndërtimit me Nr. 33 datë 11.04.2023, por njoftimi i fillimit të punimeve realizuar nga mbikëqyrësi është realizuar me anë të shkresës nr. 13908 prot., datë 19.12.2022, ku konstatohet se punimet janë realizuar pa leje ndërtimi nga IKTK.

- Objekti i kontratës "*Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme "Asim Zeneli", baza prodhuese dhe shkolla "Drita"*", është kryer sipas kontratës për punë publike nr. 13460 prot., datë 07.12.2022, të lidhur midis Autoritetit Bashkisë Gjirokastrë, përfaqësuar nga zyrtari i autorizuar N.N. dhe Bashkimit të Operatorëve Ekonomik "N.J." shpk & "B." shpk, përfaqësuar me prokurë të posaçme Nr. 9649 rep. Nr. 6388 kol. Datë 01.10.2022, nga OE "N." shpk, përfaqësuar nga administratori L. K.. Vlera e kontratës është 85,460,698 lekë me TVSH. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar 133 ditë nga nënshkrimi i kontratës.

**Titulli gjetjes:** Diferenca në punime në situacionet pjesore të perealizuara nga kontraktori BOE "N."shpk & "J." shpk & "B."shpk në objektin "*Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme "Asim Zeneli", baza prodhuese dhe shkolla "Drita"*".

**Situata: 2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës për punë publike nr. 13460 prot., datë 07.12.2022, të lidhur midis Bashkisë Gjirokastrë dhe BOE "N.J." shpk & "B." shpk me objekt "*Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme "Asim Zeneli", baza prodhuese dhe shkolla "Drita"*", me vlerë të kontratës 85,460,698 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh në situacionet pjesore.

Kontrata përbëhet nga 6 situacione pjesore progresive, ku situacionet pjesore janë shoqëruar me librezë masash pjesore, por nga verifikimi faktik në objekt datë 27.07.2023, nuk ishin në përputhje me realizimin e punimeve, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 "*Për zbatimin e punimeve të ndërtimit*" Kreu II, pika 8.1; "*Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori*" dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 "*Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit"*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 "*Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave*".

Në dosjen teknike administrohet preventiv i rishikuar, tabela e lëvizjes së volumeve por nuk disponohen librezat e masave. Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, referuar Situacionit pjesor progresiv nr. 5 deri më date 31.03.2023, dhe verifikimit në objekt datë 27.07.2023 në prezencë të specialistit të IKMT, u konstatua se sipërmarrësi kishte punime të porealizuara. Punimet e porealizuara janë: Fv dyer brendshme druri importi cilësi I-re, Fv dyer d/alumini plastike me dopio xham (tualetet), Fugatim muri guri brendshëm, Fugatim muri guri i jashtëm, Lyerje me llak e sipërfaqes së murit të gurit, Shtresë mikrocement me ngjyrë për shtrimin e galerisë, Tavan Kartonxhes, Dritare d/alumini plastike me dopio xham, Dyer të brendshme druri, Patinim muri, Punimet e instalimet elektrike, ndriçues, spote, çelësa, priza etj në vlerën prej 6,526,186 lekë pa tvsh ose **7,831,423 lekë me TVSH**, duke përfituar padrejtësisht fonde publike të porealizuara (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 91-96 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara.

**Kriteri:** Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projekt preventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontrata publike nr. 13460 prot., datë 07.12.2022

**Ndikimi/Efekt:** Si pasojë e mangësive të mësipërme, sipërmarrësi nuk ka përmbushur detyrimet kontraktuale dhe ka përfituar padrejtësisht punime të porealizuara.

**Shkaku:** Mungesa e kontrollit nga mbikëqyrësi i punimeve dhe Bashkia Gjirokastrë.

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandimi:** - Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likujduara por të porealizuara.

### **Pika 2.5 e programit. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit.**

Bashkia Gjirokastrë ka të miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.01, datë 08.02.2017.

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Gjirokastrë, gjatë periudhës 01.10.2022 - 31.12.2022, janë zhvilluar aplikimet dhe miratimet për lejet e ndërtimit të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

<b>Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje</b>		
<b>Nr.</b>	<b>Përshkrimi i lejes</b>	<b>Numri i miratimeve</b>
1	Certifikatë përdorimi	<b>1</b>
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	<b>2</b>
3	Leje infrastrukture	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	-

5	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	2
6	Leje për ndryshim funksioni	-
7	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	-
8	Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues	-
9	Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit	-
10	Leje rindërtimi, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni	-
11	Leje zhvillimi	2
12	Njoftim për fillim punimesh	4
13	Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues	
14	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	1
15	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	-
16	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	-
17	Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni	-

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga DPKTZH e Bashkisë Gjirokastrë, janë miratuar **3 leje ndërtimi**, ndër të cilat leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m<sup>2</sup> është miratuar **1 leje** ndërtimi, leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni janë miratuar **2 leje** ndërtimi. Gjithashtu janë miratuar 3 leje zhvillimi, 1 çertifikatë përdorimi dhe 4 njoftim fillim punimesh. të evidentuara në tabelën e mëposhtme:

Nr. Rendor	Lloji i aplikimit	Emër Mbiemër (Zhvilluesi)	Emër Mbiemër (Aplikuesi)	Nr. Prot	Data e miratimit
1	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	A. B.	J. X.	7392	25.10.2022
2	Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni	A. M.	J. X.	9418	19.10.2022
3	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	V.H	F. C.	9529	06.10.2022
4	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	B. G.	G. M.	10612	06.10.2022
5	Leje zhvillimi	D.K.	F.C.	10906	21.12.2022
6	Çertifikatë përdorimi	A.P.	A.P.	10986	04.11.2022
7	Njoftim për fillimin e punimeve	B.S.	K.	10988	11.10.2022
8	Njoftim për fillimin e punimeve	A.M.	J.X.	11467	27.10.2022
9	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	M.C.	F.C.	11709	27.10.2022
10	Leje zhvillimi	H.L.	F.C.	12490	21.12.2022
11	Njoftim për fillimin e punimeve	V.H	F.C.	13545	13.12.2022
12	Njoftim për fillimin e punimeve	K.M.	R.	13798	21.12.2022

Në bazë të shqyrtimit rast pas rasti të tipologjive të ndërtimit janë përzgjedhur për tu audituar rastet e mëposhtme të lejes së ndërtimit, lejeve së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, të pasqyruara në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit / Lekë
1.	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues, me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	Shtese kati mbi objekt ekzistues ne lagjen Cfake	V.H	Vendim Nr.72, Datë 06/10/2022	6,221,313 Lekë
2.		“Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe	A.P.	Vendim Nr.83,	

Nr.	Kategoria e aplikimit	Emërtimi i lejes së ndërtimit	Zhvilluesi	Vendimi Leje ndërtimi	Preventivi sipas subjektit / Lekë
	Çertifikatë përdorimi	ambiente ndihmëse të saj”		Datë 03/11/2022	
3.	Leje zhvillimi	“Banesë dy katëshe në Humelicë – Gjirokastër”	D.K.	Vendimi Nr.94, Datë 16/12/2022	

Gjatë auditimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan 1 praktikë tek e cila pasqyrohej situata në lidhje me mosrespektimin e kondicioneve urbane të tilla si intensiteti të ndërtimit dhe lartësia e lejuar e ndërtimit, të përcaktuara në Planit e Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit.

**Titulli i gjetjes 1:** *Mosrespektimi i kondicioneve urbane të përcaktuar në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe në Rregulloren e Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.01, datë 08.02.2017.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kushtet në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar. Gjetja e konstatuar u evidentuan në rastin e mëposhtëm të miratuar për leje ndërtimi, me objekt: “Shtesë kati mbi objektin ekzistues në lagjen Cfake”, për të cilën është marrë vendimi Nr.72, datë 06.10.2022, me zhvillues V.H, në adresën Rruga “Hasan Xhiku”, Nr.26. Gjirokastër. Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit Nr.01, datë 08.02.2017, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë ZU.4.1.C, në sistemin urban, me kategorinë e lejuar banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 1.8, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 60%. Nga verifikimi dhe krahasimi i të dhënave të treguesve të zhvillimit të pasqyruar në planvendosjen e miratuar me projektin e ndërtimit, intensiteti i ndërtimit për objektin pas shtesës së katit është 1.82 dhe jo 1.26 sipas të dhënave të pasqyruara tek planvendosjen e miratuar. Në projektin konstruktiv të paraqitur në dosjen teknike të aplikimit për leje ndërtimi konstatohet që përmasat e konstruksionit nuk përkojnë me përmasat e strukturës së projektit arkitektonik, nga 13.19 metra x 15.29 metra sipas projektit arkitektonik, në projektin konstruktiv përmasat e objektit janë 15 metra x 15.45 metra. Sipërfaqja e shtesës së objektit nga 162 m2 të pasqyruar tek të dhënat e treguesve të zhvillimit, në bazë të projektit konstruktiv është 180 m2. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15, pika i dhe pika ii, në dokumentacionin e nevojshëm për miratimin e lejes së ndërtimit është projektin arkitektonik dhe projekti konstruktiv, të cilat duhet të jenë në përputhje dhe të korrespondojnë me njëra tjetrën. Shtimi i sipërfaqes së ndërtimit nga 162 m2 në 180 m2 ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit nga 1.77 në 1.82 nga 1.8 e lejuar me parametrat e njësisë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit evidentohet që nuk është respektuar lartësia maksimale e lejuar e godinës në bazë të Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin Nr.1, datë 08.02.2017. Në parametrat e lejuar të njësisë ZU.4.1.C, nga 10 metra me çati deri 1.5 metra që është objekti i paraqitur në projektin e ndërtimit, objekti i miratuar zhvillohet në lartësinë 13.16 metra, në mospërputhje me kondicionet urbane të lejuara. Në raport me lejen e ndërtimit të miratuar për shtimin e katit në lartësi, sipas projektit të ndërtimit dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, objekti zhvillohet në lartësinë e 4 kateve plus çati, nga 3 kate me çati deri 1.5 m të lejuar sipas njësisë ZU.4.1.C dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me

Vendimin Nr.01, datë 08.02.2017. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, Neni 37, lartësia e ndërtimit, në pikën 3/b përcaktohet se: " *Kati nëntokë, që sipas rastit mund të jetë emërtuar edhe "Bodrum", është vëllimi i ndërtimit të katit të objektit, i cili vendoset tërësisht ose kryesisht nëntokë, me kusht që kuota e sipërme e tij e matur në dyshemenë e përfunduar të katit mbi katin nëntokë, të mos jetë më shumë se 1 metër mbi nivelin e kuotës së sistemuar të trotuarit ose sheshit rrethues të jashtëm të strukturës.*" Në bazë të projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje, ajo që përcaktohet si kat nëntokë në lejen e ndërtimit të miratuar, në bazë të legjislacionit në fuqi është i gjithë kati mbi tokë, pasi nuk është 1 metër mbi kuotën e sistemit, por është 4 metra, në lartësinë e plotë të katit dhe aksesohet në mënyrë direkte nëpërmjet sistemit të jashtëm perimetral. Gjithashtu duke u bazuar edhe në VKM-së 408, datë 13.5.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, në nenin 37, në pikën c, përcaktohet se lartësia e ndërtimeve e shprehur në metra matet sipas rastit." *Në rastin e ndërtesave të vendosura në terrene me pjerrësi, lartësia në metra jepet në mënyrë të posaçme për të dyja faqet e strukturës në secilën anë të terrenit të pjerrët dhe në përputhje me shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike.* a) *Nga kuota mesatare e sistemit të trotuarit rrethues të ndërtimit, deri në pikën më të lartë të fundit të parapetit rrethues të mbulesës së sheshtë të objektit;* b) *Nga kuota mesatare e sistemit të trotuarit rrethues të objektit në terren të sheshtë, deri në kulmin e mbulesës nga jashtë, për mbulesa të pjerrëta;*" Tek projekti arkitektonik, tek fasada dhe prerja, evidentohet qartë lartësia e godinës, si në metra dhe në numër katësh.

#### **Kriteri:**

Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

- Në bazë të Ligji Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar, Neni 20, Plani i Përgjithshëm Vendor.
- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Neni 38, Intensiteti i ndërtimit (I), përcaktohet nga dokumenti i planifikimit në nivel njësie strukturore.
- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Neni 37, lartësia e ndërtimeve.

#### **Ndikimi/Efekti:**

Mosrespektimi i kriterëve të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor, ndikon në: a) lartësinë e strukturave ekzistuese përreth strukturës së re; b) normat e lejuara të distancave; c) vlerat mjedisore dhe ekologjike në zonë; ç) vlerat e trashëgimisë kulturore në zonë; d) diellëzimin dhe orientimin; dh) respektimin e normave mjedisore) infrastruktura publike; f) hapësirat publike.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastër.

**Rëndësia:** E lartë

#### **Rekomandime:**

Nga DPZHT Gjirokastër të merren masa për të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rilevimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.

<b><u>Titulli i gjetjes 2:</u></b> <i>Mosrespektimi i distancave të objektit nga kufiri i pronës në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.</i>
---

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se distancat ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës nuk janë respektuar sipas kriterëve të Rregullores së Zhvillimit të Territorit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar për leje ndërtimi, me objekt: “Shtesë kati mbi objektin ekzistues në lagjen Cfake”, për të cilën është marrë vendimi Nr.72, datë 06.10.2022, me zhvillues V.H, në adresën Rruga “Hasan Xhiku”, Nr.26. Gjirokastër. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“, i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Për objektin në lartësinë e 4 kateve distanca që duhet të respektohet nga kufiri i pronës duhet të jetë 5 metra. Nga verifikimi i planvendosjen së miratuar, u evidentua që nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës në të gjitha orjentimet. Gjithashtu nuk janë pasqyruar të gjitha përmasat ndërmjet pikave të skajeve të objektit dhe kufirit të pronës.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës.

**Ndikimi/Efekti:** Mosrespektimi i distancës nga kufiri i pronës çënon ndërtimet me të cilat objekti kufizohet dhe çënon zhvillimin e ndërtimeve të reja në parcelat kufitare, në orjentimin, diellëzimin, standardet higjieno-sanitare, mjedisore dhe sigurinë.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastër

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:**

Nga DPZHT Gjirokastër të merren masa që lejet e ndërtimit të miratuara të jenë në përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.

**Titulli i gjetjes 3:** *Mosparaqitja e numrit të kateve të objektit që do të zhvillohet dhe objekteve me të cilat kufizohet.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohen numrat e kateve të objektit që do të zhvillohet dhe objekteve të tjera. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar për leje ndërtimi, me objekt: “Shtesë kati mbi objektin ekzistues në lagjen Cfake”, për të cilën është marrë vendimi Nr.72, datë 06.10.2022, me zhvillues V.H, në adresën Rruga “Hasan Xhiku”, Nr.26. Gjirokastër. Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet numri i kateve të objektit që do të zhvillohet dhe të objekteve të tjera me të cilat kufizohet, në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit“, i ndryshuar, neni 15, pika c, plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015,i ndryshuar, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, neni 15, pika c, dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi është edhe plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese.



**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i numrit të kateve të objekteve që do të zhvillohen dhe të objekteve me të cilat kufizohet, ndikon në mosrespektimin e distancave dhe parametrave të lejuar të zhvillimit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastrë

**Rëndësia:** E lartë

**Titulli i gjetjes 4:** *Mosparaqitja e saktë e rievimit topografik me të gjithë të dhënat dhe elementët tregues të saj.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të zhvillimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, në rievimin topografik nuk paraqiteshin të gjithë të dhënat dhe elementët tregues të saj. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastin e mëposhtme të miratuar për leje ndërtimi, me objekt: "Banesë dy katëshe në Humelicë - Gjirokastrë", për të cilën është marrë vendimi nr. 94, datë 16.12.2022, me zhvillues z. D.K., në adresën Humelicë, Gjirokastrë. Plani i rievimit për objektin e miratuar nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e kërkuara. Plani i rievimit të pronës, në zbatim të Nenit 10, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, duhet të paraqesë konturin e pasurisë si edhe të dhëna të tjera për gjendjen faktike të objektit dhe objekteve kufitare. Gjithashtu ky plan duhet të paraqesë edhe të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, madhësinë e pronës e paraqitur me dimensione, si edhe koordinatat e kufirit të pasurisë. Plani i rievimit të objektit në fjalë nuk jep të dhëna mbi rrugët dhe gjerësitë e tyre, nuk jep të dhëna mbi pasuritë kufitare, nuk jep të dhëna mbi dimensionet e parcelës dhe të objekteve ekzistuese.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, i ndryshuar, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", Nenit 10, pika (ç) planin e rievimit të pronës, në shkallë 1:500, nga topograf i licencuar.

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i saktë dhe me të gjithë elementët e ndërtimit të gjendjes ekzistuese, ndikon në zhvillimin e parcelës e në treguesit e zhvillimit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastrë

**Rëndësia:** E mesme

**Rekomandime:**

Nga DPZHT Gjirokastrë të merren masa për të mos miratuar lejet e zhvillimit pa verifikuar dokumentacionin e ngarkuar në sistem që të plotësojë e të paraqesë të gjithë të dhënat e nevojshme e konformë kushteve teknike.

**Titulli i gjetjes 5:** *Mosparaqitja në sistemin e-Leje e dokumentacionit të nevojshëm për miratimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit.*

**Situata:** Nga auditimi i lejeve të zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar për leje zhvillimi dhe çertifikatë përdorimi me objekt:

1. "Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj", të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i

ndryshuar, neni 27/2, në dokumentet për pajisjen me çertifikatë përdorimi, në pikën g përcaktohet që të duhet të dorëzohet edhe projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentet e ngarkuara në sistemin e-leje, pasqyrohet vetëm projekti arkitektonik i miratuar, por nuk dokumentohet projekti “as build” i zbatuar.

2."Banesë dy katëshe në Humelicë - Gjirokastrë", për të cilën është marrë vendimi nr. 94, datë 16.12.2022, me zhvillues z.D.K., në adresën Humelicë, Gjirokastrë. Kartela e pasurisë së paluajtshme nuk është e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit. Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së zhvillimit, konstatohet se kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Gjithashtu në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje mungon deklarata e përgjegjësive profesionale për topografin që ka hartuar rilevimin topografik dhe mungojnë vërtetimet e statusit aktiv për hartuesit të projektit arkitektonik.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të VKM-së 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, në dokumentet për pajisjen me çertifikatë përdorimi.

-VKM-ja 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 45, pika c).

-VKM-ja 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 10.

- Ligji nr.111/2018 “Për kadastrën”, Neni 17 “Certifikatat”, pika 4 dhe 6.

-Vendimin nr. 457, datë 29.6.2022, Neni 18 dhe 21.

**Ndikimi/Efekti:** Mospasqyrimi i dokumentacionit të plotë të ngarkuar në sistemin e-leje ndikon në mos shqyrtimin e saktë dhe në mënyrën e duhur të gjithë të dhënat përpara pajisjen me leje zhvillimi. Mangësitë në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me çertifikatë përdorimi, ndikojnë në mosdhënien e sigurisë së plotë se objekti është ndërtuar sipas kriterëve ligjore, duke cenuar Standartet e zhvillimit të kontrolluar, ato të mjedisit, sigurisë dhe higjieno-sanitare.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastrë

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:**

Nga DPZHT Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.

**Titulli i gjetjes 6:** *Miratimi i certifikatës së përdorimit jo në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar dhe zbatimin e punimeve në terren.*

**Situata:** Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar me objekt: “Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj”, të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Nga verifikimi i realizimit të punimeve në terren dhe nga fotot e ngarkuara në sistemin e-leje për miratimin e çertifikatës së përdorimit, evidentohet që objekti nuk është realizuar në përputhshmëri me projektin e ndërtimit të miratuar. Në ndryshim nga projekti arkitektonik i miratuar është realizuar një rampë për aksesin e automjetit në katin përdhe, elementë i cili nuk është parashikuar gjatë lejes së ndërtimit. Gjithashtu ka ndryshuar realizimi i shkallëve për aksesin në katin e dytë,

duke shtuar disa shkallë për aksesin në krahun tjetër. Ndërsa struktura me kolonat e drurit dhe brisoleit për hijëzim, nuk janë realizuar sipas projektit. Në bazë të fotove të ngarkuara në sistem, nuk pasqyrohet qartë realizimi i objektit në të gjitha orientimet dhe fasadat janë të pasqyruara në mënyrë të fragmentuara. Gjithashtu funksioni i objektit me qëllim grumbullimin e produkteve bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj nuk evidentohet. Në bazë të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, datë 31.7.2014, Neni 42, pika 3 dhe pika 4, çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kritereve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi. Mungesa e verifikimit në terren të realizimit të punimeve të ndërtimit nga specialistët e DPZHT Gjirokastër, përpara dhënies së certifikatës së përdorimit, ka sjellë realizimin e objektit jo në përputhshmëri të plotë me lejen e ndërtimit të miratuar dhe me kondicionet urbane të përcaktuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.

**Kriteri:** Anomalitë e mësipërme të trajtuara në këtë gjetje nuk janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi, si më poshtë vijon:

-Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42/ Certifikata e përdorimit, pika 3 dhe pika 4.

-Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 29, pika c, dhënien e certifikatës së përdorimit.

-VKM-ja 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve.

**Ndikimi/Efekti:** Zbatimi i realizimit jo në përputhje me lejen e ndërtimit të miratuar ndikon në zhvillimin informal të ndërtimeve, pa u bazuar në bazë të rregullores dhe sipas legjislacionit në fuqi. Ndryshimi/shtimi i volumeve të ndërtimit të cilat nuk janë parashikuar në projektin e ndërtimit të miratuar, ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe sigurinë e objektit, në aspektin arkitektonik dhe në ndryshimin e destinacionit të objektit.

**Shkaku:** Neglizhencë nga ana e DPZHT Gjirokastër

**Rëndësia:** E lartë

**Rekomandime:**

Përpara miratimit të certifikatës së përdorimit, DPZHT Gjirokastër të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

***Për sa më lart, ngarkohen me përgjegjësi:***

**Z. F.G.**, me detyrë Kryetari i Bashkisë Gjirokastër.

**Znj. B.D.**, me detyrë Drejtor i PZHT.

**Z. E.L.**, me detyrë Përgjegjës në Drejtorinë e PLZT.

**Znj. A.L.**, me detyrë specialiste mjedisi.

**Pika 2.6 e programit. Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njesisë Vendore (IMTV).**

Për vitin 2022, struktura organizative e Bashkisë Gjirokastër është miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 528,atë 19.08.2021 ” Për ristrukturim organizativ të Bashkisë Gjirokastër për vitin 2021”, Urdhër i Kryetarit nr. 647,datë 24.09.2021 “Për miratimin e strukturimit në

përfundim të ristrukturimit organizativ të Bashkisë Gjirokastrë” për vitin 2021, i përbërë nga **4 punonjës**, nga të cilët **1 kryeinspektor** dhe **3 inspektore** në fakt aktualisht në punë janë tre punonjës, Kryeinspektori dhe dy Inspektori në formë tabelle paraqitet si vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Funksioni sipas strukturës	Lloji i arsimit/dega	Data emërimit në detyrë	Aktualisht në punë apo larguar, data
1	E.SH.	K/Inspektor	Arsimi i larte Matematike/ Fizike	12.10.2021	Ne pune
2	A.M.	Inspektor	Arsimi i larte/ Arkitekture	21.04.2020	Ne pune
3	K.N.	Inspektor	Arsimi i larte/Kontabilitet/ Finance	25.03..2022	Ne pune
4	K. B.	Inspektor	Arsimi i larte/Jurist	13.10.2021	Larguar/ 23.03.2022

Burimi: Bashkia Gjirokastrë

Referuar të dhënave në pasqyrë, konstatohet se emërimi Kryeinspektorit në strukturën e IMT është në papajtueshmëri me kriteret e përcaktuara në ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”, ku përcaktohet se:

“Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjes vendore duhet të kenë arsimin e lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogjeologjisë dhe mjedisit.

Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor në Bashkinë Gjirokastrë funksionon në bazë të përcaktimeve të **Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007** “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, Neni 3,4,5, **Ligjit nr. 183/2014, datë 24.02.2014** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, Neni 4,5,6.

Gjithsesi, duke parë tabelën e mësipërme, konstatohet se në strukturën e IMTV nuk ka asnjë punonjës me profil arsimimi teknik si ing. ndërtimi, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj, profile të cilat janë të specializuara në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, gjë e cila do të rriste dhe përmirësonte rendimentin e IMTV, duke mbrojtur kështu territorin nga ndërhyrjet abuzive.

- **Mbi vendimet e marra nga IMTV për prishjen e objekteve pa leje ndërtimi / zhvillimi**  
Për periudhën objekt auditimi (01.10.2022 – 31.12.2022), nga shqyrtimi i blloqeve të proces verbaleve për konstatimin e kundërvajtjeve, rezulton se:

Nr.	Lloji i aktit	2022
1	PV/Akte kontrolli	12
2	PV/Akte konstatimi	23
3	Vendime gjobe	21
4	Vendime pezullimi	4
5	Vendime prishje	2
6	PV ekzekutimi të prishjeve	
7	Kallëzime penale	
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	4
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT	
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	

Në zbatim të proces verbaleve të konstatimit janë vendosur **3 gjoba**, me vlerë totale **2,000,000 lekë**, janë marrë **4** vendime për pezullim punimesh dhe **2** vendime për prishje të objekteve të kundërligjshëm.

Nga kontrolli i ushtruar në blloqet e vendimeve të prishjes së objekteve të jashtëligjshëm, rezulton se janë marrë **2** vendime, por nuk gjenden proces verbalet e konstatimit, vendimet e pezullimit, si dhe vendimet e masës administrative. Nuk është marrë vendimi i dënimit me gjobë për kundërvajtësin për personat të cilët është kërkuar prishje objekti, kjo në kundërshtim me **Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”**, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e).

Grupi i auditimit i kërkoj IMTV-së dokumentacionin lidhur me ekzekutimin e vendimeve për prishjen e objekteve apo strukturave të ndryshme që janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin. Nga ana e IMTV-së u paraqit shkresa nr. 7212/1prot, datë 5.7.2022, ku për mungesë të mjeteve është kërkuar ekzekutimi i vendimeve IKMT, duke qenë se vet IMTV Gjirokastër nuk i ka mjetet e nevojshme për ekzekutimin e prishjeve (gjithsej 2 raste për të cilat IMTV ka detyrimin e prishjes), **por që nuk u paraqit asnjë dokumentacion mbi ekzekutimin në zbatim të kuadrit ligjorë.**

Në përfundim rezulton se, nga ana e IMTV-së nuk janë marrë masat e duhura për të zbatuar vendimet e nxjerra për prishjen e objekteve të ndërtuara në kundërshtim me ligjin, apo edhe nëse këto objekte janë prishur IMTV, nuk e ka dokumentuar këtë proces. IMTV nuk ka dorëzuar informacion në lidhje me asnjë prej vendimeve të prishjes së strukturave ose objekteve. Dokumentimi i aktivitetit të IMTV për prishjet e ndërtimeve të jashtëligjshme mungon, proces ky i cili është i parashikuar në ligjet dhe rregulloret e sipërpërmendura dhe duhet të jetë pjesë e dosjeve individuale që IMTV duhet të mbajë për çdo subjekt të kontrolluar.

- **Mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara**

Grupi i auditimit i kërkoj IMTV dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dokumentacion lidhur me ekzekutimin, kontabilizimin dhe vjeljen e gjobave. Referuar analizimit të të dhënave të paraqitura nga IMTV dhe DFB në Bashkinë Gjirokastër, lidhur me gjobat e vendosura dhe arkëtimin e tyre rezulton se:

Në periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022 nga IMTV Bashkia Gjirokastër janë vendosur në total **3 gjoba me vlerë 2,000,000 lekë**, si më poshtë vijon:

*Tabela e mëposhtme është për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022*

Nr.	Subjekti	Nr.	Data	Arsyeja	Vlera	Likujduar	Proces gjyqësor	Pa likujduar	Situata
1	E.H.	50	14.10.2022	Ndërtim pa leje	500,000		500,000	500,000	Është në proces gjyqësor
2	P. SH.P.K	51	16.12.2022	Ndërtim pa leje	500,000		500,000		Shfuqizimi i aktit administrativ
3	M. SH.P.K , G.	52	29.12.2022	Jo prezent mbikëqyrësi i punimeve dhe mungesa e masave të sigurimit teknik të punëtorëve	1,000,000		1,000,000	1,000,000	Është në proces gjyqësor

Nga të dhënat e pasqyrës rezulton se:

- a- Asnjë nga personat nuk është mundësuar likuidimi i gjobës.
- b- Për asnjë rast nuk është llogaritur penaliteti në masën 2% për çdo ditë vonesë deri në 30 ditë, **ku për subjektin “E.H.” kamatëvonesa përlllogaritet në shumën 300,000 lekë (500,000 x 2% e 30 ditë), dhe për subjektin “M.C.” kamatëvonesa përlllogaritet në vlerën 600,000 lekë (1,000,000 lekë x 2% x 30 ditë)**
- c- Për një rast është bërë shfuqizim akti administrativ.
- d- Në dy raste është në proces gjyqësor.

Në asnjë nga rastet e mësipërme nuk është e dokumentuar vjelja e gjobës nëpërmjet pagës, si një nga mënyrat kur gjobat nuk paguhen vullnetarisht, referuar **Ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010**, “Për kundërvajtjet administrative”, Kreu V, Neni 31, pika 5.

- **Mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatimin në terren të kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me DPKZHT**

Grupi i auditimit i kërkoi IMTV-së dokumentacionin lidhur me bashkëpunimin e IMTV-se dhe DPKZHT-se, planet një (1) mujore dhe tre (3) mujore te miratuara nga k/inspektori, korrespondencën me IKMT, si dhe kërkesat drejtuar DPKZHT për pajisjen me projektet e miratuara për ndërtimet objekt – kontrolli, të pajisura me leje zhvillimi / ndërtimi.

Si përfundim, shprehemi se, nuk janë hartuar në mënyrë sistematike planet mujore të punës, të hartuara nga kryeinspektori. IMTV dhe DPKZHT nuk kanë rakorduar punën midis tyre për ruajtjen e territorit nga ndërtimet e jashtëligjshme, kjo në kundërshtim me **Ligjin 107/2014**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 50, pika 2, ku përcaktohet se “2. Autoritetet e planifikimit bashkëpunojnë dhe bashkërendojnë veprimet ndërmjet tyre dhe bashkëveprojnë e shkëmbejnë informacione e të dhëna”.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me **Ligjin nr. 107/2014**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 51, pika 3, ku citohet:

“Autoritetet e inspektimit bashkëveprojnë dhe bashkërendojnë veprimet inspektuese ndërmjet tyre, si dhe me autoritetet e planifikimit, me qëllim rritjen e efektivitetit të inspektimit. Kur vihet në dijeni të fakteve, edhe pse ato mund të mos jenë brenda sferës së tij të juridiksionit dhe përgjegjësive, çdo autoritet i inspektimit njofton menjëherë autoritetin tjetër përgjegjës ose të interesuar. ”

si dhe në kundërshtim me **Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007**, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, ndryshuar me **Ligjin nr. 10 240, datë 25.2.2010** dhe **Ligji nr.10 323, datë 23.9.2010**, dhe **Ligji nr. 23/2013** dhe me **Ligjin 183/2014**, Neni 12, pika 10, i cili përcakton se:

“Pavarësisht sa më sipër, kryeinspe-ktori/inspektorët e IKMT-së, gjatë ushtrimit të kontrollit të parashikuar, sipas këtij neni, kanë të drejtë që, krahas verifikimit në vend të situatës ndërtimore, të inspektojnë, të kërkojnë dhe të kryejnë të gjitha verifikimet e nevojshme pranë autoritetit përkatës të planifikimit, të cilët janë të detyruar të krijojnë të gjitha lehtësitë për verifikimin e dokumentacionit të nevojshëm, si dhe të japin të gjitha shpjegimet përkatëse dhe çdo dokume-ntacion të kërkuar. Në rast se në përfundim të inspektimit, sipas kësaj pike, konstatohen shkelje, kryeinspektori/inspektorët e IKMT-së marrin masat përkatëse të parashikuara në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”

Rezulton se IMTV nuk ka kryer detyrat e saj, përcaktuar në legjislacionin dhe rregulloret e sipër-përmendura. Mungesa e bashkëpunimit midis strukturave, si dhe mungesa e planeve mujore dhe tre mujore të miratuara nga k/inspektori, ul efektivitetin e kryerjes së detyrave, duke krijuar rrezik për mungesë inspektimi në të gjitha subjektet që shkelin ligjin, **duke ngarkuar me përgjegjësi z. E.SH. / Kryeinspektor.**

## **Pika 2.7 e programit. Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.**

**Titulli gjetjes:** *Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguara në Bashkinë Gjirokastër nga KLSH me shkresën nr. 883/13prot, datë 24.01.2023.*

**Situata:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

- Bashkia Gjirokastër për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së **nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve.**

Referuar shkresës nr. 883/13prot, datë 24.01.2023 “Për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të KLSH-së”, rezultoi se **afati 6 mujor** për raportimin në KLSH lidhur me zbatimin e rekomandimeve plotësohet më datë 7.6.2023. Në kushtet kur auditimi aktual korrespondon në periudhën që do të raportohet në KLSH, nuk është e nevojshme të bëhet raportimi pasi nga grupi i auditimit është pjesë e programit të auditimit edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve.

- Bashkia Gjirokastër ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1069prot, datë 02.02.2023, **por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve.**

- *Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon.*

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative**, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa, në proces auditimi janë 7 masa dhe **nuk janë zbatuar 8 masa.**

**b. Për masa shpërblim dëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 21,107,773 lekë**, të pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, janë në proces zbatimi **3** masa me vlerë **21,107,773 lekë**, nga e cila nuk është arkëtuar asnjë vlerë dhe nuk ka masa të pazbatuara.

**c. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 5 masë me vlerë 230,412 mijë lekë**, të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 0 (zero) masa pa vlerë, janë në proces zbatimi 2 masa pa vlerë, ku nga vlera e rekomanduar prej 217,928 mijë lekë është arkëtuar vlera 15,899 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 202,029 mijë lekë. **Nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 12,484 mijë lekë.**

**d. Për masa disiplinore**, janë rekomanduar gjithsej **12 masa** të pranuar plotësisht dhe zbatuara nga subjekti.

### **Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar nga ana e Bashkisë Gjirokastër**

Masat	Rekomanduar	Rek. Të Zbatuara	Në Proces Zbatimi	Rek. Të Pa Zbatuara	Shprehur ne vlere në 000/lekë		
					VI. Rekomandim	VI. Arkëtuar	VI. Mbetur
Masa Organizative	23	8	7	8			
Masa Për Shpërblim Dëmi	3	0	3	0	21,107	0	21,107
Masa mungesë të ardhurash	5	0	2	3	230,412	15,029	214,513
Masa Disiplinore	12	12					
Masa Administrative							
Kompetence e IMTV							
<b>Totali leke</b>	<b>42</b>	<b>20</b>	<b>12</b>	<b>11</b>	<b>251,519</b>	<b>15,029</b>	<b>235,620</b>

**Kriteri:** Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017

“Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij”.

**Ndikimi/Efekti:** Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e të ardhurave të munguara në vlerën **214,513 mijë lekë dhe dëmi ekonomik në vlerën 21,107 mijë lekë.**

**Shkaku:** Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e personave përgjegjës të ngarkuar me urdhrin nr. 1069prot, datë 2.2.2023 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë dhe mos marrja e masave të vetë kryetarit për verifikimin e urdhrave të nxjerra prej tij, respektivisht:

**Z. F.G., me detyrë Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë.**

**Z. N.N., me detyrë Sekretar i Përgjithshëm..**

**Znj. J.M., me detyrë Zv/Kryetar Bashkia Gjirokastrë.**

**Znj. A.K., me detyrë Drejtori Finance.**

**Z. H.P., me detyrë Drejtori Juridik dhe Pronave Publik, në cilësinë e Drejtorit të Aseteve dhe Juridike.**

**Zj. C.M., me detyrë Drejtor Ardhurave Vendore dhe Pronave, në cilësinë e Drejtorit të PZHT**

**Rëndësia: e lartë**

**Rekomandimi:**

Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

#### **A. Masa organizative.**

**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit t’i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullësor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullësore të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t’i kërkojë Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**8.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë të marrë masat e duhura për një planifikim sa më të studiuar të zërave buxhetor të shpenzimeve, duke eliminuar diferencat e dukshme midis vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar për këto zëra.

**9.1.Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

**13.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë **14,664,580 lekë** që subjektet të ndryshëm i detyrohen Bashkisë Gjirokastrë, duke mos krijuar vonesa në kohë në ndjekjen e procedurave për këtë qëllim.

**13.2 Rekomandim:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrë masat për kontabilizimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në vlerën **110,777 mijë lekë.**



**16.1.Rekomandim:** Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që pas miratimit të lejeve të ndërtimit, të mbahen aktet e kontrollit për zbatimin e tyre në teren në përputhje me lejen e ndërtimit.

**18.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të llogaritjes së fondit limit, të marrë masa që në rastet e prokurimeve për karburant, të llogarisë saktë vlerën e fondit limit, për të mos angazhuar fonde buxhetore më tepër nga sa duhen, me qëllim shpërndarjen e fondeve në mënyrë proporcionale me nevojat reale sipas zërave buxhetor të shpenzimeve.

**Menjëherë**

**22. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Gjirokastrë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2018 – 30.06.2021, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, konkretisht.

**Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastrë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,121,654** lekë, respektivisht:

-Vlera **1,121,650** lekë, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999** lekë, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashku” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastrë të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSh** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera.

Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

**Menjëherë**

### **C. Masa për shpërblim dëmi.**

**1.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjellësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**2.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.” ShPK & “SH.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastrë-Kakavi”.

**3.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë të marrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **749,128 lekë** nga kontraktori “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës me nr. 7359, datë 01.07.2022, me “Blerje kontejnerësh për mbetjet urbane”, Bashkia Gjirokastrë, për mos përmbushje të afatit të kontratës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

**D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, efizienz dhe efektivitet të tyre.**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 6,219,206 lekë** ndaj **229 personave**.

**2.2. Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Gjirokastrë vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

**3.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 3,700,000 lekë**, nga katër subjekte (sipas tabelës në aneksin bashkangjitur raportit të auditimit, pika 2.6).

**4.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në **vlerën 564,084 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

**5.1.Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin që për gjobat të cilat nuk janë paguar në mënyrë vullnetare dhe ju ka kaluar afati ligjor i pagesës, në vlerën **2,000,000 lekë** sipas aneksit, bashkëlidhur raportit të auditimit, të bëjë adresimin e tyre në gjykatë për nxjerrjen e urdhër ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobës.

**Menjëherë**

**Më hollësisht paraqiten në Aneksin 2.7 bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit.**

#### **Pika 2.8 e programit: Shqyrtim ankesash**

Me anë të kërkesës së z. A.B. administruar nga KLSH me nr.691 prot., datë 26.07.2023, nëpërmjet të cilës shpreh shqetësimin e tij dhe të banorëve të tjerë të cilët banojnë në rrugën “Zeman Haska”, në lagjen “Kodra e Shtufit”. Në këtë ankesë të paraqitur shkurtimisht pretendohet se miratimi i deklaratës paraprake nga Bashkia Gjirokastrë, për rrethimin e pasurisë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, në pronësi të z. P.B., ka ndërprerë aksesin për në banesat e tyre.

Në lidhje me trajtimin e rastit të mësipërm, nga Bashkia Gjirokastrë u kërkua informacioni i nevojshëm për këtë situatë dhe dokumentacioni i shkarkuar nga sistemi e-leje. Për të verifikuar problematikën e ngritur në ankesë u shqyrtua deklarata paraprake e kryerjes së punimeve, e miratuar me vendimin nr. 65, datë 13/07/2023 nga Bashkia Gjirokastrë, për objektin “Rrethi metalik i lehtë edhe sistemime oborri”, (aplikuar me kërkesën me numër

identifikimi NID/NUIS FO, dorëzuar më datë 11/07/2023, me numër AN110720230031), në pasurinë me nr. pasurie 8541-16/110, ZK 8541, në rrugën “Zeman Haska”, nr.26, Gjirokastër. Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, u verifikua çertifikata e pronësisë për pasurinë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, me llojin e pasurisë truall, me një sipërfaqe të truallit 400 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 0 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. P.B., të lëshuar me datë 15.06.2023. Ndërsa në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në pikën “c”, tek të drejtat reale përshkruhet mbi këtë truall gjendet edhe ndërtesa me numër pasurie 16/110-ND.

Në planvendosjen e miratuar, pasqyrohet konturi i pronës i mbivendosur mbi gjendjen ekzistuese dhe mbi foton ajrore, në të cilën evidentohet që kufiri i pronës sipas paraqitjes **përfshin edhe një pjesë të infrastrukturës rrugore të rrugës “Zeman Haska”, duke kufizuar aksesin e rrugës.**

Rrjedhimisht, nga sa më sipër, arrihet në konkluzion se për shkak të mbivendosjes së pasurisë mbi infrastrukturën rrugore dhe kufizimit të aksesit në pronat kufizuese, deri në momentin e sqarimit dhe zgjidhjes së situatës, Bashkia Gjirokastër duhet të pezullojë lejen e miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastër, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, **duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.**

#### **IV. GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Bashkia Gjirokastër nuk ka ngritur një sistem efektiv të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, duke mos hartuar një kuadër të plotë rregullash dhe procedurash të shkruara për këtë qëllim, nuk janë hartuar programe trajnimi për ngritjen dhe zhvillimin profesional të stafit, nuk janë përcaktuar rregulla të shkruara për llojet e raporteve që duhet të përgatiten nga menaxherët kryesor, me qëllim njohjen e titullarit nëpërmjet raporteve shkresore me situatën e të ardhurave, debitorët e probleme të tjera të menaxhimit të veprimtarisë së institucionit, nuk është hartuar regjistri i riskut, si dhe nuk janë hartuar aktivitetet e kontrollit për zvogëlimin e riskut të parashikuar, lista e proceseve të punës dhe gjurma e auditimit nga asnjë sektor dhe drejtori.

Në procedurat e marrjes në punë të punonjësve, marrëdhëniet e punës të së cilëve rregullohet me kodin e punës, u konstatua se nuk janë hartuar kriteret e nevojshme për përzgjedhjen e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20, neni 8, pika 8, germa “b”, neni 15, pikat 1-4, neni 16, pikat 2-3, neni 17, pika 1, neni 21, pika 2, neni 27, pikat 1-2, Udhëzimi nr. 16, datë 20.07.2016, “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, pika 2.2, pika 2.2.4, nënpikat 1-5, dhe Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin i miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli II “Rolet dhe aktorët në sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollit”, pika 2.2.6 “Grupi i menaxhimit strategjik”, pika 2.5.2 “Menaxhimi i riskut”, Kapitulli III “Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit” pika 3.1 “Mjedisi i kontrollit të brendshëm”, pika 3.2 “Cikli i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollin”, hapi 5 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 34-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandim:** Nga Kryetari i Bashkisë Gjirokastër të merren masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë të risqeve, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që

mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit, të hartohet dhe të miratohet gjurma e auditimit me qëllim menaxhimin e riskut.

## Në vijimësi

**2.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi realizimi i buxhetit në tërësi sipas aktrakordimit me thesarin për vitin 2022, nga 1,299,784 mijë lekë të planifikuara janë realizuar në vlerën 995,656 mijë lekë ose në masën 77 %, (Pagat (600) nga 366,254 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 350,489 mijë lekë, sigurime shoq. (601) nga 60,144 mijë lekë të planifikuar janë realizuar 58,354 mijë lekë, Shpenzime operative (602) nga 184,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 155,688 mijë lekë dhe shpenzime për investime (230-231) nga 431,729 mijë lekë të planifikuara janë realizuar 185,300 mijë lekë, *me burim të ardhurash ( të ardhura e veta në vlerën 30,065 mijë lekë, grand në vlerën 59,395 mijë lekë, dhe transfertës e kushtëzuar në vlerën 95,840 mijë lekë)* ose 43%, konstatohet se ka diferenca të dukshme midis planifikimit dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore për investime, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me ndikimin që ka në ofrimin e të mirave publike ndaj komunitetit, rezulton se është më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ky mos realizim vjen si rezultat i realizimit të procedurave të prokurimit në fund të vitit e për pasojë kontratat janë lidhur në vitin 2023, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin dhe zbatimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, ligji nr. 68-2017, “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, UMF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm për Pushtetin Vendor”, Udhëzimi nr. 23 datë 22.11.2016, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm” dhe Vendimet përkatëse të Këshillit Bashkiak (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 43-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të marrë në konsideratë faktorët që kanë ndikuar në mosrealizimin e buxhetit paraardhës në mënyrë që programimet e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit koherent, të jenë sa më të argumentuara dhe ndryshimet të jenë sa më të vogla dhe vetëm për raste të domosdoshme. Planifikimi i realizimit të procedurave të prokurimit të bëhet mbi baza reale dhe shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta.

## Në vijimësi

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i rezultoi se nga totali i detyrimeve sipas bilancit në vlerën 10,889,181 lekë, janë raportuar në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vlerën 9,199,181 lekë (*detyrime shpenzime kapitale në vlerën 8,236,219 lekë dhe detyrime për vendime gjyqi në vlerën 962,962 lekë*). Diferenca për vlerën 1,690,000 lekë që nuk është raportuar MFE ka të bëjë me paradhëniet për kopshte e çerdhe në fund të vitit. Detyrime të papaguara më datë 31.12.2022, janë në vlerën gjithsej 9,199,181 lekë të cilat nuk janë likuiduar për mungesë të fondeve, veprim në mospërputhje me ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” nenet 42,43,47,50,52 dhe 65, UMF nr. 2 datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” i ndryshuar, pikat 253,354, UMF nr. 5, datë 27.12.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 dhe ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 40, 48 dhe ligjit nr. 10269 “Për menaxhimin financiarë dhe kontrollin” neni 12, germa “gj” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 43-49 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e Financës , të paraqesë në mbledhjen e këshillit Bashkiak, një material për gjendjen e faturave të pa likuiduara, të hartojë një grafik duke zbatuar të gjitha radhën e pagesave. Për Vendimet Gjyqësore që kanë marrë formë të prerë, duhet ti ekzekutojë ato në mënyrë vullnetare dhe të mos presë që ekzekutimi të bëhet nëpërmjet urdhrave të përmbaruesit gjyqësor për të shmangur kostot e tepërta buxhetore që vijnë për shkak të pagesave të shpenzimeve përmbarimore.

#### Menjëherë

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 33,986,115 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, është paraqitur më pak për vlerën 59,718,570lekë në të nuk janë përfshirë vlera e plotë e debitorëve të taksave dhe tarifave vendore në vlerën 54,266,148 lekë, detyrimet për qira objekti në vlerën 2,526,000 lekë detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimeve në vlerën 1,854,317 lekë dhe detyrimet për qira tokë bujqësore në vlerën 1,072, 105 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 30, ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 12, germa “g” (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kontabilizojë vlerën prej 59,718,570 lekë për detyrimet që kanë subjektet për taksa e tarifa vendore, qira tokash, qira objekti dhe detyrimet për taksën e ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit, si dhe të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve, në vlerën 93,704,685 lekë.

#### Në vijimësi

**5.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se gjendja e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (të drejta)”, paraqitet në mbyllje të vitit 2022 në vlerën 46,772,800 lekë, e cila nuk kuadron me Llogarinë 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti” të Pasqyrës së Performancës Financiare për vlerën 275,277,960 lekë, pasi kjo llogari është pasqyruar në vlerën 322,050,760 lekë, në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu III. “Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” pika 59 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerave të llogarive sipas pozicioneve për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

#### Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023.

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llogaria 202 “Studime dhe projekte”, e pasqyruar në mbyllje të vitit 2022, në vlerën 40,345,713 lekë, konstatohet se në këtë llogari ka projekte për ndërtim e rikonstruksion ujësjellësi, ndërtesa dhe rrugë e rrjete, në vlerën 36,435,713 lekë, të cilët janë trashëguar nga ish-Komunat sot Nj/Administrative të Bashkisë Gjirokastrë, për të cilat nuk ka informacion nëse këto projekte janë vënë në përdorim dhe vlerat e tyre të sistemoheshin në llogaritë përkatëse të investimit të përfunduar si pjesë e kostos totale të objektit që i përket, kjo ka sjellë paraqitjen e Aktiveve Afatgjata Materiale më

pak për vlerën 36,435,713 lekë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në pasqyrat financiare dhe në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

#### Në vijimësi

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se llogaria 212 “Ndërtesa konstruksione” e analizuar në kontabilitet për 162 artikuj kontabël, në vlerën 50,552,353 lekë dhe llogaria 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” e analizuar në kontabilitet për 261 artikuj kontabël, në vlerën 2,019,415,999 lekë, nuk janë të analizuara sipas ndërtimeve dhe konstruksioneve apo rrugëve e rrjeteve, nuk ka informacioni për çdo objekt, në lidhje me datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, personin përgjegjës, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, rezulton se shtesat për rikonstruksionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të objektit por janë trajtuar si aktive më vete, në këto kushte nuk mund të ketë informacion të saktë në lidhje me gjendjen kontabël, e cila do të krahasohet dhe me gjendjen faktike kur bëhet inventarizimi fizik për të vërtetuar dhe sistemuar vlerën e tyre në kontabilitet, pra na japin arsye të mos kemi siguri mbi vlerat në pasqyrat e pozicionit financiar për sa i përket kësaj llogarie për pasojë të mos japim dot një opinion mbi plotësinë, saktësinë dhe përkatësinë e këtyre vlerave në kontabilitet, veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30,31 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Gjirokastrë, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstruksionin dhe mirëmbajtjen e tyre të kryejë zbërthimin e dokumentacionit financiar e ligjor për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra në vite të paanalizuar.

#### Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2023.

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, nga 431 artikuj kontabël të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 31,343,317,280 lekë, Bashkia Gjirokastrë, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 10.06.2015 , Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35 (Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK Gjirokastrë dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

## Në vijimësi

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Gjirokastër, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 12 objekte variojnë nga 3,907 lekë deri në 86,215 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, pika 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastër të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

## Në vijimësi

**10.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se: Bashkisë Gjirokastër, me VKM nr. 1684, datë 24.12.2008, Njesisë Administrative Cepo, me VKM nr. 244, datë 31.03.2011 dhe Njesisë Administrative Lazarat, me VKM nr. 1467, datë 05.11.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunave, të Qarkut Gjirokastër”, i janë miratuar listat inventarit, ndërsa Njesisë Administrative Lunxheri, me VKM nr. 567, datë 27.06.2013, Njesisë Administrative Picar, me VKM nr. 22, datë 12.01.2011, Njesisë Administrative Antigone, me VKM nr. 506, datë 13.07.2011 dhe Njesisë Administrative Odrie, me VKM nr. 1044, datë 14.10.2009 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Komunave të Qarkut të Gjirokastër”, i janë kaluar prona në pronësi dhe përdorim.

Për pronat si më sipër Sektori Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike, **nuk** ka bërë regjistrimin e tyre në ASHK, **nuk** janë inventarizuar, **nuk** disponohej informacion në lidhje me gjendje reale të këtyre pronave sa nga këto prona janë të zëna sa funksionale dhe sa prej tyre nuk ekzistojnë, në kundërshtim me ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar, me pika 26 dhe 27, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfitëozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 3, faqe 54-74 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastër, të marrë masa që për Njësitë Administrative Gjirokastër, Cepo dhe Lazarat të cilave nuk ju është kaluar me VKM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, për përfundimin e procedurës së transferimit dhe për pronat të cilat janë transferuar të ngrejë grup pune me specialistë të fushës, për evidentimin, inventarizimin, vlerësim dhe regjistrimin e pronave në ASHK. Të krijohet regjistri i pronave të paluajtshme të kaluara në pronësi, apo në

përdorim të Bashkisë Gjirokastrë dhe të bëhen përpjekje për dhënien me qira të ndërtesave, tokës bujqësore, trojeve me qëllim krijimin e të ardhurave në dobi të komunitetit.

## Në vijimësi

**11. Gjete nga auditimi:** Në subjektin Bashkia Gjirokastrë për periudhën objekt auditimi 01.10.2022 deri më 31.12.2022, janë realizuar gjithsej 12 procedura me vlerë të lartë me fond limit 168,061 mijë lekë dhe vlerë kontrata të lidhur 139,034 mijë lekë ose 82.7% e fondit të prokuruar.

Nga grupi i KLSH, referuar materialiteti të përcaktuar në fillim të procesit të auditimit me vlerë popullate 19,913 mijë lekë, janë vlerësuar për auditim **4 procedura** me fond limit **145,257** mijë lekë ose 86.4% e fondit të prokuruar.

Nga auditimi janë konstatuar shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, të cilat kanë konsistuar në:

**a- Aplikimin e kriterëve** të paargumentuara dhe jo në përputhje me tipologjinë e procedurave, duke vendosur pika licence jo në përputhshmëri me natyrën e objektit të prokurimit dhe të përshtatur me zërat e preventivit.

Janë kërkuar inxhinier ku referuar zërave të preventivit nuk kërkohet prezenca e këtyre inxhinierëve.

Këto mangësi janë konstatuar në procedurat me objekt “*Rikonstruksion rruga Zhulat 1*”, me fond limit 48,561,521 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “E.I.” shpk me vlerë kontrate 38,296,731 lekë dhe në procedurën me objekt “*Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita*”, me fond limit 73,079,408 lekë, ku fitues është shpallur bashkimi i OE “N.J.B.” shpk me vlerë kontrate pa TVSh 71,217,249 lekë.

Kategorizimi i punimeve nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit. Vendosja si kriterë e licencave me nivele të kategorive jo në përputhshmëri me volumin e punimeve dhe me natyrën e objektit të prokurimit, nga njëra anë, eventualisht dhe potencialisht çënon konkurrencën, në kundërshtim me vetë qëllimin e ligjit “*Për prokurimin publik*”, pasi vendosja e këtyre kërkesave ndikon drejtpërsëdrejti në pjesëmarrjen e OE, dhe nga ana tjetër, frenojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm në procedurat e prokurimit.

**b- Në vlerësimin e procedurës**, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet plotësimit të të gjitha kriterëve të DT të miratuara nga AK dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi disa nga kriteret nuk plotësohen nga ana e tyre.

Në këto raste KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurë tjetër me kushte me favorizues për rritjen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë për një përdorim me efektiv të fondeve të prokuruar, konkretisht:

- *Mos deklarim të saktë të stafit inxhinjrik.*

- *Mos paraqitja e kategorive të licencave të kërkuara.*

- *Mos plotësimi i kriterit me specialit të fushave elektrik, hidraulik, etj, si dhe dokumentacion bashkëzotërues argumentues.*

- *Për disa nga specialistet kodi sipas listpagesës nuk përputhet me llojin e profesionit të deklaruar, konkretisht bazuar në listëpagesat FDP të ngarkuara në sistem si dhe në Strukturën e Listës Kombëtare të Profesioneve.*

Këto mangësi janë konstatuar në procedurat me objekt “*Permiresimi I kushteve të banimit për komunitetet e varfëra dhe të pafavorizuara*” me fond limit 12,123 mijë lekë; “*Rikonstruksion i palestrës shkolla e mesme Asim Zeneli dhe shkolla Drita*” me fond limit 73,074 mijë lekë dhe “*Rikonstruksion rruga zhulat 1*” me fond limit 48,561 mijë lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “*Për prokurimin publik*”, si dhe nenet 41 *Kërkesa të*



veçanta për kontratat e shërbimeve dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (për kriteret), si dhe në shkelje të dispozitave të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar me ligjin neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76 “Kriteret detyruese për skualifikim” , neni 92, “Shqyrtimi i ofertave” , si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit” (për vlerësimin) (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 74-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike (Njësia e Prokurimit), për procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave dhe kriterëve për kualifikim, duhet të ketë parasysh tipologjinë e objektit të kontratës, vlerën limit të planifikuar, zërat e punimeve të parashikuara në preventivin e objektit, volumet e tyre dhe në harmoni me rekomandimet e APP-së, dokumentet teknike me qëllim për të garantuar, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Për çdo procedurë prokurimi AK të udhëhiqet nga parimi i ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitetit, bazuar në kriteret e vlerësimit që nxisin konkurrencën e lirë dhe trajtim të barabartë të operatorëve ekonomik, duke përfutur kështu kontrata me ndikim në miradministrimin e fonde buxhetore.

**11.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në cilësinë e Titullarit të AK, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e ofertave ekonomike të cilat nuk plotësojnë kriteret e kërkesave kualifikuese të DST, me pasojë përdorimin me paligjshmëri të fondeve publike.

Të konsiderojë faktin se kualifikimi i operatorëve ekonomikë të cilët nuk plotësojnë kriteret e Dokumenteve Standarde të Tenderit, përveçse është shkelje e kuadrit rregullator në fuqi, përbën edhe risk real për shpenzimet e njësisë publike, pasi këta operatorë për shkak të mangësive nuk japin siguri për kryerjen me sukses dhe cilësi të kushteve të kontratës.

### **Menjëherë dhe vijimësi**

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të ndërtimit u konstatua se nuk respektohen të gjitha kushtet në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar. Gjetja e konstatuar u evidentuan në rastin e miratimit të lejes së ndërtimit, me objekt: “Shtesë kati mbi objektin ekzistues në lagjen Çafkë”, me vendim nr.72, datë 06.10.2022, zhvillues V.H, në adresën Rruga “Hasan Xhiku”, Nr.26. Gjirokastrë.

Në bazë të Planit të Përgjithshëm Vendor dhe Rregullores së Planit të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr.01, datë 08.02.2017, zona në të cilën zhvillohet objekti bën pjesë në njësinë ZU.4.1.C, në sistemin urban, me kategorinë e lejuar banim dhe duhet të plotësojë kondicionet urbane me intensitetin e ndërtimit të lejuar 1.8, koeficientin e shfrytëzimit të territorit 60%. Në projektin konstruktiv të paraqitur në dosjen teknike të aplikimit për leje ndërtimi konstatohet që përmasat e konstruksionit nuk përkojnë me përmasat e strukturës së projektit arkitektonik, nga 13.19 metra x 15.29 metra sipas projektit arkitektonik, në projektin konstruktiv përmasat e objektit janë 15 metra x 15.45 metra. Sipërfaqja e shtesës së objektit nga 162 m<sup>2</sup> të pasqyruar tek të dhënat e treguesve të zhvillimit, në bazë të projektit konstruktiv është 180 m<sup>2</sup>. Shtimi i sipërfaqes së ndërtimit nga 162 m<sup>2</sup> në 180 m<sup>2</sup> ndikon në rritjen e intensitetit të ndërtimit nga 1.77 në 1.82 nga 1.8 e lejuar me parametrat e njësisë. Nga shqyrtimi i projektit të ndërtimit evidentohet që nuk është respektuar lartësia maksimale e lejuar e godinës në bazë të Planit të Përgjithshëm të Territorit të miratuar me Vendimin Nr.1, datë 08.02.2017. Në parametrat e lejuar të njësisë ZU.4.1.C, nga 10 metra

me çati deri 1.5 metra që është objekti i paraqitur në projektin e ndërtimit, objekti i miratuar zhvillohet në lartësinë 13.16 metra, në mospërputhje me kondicionet urbane të lejuara. Në raport me lejen e ndërtimit të miratuar për shtimin e katit në lartësi, sipas projektit të ndërtimit dhe në bazë të legjislacionit në fuqi, objekti zhvillohet në lartësinë e 4 kateve plus çati, nga 3 kate me çati deri 1.5 m të lejuar sipas njësisë ZU.4.1.C dhe Planit të Përgjithshëm Vendor të miratuar me Vendimin Nr.01, datë 08.02.2017.

Në bazë të projektit të ndërtimit të ngarkuar në sistemin e-Leje, ajo që përcaktohet si kat nëntokë në lejen e ndërtimit të miratuar, në bazë të legjislacionit në fuqi është i gjithë kati mbi tokë, pasi nuk është 1 metër mbi kuotën e sistemit, por është 4 metra, në lartësinë e plotë të katit dhe aksesohet në mënyrë direkte nëpërmjet sistemit të jashtëm perimetral.

Për sa sipër është në kundërshtim me VKM-së 408, datë 13.5.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 37, lartësia e ndërtimit, në pikën 3/c/b. 2- Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 35, distancat e lejuara midis ndërtimit dhe kufirit të pronës përcaktohet si gjatësia e vijës pingule nga faqja e strukturës së ndërtimit me kufirin e pronës dhe është e barabartë me numrin e kateve mbi tokë të ndërtimit plus 1m. Për objektin në lartësinë e 4 kateve distanca që duhet të respektohet nga kufiri i pronës duhet të jetë 5 metra. Nga verifikimi i planvendosjen së miratuar, u evidentua që nuk janë respektuar distancat nga kufiri i pronës në të gjitha orjentimet. Gjithashtu nuk janë pasqyruar të gjitha përmasat ndërmjet pikave të skajeve të objektit dhe kufirit të pronës.

3- Në planvendosjen e miratuar nuk pasqyrohet numri i kateve të objektit që do të zhvillohet dhe të objekteve të tjera me të cilat kufizohet, në kundërshtim me pikën “c” e nenit 15, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 96-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**12.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për:

- Të verifikuar të gjitha materialet e ngarkuara në sistemin e-leje, rilevimin e gjendjes ekzistuese të objektit dhe projektin e ndërtimit, që të jenë në përputhje me kondicionet urbane të lejuara sipas njësisë përkatëse.
- Lejet e ndërtimit të miratuara të jenë më përputhje dhe të respektojnë distancat minimale të lejuara ndërmjet objektit dhe kufirit të pronës.
- Të mos miratuar lejet e ndërtimit pa verifikuar që planvendosja të jetë e plotë me të gjithë të dhënat e nevojshme të pasqyruara në të dhe konformë kushteve teknike të projektimit.

**Menjëherë**

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i lejeve të zhvillimit dhe çertifikatave të përdorimit u konstatua se në materialet e ngarkuara në sistemin e-Leje, nuk paraqitet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për miratimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, konkretisht:

1.“Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj”, të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Në bazë të VKM-së 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, neni 27/2, në dokumentet për pajisjen me çertifikatë përdorimi, në pikën g përcaktohet që të duhet të dorëzohet edhe projekti arkitektonik i miratuar dhe projekti “as build” (i zbatuar); Në dokumentet e ngarkuara në sistemin e-leje, pasqyrohet vetëm projekti arkitektonik i miratuar, por nuk dokumentohet projekti “as build” i zbatuar.

2.“Banesë dy katëshe në Humelicë - Gjirokastrë”, për të cilën është marrë vendimi nr. 94, datë 16.12.2022, me zhvillues z.D.K., në adresën Humelicë, Gjirokastrë. Kartela e pasurisë së

paluajtshme nuk është e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit. Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së zhvillimit, konstatohet se kartelat e pasurisë së paluajtshme nuk janë ngarkuar të azhornuara gjatë 3 muajve të fundit. Gjithashtu në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje mungon deklarata e përgjegjësive profesionale për topografin që ka hartuar rilevimin topografik dhe mungojnë vërtetimet e statusit aktiv për hartuesit të projektit arkitektonik (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 96-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**13.1. Rekomandimi:** Nga Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë të merren masa për të verifikuar në sistemin e-Leje paraqitjen e të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për shqyrtimin e lejes së zhvillimit dhe çertifikatës së përdorimit, përpara miratimit të tyre.

## Menjëherë

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave së miratimit të “Certifikatave të përdorimit” u konstatua se leja e ndërtimit e miratuar nuk përputhej me zbatimin në terren të objektit. Gjetja e konstatuar u evidentua në rastet e mëposhtme të miratuar me objekt: “*Pikë grumbullimi produktesh bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj*”, të miratuar me vendimin Nr. 83, datë 03/11/2022, me zhvillues A.P., në zonën Valare-Gjirokastrë. Nga verifikimi i realizimit të punimeve në terren dhe nga fotot e ngarkuara në sistemin e-leje për miratimin e çertifikatës së përdorimit, evidentohet që objekti nuk është realizuar në përputhshmëri me projektin e ndërtimit të miratuar. Në ndryshim nga projekti arkitektonik i miratuar është realizuar një rampë për aksesin e automjetit në katin përdhe, elementë i cili nuk është parashikuar gjatë lejes së ndërtimit. Gjithashtu ka ndryshuar realizimi i shkallëve për aksesin në katin e dytë, duke shtuar disa shkallë për aksesin në krahun tjetër. Ndërsa struktura me kolonat e drurit dhe brisoleit për hijëzim, nuk janë realizuar sipas projektit. Në bazë të fotove të ngarkuara në sistem, nuk pasqyrohet qartë realizimi i objektit në të gjitha orientimet dhe fasadat janë të pasqyruara në mënyrë të fragmentuara. Gjithashtu funksioni i objektit me qëllim grumbullimin e produkteve bujqësore dhe ambiente ndihmëse të saj nuk evidentohet. Në bazë të Ligjit 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, datë 31.7.2014, Neni 42, pika 3 dhe pika 4, çertifikata e përdorimit lëshohet vetëm kur aktet e kontrollit vërtetojnë realizimin e punimeve, në përputhje me kushtet e lejes ose deklaratës paraprake për kryerje punimesh, sipas fazave dhe kriterëve të përcaktuara në legjislacionin për punimet e ndërtimit, në rregulloren e zhvillimit dhe në legjislacionin mjedisor. Në rast se konstatohet mospërputhje e punimeve të kryera me kërkesat, sipas pikës 3, autoriteti i planifikimit lëshon aktin e konstatimit të mospërputhshmërisë, i cili jep sugjerimet dhe afatin kohor dhe, nëse afati kohor nuk respektohet, sanksionet për sigurimin e përputhshmërisë nga zhvilluesi. Mungesa e verifikimit në terren të realizimit të punimeve të ndërtimit nga specialistët e DPZHT Gjirokastrë, përpara dhënies së çertifikatës së përdorimit, ka sjellë realizimin e objektit jo në përputhshmëri të plotë me lejen e ndërtimit të miratuar dhe me kondicionet urbane të përcaktuara sipas Planit të Përgjithshëm Vendor.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 42/ Certifikata e përdorimit, pika 3 dhe pika 4.

-Në bazë të ligjit 107/2014, datë 31.7.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 29, pika c, dhënien e çertifikatës së përdorimit

-VKM-ja 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 27/2, mbikëqyrja e punimeve (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 96-103 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë, përpara miratimit të çertifikatës së përdorimit, të marrë masa për të verifikuar aktet e kontrolleve të

mbajtura dhe realizimin e zbatimit të punimeve në terren, në mënyrë që të jenë në përputhshmëri me lejen e ndërtimit të miratuar.

**Menjëherë**

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmbledhur paraqitet si më poshtë:

- Bashkia Gjirokastrë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të **nuk ka kthyer përgjigje në afatin e 20 ditëve.**

Referuar shkresës nr. 883/13prot Prot, datë 24.01.2023 për dërgimin e Raportit Përfundimtar dhe Rekomandimeve të KLSH-së, rezulton se **afati 6 mujor** për raportimin në KLSH lidhur me zbatimin e rekomandimeve plotësohet më datë 7.6.2023. Në kushtet kur auditimi aktual korrespondon në periudhën që do të raportohet në KLSH, nuk është e nevojshme të bëhet raportimi pasi nga grupi i auditimit është pjesë e programit të auditimit edhe verifikimi i zbatimit të rekomandimeve.

- Bashkia Gjirokastrë ka hartuar planin e veprimit të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH me shkresën nr. 1069prot, datë 02.02.2023, **por nuk ka raportuar në Këshillin Bashkiak mbi rezultat e zbatimit të këtyre rekomandimeve.**

- Në mënyrë të përmbledhur situata e zbatimit të rekomandimeve paraqitet si vijon.

**a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 23 masa organizative,** të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 8 masa, në proces auditimi janë 7 masa dhe **nuk janë zbatuar 8 masa.**

**b. Për masa shpërblim bëmi janë rekomanduar 3 masa me vlerë 21,107,773 lekë,** të pranuar nga subjekti. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, janë në proces zbatimi **3** masa me vlerë **21,107,773 lekë,** nga e cila nuk është arkëtuar asnjë vlerë dhe nuk ka masa të pazbatuara.

**c. Për masa mungesë të ardhurash janë rekomanduar 5 masë me vlerë 230,412 mijë lekë,** të pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 0 (zero) masa pa vlerë, janë në proces zbatimi 2 masa pa vlerë, ku nga vlera e rekomanduar prej 217,928 mijë lekë është arkëtuar vlera 15,899 mijë lekë, duke mbetur për likuidim vlera 202,029 mijë lekë . **Nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 12,484 mijë lekë.**

**d. Për masa disiplinore,** janë rekomanduar gjithsej **12 masa** të pranuar plotësisht dhe zbatuara nga subjekti.

Veprime në kundërshtim me Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15, “Të drejtat e KLSH”, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 50, pika 5, “Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ..., kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 107-111 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16 të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, Ju rikërkojë marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara si dhe të zbatuara pjesërisht si dhe përshpejtimin e atyre në proces si më poshtë:

#### **A. Masa organizative.**

**7.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit t'i kërkojë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), që të marrë masa për evidentimin e sipërfaqeve të

shfrytëzueshme nga subjektet private, duke zbritur nga fondi pyjor dhe kullor këto sipërfaqe, si dhe të hartojë bilancin e përgjithshëm të sipërfaqeve pyjore dhe kullorë të mbetura.

Për rastet kur nuk është vepruar për zbritjen nga fondi pyjor, t'i kërkohet Agjencisë Kombëtare të Hidrokarbureve (AKBN), bllokimi i veprimtarisë së kompanive minerare, deri në zbritjen nga ky fond të sipërfaqeve të shfrytëzueshme.

**8.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë të marrë masat e duhura për një planifikim sa më të studiuar të zërave buxhetor të shpenzimeve, duke eliminuar diferencat e dukshme midis vlerës së planifikuar dhe asaj të realizuar për këto zëra.

**9.1.Rekomandim:** Titullari i Autoritetit Kontraktor të marrë masat që në të gjitha kontratat e furnizimit të mallrave, të caktojë personat përgjegjës për mbikëqyrjen e kontratës me qëllim garantimin e cilësisë së aktiveve të furnizuara në përputhje me kriteret dhe specifikimet e kërkuara. Gjithashtu të raportohet në APP për çdo rast mbi ecurinë e zbatimit të kontratës.

**13.1. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë nëpërmjet strukturave përkatëse të marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë **14,664,580 lekë** që subjektet të ndryshëm i detyrohen Bashkisë Gjirokastrë, duke mos krijuar vonesa në kohë në ndjekjen e procedurave për këtë qëllim.

**13.2 Rekomandim:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave të marrë masat për kontabilizimin e detyrimeve të pa shlyera nga të ardhurat vendore në vlerën 110,777 mijë lekë.

**16.1.Rekomandim:** Drejtoria e Punëve Publike, Administrimit dhe Kontrollit të Territorit dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit, të marrin masa që pas miratimit të lejeve të ndërtimit, të mbahen aktet e kontrollit për zbatimin e tyre në teren në përputhje me lejen e ndërtimit.

**18.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastrë, nëpërmjet strukturave përkatëse të llogaritjes së fondit limit, të marrë masa që në rastet e prokurimeve për karburant, të llogarisë saktë vlerën e fondit limit, për të mos angazhuar fonde buxhetore më tepër nga sa duhen, me qëllim shpërndarjen e fondeve në mënyrë proporcionale me nevojat reale sipas zërave buxhetor të shpenzimeve.

## **Menjëherë**

**22. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Gjirokastrë në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak të analizojë Raportin Përfundimtar të Auditimit të kryer në Bashkinë Gjirokastrë për periudhën e veprimtarisë ekonomike 01.01.2018 – 30.06.2021, duke analizuar të gjitha shkeljet dhe rekomandimet e dhëna nga KLSH për nxjerrjen e përgjegjësive të personave përgjegjës dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe përmirësimin e punës në të ardhmen, kjo në zbatim të pikës 4 e nenit 50, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”, konkretisht.

**Për 2 masa shpërblim dëmi me vlerë 1,422,101 lekë si vijon:**

**1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit Zhvillim Territorit, të marrë masa për llogaritjen e saktë të detyrimeve nga taksa e infrastrukturës në masën 0.1% për investimet që janë jo me fondet e Bashkisë Gjirokastrë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjor për arkëtimin e detyrimit në vlerën **1,121,654 lekë**, respektivisht:

-Vlera **1,121,650 lekë**, për investimin në objektin “Rikonstruksioni i Rrjetit të Furnizimit me Ujë dhe Sistemit të Kanalizimeve në Qytetin e Gjirokastrës” me vlerë preventivi prej 1,121,650,665 lekë.

-Vlera **3,999 lekë**, për investimit në objektin “Rikonstruksioni i Shkollës së Bashku” me vlerë preventivi 3,999,401 lekë.

**2.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, Bashkia Gjirokastër të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **296,447 lekë pa TVSh** nga OE “A.” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 520 prot datë 18.01.2021, me objekt “Rikonstruksion i fushës së vjetër”, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në të gjitha shkallët e gjykimit, vlerë kjo e cila përfaqëson punimeve të pakryera. Gjithashtu të fillojë procedura e dhënies së masave disiplinore sipas rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm.

**Menjëherë**

**C. Masa për shpërblim dëmi.**

**1.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **17,195,325 lekë pa TVSh** nga BOE “B.” ShPK & “A.” ShPK & “M.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të punimeve në kontratën me nr. 4803 prot., datë 22.06.2020, me objekt: “Ujësjiellësi Lazarat”. Vlera e mësipërme përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

**2.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastër të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **3,163,320 lekë pa TVSh** nga BOE “N.” ShPK & “SH.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 11585 prot datë 15.10.2021 me objekt: “Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në Kodrën e Çafkës pranë rrugës nacionale Gjirokastër-Kakavi”.

**3.1.Rekomandim:** Bashkia Gjirokastër të marrë të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e vlerës prej **749,128 lekë** nga kontraktori “E.” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit të kontratës me nr. 7359, datë 01.07.2022, me “Blerje kontejnerësh për mbetjet urbane”, Bashkia Gjirokastër, për mos përmbushje të afatit të kontratës, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

**Menjëherë**

**D. Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me economicitet, eficence dhe efektivitet të tyre.**

**2.1. Rekomandim:** Bashkia Gjirokastër, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje në **vlerën 6,219,206 lekë** ndaj **229 personave**.

**2.2. Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave dhe Drejtoria e PZHT për personat të cilët nuk kanë kryer pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet pa leje, t'i kërkojë Drejtorisë Rajonale ASHK Gjirokastër vendosjen e urdhër kufizimit mbi pasurinë deri në kryerjen e pagesës së kësaj takse.

**3.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për arkëtimin e **vlerës prej 3,700,000 lekë**, nga katër subjekte (sipas tabelës në aneksin bashkangjitur raportit të auditimit, pika 2.6).

**4.1.Rekomandim:** Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore për arkëtimin e detyrimeve të papaguara nga dhënia me qira e tokave bujqësore në **vlerën 564,084 lekë** duke llogaritur dhe shtuar vlerën e kamatëvonesave për të gjitha rastet e detyrimeve të pa arkëtuara në afat.

**5.1.Rekomandim:** Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor dhe Drejtoria Juridike, të marrin që për jobat të cilat nuk janë paguar në mënyrë vullnetare dhe ju ka kaluar afati

ligjor i pagesës, në vlerën **2,000,000 lekë** sipas aneksit, bashkëlidhur raportit të auditimit, të bëjë adresimin e tyre në gjykatë për nxjerrjen e urdhër ekzekutimit, me qëllim arkëtimin e gjobës.

**Menjëherë**

**16. Gjetje nga auditimi:** Me anë të kërkesës së z. A.B. administruar nga KLSH me nr.691 prot., datë 26.07.2023, nëpërmjet të cilës shpreh shqetësimin e tij dhe të banorëve të tjerë të cilët banojnë në rrugën “Zeman Haska”, në lagjen “Kodra e Shtufit”. Në këtë ankesë të paraqitur shkurtimisht pretendohet se miratimi i deklaratës paraprake nga Bashkia Gjirokastrë, për rrethimin e pasurisë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, në pronësi të z. P.B., ka ndërprerë aksesin për në banesat e tyre.

Në lidhje me trajtimin e rastit të mësipërm, nga Bashkia Gjirokastrë u kërkua informacioni i nevojshëm për këtë situatë dhe dokumentacioni i shkarkuar nga sistemi e-leje. Për të verifikuar problematikën e ngritur në ankesë u shqyrtua deklarata paraprake e kryerjes së punimeve, e miratuar me vendimin nr. 65, datë 13/07/2023 nga Bashkia Gjirokastrë, për objektin “Rrethi metalik i lehtë edhe sistemime oborri”, (aplikuar me kërkesën me numër identifikimi NID/NUIS F.....O, dorëzuar më datë 11/07/2023, me numër AN110720230031), në pasurinë me nr. pasurie 8541-16/110, ZK 8541, në rrugën “Zeman Haska”, nr.26, Gjirokastrë.

Në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-leje, u verifikua çertifikata e pronësisë për pasurinë me nr.16/110, në zonën kadastrale 8541, me llojin e pasurisë truall, me një sipërfaqe të truallit 400 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 0 m<sup>2</sup>, në pronësi të z. P.B., të lëshuar me datë 15.06.2023. *Ndërsa në kartelën e pasurisë së paluajtshme, në pikën “c”, tek të drejtat reale përshkruhet mbi këtë truall gjendet edhe ndërtesa me numër pasurie 16/110-ND.*

Në planvendosjen e miratuar, pasqyrohet konturi i pronës i mbivendosur mbi gjendjen ekzistuese dhe mbi foton ajrore, në të cilën evidentohet që kufiri i pronës sipas paraqitjes **përfshin edhe një pjesë të infrastrukturës rrugore të rrugës “Zeman Haska”, duke kufizuar aksesin e rrugës.** (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 111-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit Bashkia Gjirokastrë në bashkëpunim me Inspektoriatin e Mbrojtjes Territorit, të marrin masa për pezullimin e lejen së miratuar për zhvillimin e punimeve dhe në bashkëpunim me ASHK-në Gjirokastrë, të zhvillojë verifikimin e përputhshmërisë të kufirit të pronësisë, në bazë të gjendjes aktuale në terren, sipas pozicionit gjeografik të saktë, duke mos cënuar aksesin e pasurive kufizuese dhe infrastrukturës rrugore.

**Menjëherë**

## **B. MASA SHPËRBLIM DËMI.**

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërbllimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërbllimin e dëmit në vlerën **7,874,723 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1 Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës nr. 4049 prot., datë 10.05.2021 me objekt *“Rikualifikim i hapësirave publike rreth stadiumit Gjirokastër “*, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Gjirokastër , të përfaqësuar nga Zyrtari i Autorizuar i autoritetit Kontraktor z. N.N. dhe bashkimi OE **N.K." ShPK** . Vlera e kontratës baze 28,757,171 lekë pa TVSh me afat 10 muaj.

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, librit të masave, ditarit të punimeve, projektit dhe preventivit bazë, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **43,300 lekë pa TVSh**. Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, neni 12, Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 *“Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”* e konkretisht Kreu II, Pika 3 *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 91-96 të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*.

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës Bashkia Gjirokastër në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për kontabilizim dhe arkëtimin e vlerës prej **43,300 lekë** në ngarkim të **JV N.K." ShPK**, si diferencë punimesh të pakryera në referencë të zërave të punimeve të preventivit.

**Brenda datës 31.12.2023**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i kontratës për punë publike nr. 13460 prot., datë 07.12.2022, të lidhur midis Bashkisë Gjirokastër dhe BOE "N.J." shpk & "B." shpk me objekt *“Rikonstruksioni i palestrës shkolla e mesme “Asim Zeneli”, baza prodhuese dhe shkolla “Drita”*, me vlerë të kontratës 85,460,698 lekë me TVSH, u konstatuan diferenca punimesh në situacionet pjesore.

Kontrata përbëhet nga 6 situacione pjesore progresive, ku situacionet pjesore janë shoqëruar me librezat masash pjesore, por nga verifikimi faktik në objekt datë 27.07.2023, *nuk ishin në përputhje me realizimin e punimeve*, veprim i cili është në kundërshtim Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 *“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”* Kreu II, pika 8.1; *“Situacionet pjesore hartohen në lloje, zëra, sasi, çmim e vlerë, sipas kontratës dhe ndryshimeve të urdhëruara nga investitori”* dhe Udhëzimin Nr. 1, datë 16.6.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*, 3.3 ku përkatësisht përcaktohet se: 3.3 *“Situacionet mujore pjesore, progresive dhe përfundimtare hartohen mbi bazën e volumeve të llogaritura në librezën e masave dhe çmimeve faktike, mbështetur në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin teknik të çmimeve të ndërtimit, të miratuara çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave”*.

Në dosjen teknike administrohet preventiv i rishikuar, tabela e lëvizjes së volumeve por nuk disponohen librezat e masave. Nga verifikimi i dokumentacionit vënë në dispozicion, referuar Situacionit pjesor progresiv nr. 5 deri më date 31.03.2023, dhe verifikimit në objekt datë 27.07.2023 në prezencë të specialistit të IKMT, u konstatua se sipërmarrësi kishte punime të përcaktuara. Punimet e përcaktuara janë: Fv dyer brendshme druri importi cilësi I-re, Fv dyer d/alumini plastike me dopio xham (tualetet), Fugatim muri guri brendshëm, Fugatim muri guri i jashtëm, Lyerje me llak e sipërfaqes së murit të gurit, Shtresë mikrocement me ngjyrë për shtrimin e galerisë, Tavan Kartonxhes, Dritare d/alumini plastike me dopio xham, Dyer të brendshme druri, Patinim muri, Punimet e instalimet elektrike, ndriçues, spote, çelësa, priza etj në vlerën prej 6,526,186 lekë pa tvsh ose **7,831,423 lekë me TVSH**, duke përfutur padrejtësisht fonde publike të përcaktuara. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 91-96 të Raporti Përfundimtar të Auditimit)*.



**2.1. Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë të marrë masa, të ngrejë grup pune të veçantë me specialistë të fushës, të vlerësojnë e të analizojnë zërat e punimeve të zbatuara në vlerën **7,831,423 me TVSH** nga sipërmarrësi i punimeve në situacionin pjesor nr. 5, ku të përcaktohen shkaqet, arsyet dhe përgjegjësitë ligjore. Gjithashtu nëse deri në fazën e mbylljes së punimeve këto zëra nuk realizohen të kërkohet arkëtimi i vlerës së punimeve të likuiduara por të përcaktuara.

Menjëherë

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE .**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dizozicion në lidhje me legalizimet e ndërtimeve pa leje dhe listave që disponon për pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë, konstatohet se nga ALUIZNI Gjirokastrë janë dërguar zyrtarisht me shkresë listat e qytetarëve shoqëruar me leje legalizimi dhe destinuara për regjistrim në ASHK Gjirokastrë, për periudhën deri më 31.12.2022, rezulton se nuk kanë bërë pagesën e taksës së ndikimit në infrastrukturë 84 persona për vlerën 1,854,317 lekë, e cila konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë, nga Drejtoria Urbanistikës Bashkisë Gjirokastrë, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore të bëra në VKM nr. 860, datë 10.12.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, pika 5, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave vendore”, i ndryshuar, neni 27- *Taksa e ndikimit në infrastrukturë*, pika 3, gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,854,317 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale të dhënat sipas pasqyrës Aneks nr.2/5 bashkëlidhur (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 49-54 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria Urbanistikës, të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim, listat me vlerat e taksës së llogaritur dhe të zbatohen procedurat ligjore për arkëtimin taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e legalizimit për 84 persona me vlerë **1,854,317 lekë**.

Menjëherë

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi në lidhje me arkëtimin e të ardhurave nga qiraja e tokave bujqësore të pandara, për kontratat e vitit 2022 e para, u konstatua se 24 fermer, nuk kanë shlyer detyrimet e kontratës, **në vlerën 1,072,105 lekë që janë të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Gjirokastrë**, nga Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike, nuk janë marrë masa për zbatimin e kushteve të kontratës për arkëtimin e detyrimeve dhe zgjidhjen e menjëhershme të kontratës. Gjithashtu këto lista nuk janë dërguar në fund të periudhës viti 2022 në Drejtorinë e Financës për kontabilizimin e detyrimeve në vlerën 1,072,105 lekë, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” neni 12, germa “g”, neni 22, pika 3, germa “dh” dhe VKB-ve për miratimin e paketave fiskale të dhënat sipas pasqyrës Aneks nr.2/6 bashkëlidhur (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 49-54 të Raporti Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Sektori i Lejeve, Liçencave dhe Administrimit të Pronave Publike të marrë masa që të dërgohen në Drejtorinë e Financës për kontabilizim listat me vlerat e qirave të paguara dhe të zbatohen të gjitha procedurat administrative e ligjore për të kërkuar zbatimin e kontratave dhe arkëtimin nga 24 fermerë të vlerës **1,072,105 lekë**.

Menjëherë

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i veprimtarisë së IMT Bashkia Gjirokastrë për periudhën 01.10.2022 – 31.12.2022, *rezulton se:*

- IMTV nuk ka në strukturën e saj punonjës me profil arsimimi teknik si ing. ndërtimi, urbanistik, teknologjisë së materialeve, etj, profile të cilat janë të specializuara në njohjen e materialeve, strukturave, projekteve, si dhe evidentimit të gjendjes faktike të strukturave në raport me strukturat e miratuara me anë të vendimeve të organeve kompetent, gjë e cila do të rriste dhe përmirësonte rendimentin e IMTV, duke mbrojtur kështu territorin nga ndërhyrjet abuzive, në kundërshtim me ligjin nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”.

- Nga ballafaqimi i blloqeve të vendimeve dhe konstatimeve të mbajtura nga IMTV Gjirokastrë, vihen re se ka parregullsi të ndryshme, si mungesa e proces verbaleve të konstatimit të kundërvajtjes, vendimeve për pezullim, prishje, masë gjobe, në përputhje me **Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007**, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 5, pika b), ç), d), Nenin 12 dhe 13.

- Për gjambat e vendosura gjatë vitit 2022 dhe që nuk janë paguar brenda afateve ligjore, IMTV nuk ka ndjekur të gjitha procedurat e duhura ligjore me qëllim arkëtimin e tyre. Përkatësisht, IMTV nuk ka ndjekur hapat e parashikuar në ligj si procedurat e mbledhjes me forcë të detyrimit apo vendosje sekuestro mbi pasurinë, si dhe nuk janë llogaritur kamatëvonesat në shumën **900,000 lekë, si mungesë të ardhurash**.

- IMTV Gjirokastrë nuk ka kërkuar në asnjë rast heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë, për rastet e ndërtimit të kundërligjshëm, siç parashikohet në Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 5, pika c), si dhe Ligjin 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 5. Ky veprim ndëshkohet sipas përcaktimeve të Nenit 15, pika 7, të po këtij ligji.

- Nuk është respektuar afati 10 ditor për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, pasi është mbajtur proces verbali i konstatimit, kjo në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.7.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Neni 13. Ky veprim ndëshkohet sipas përcaktimeve të Nenit 15, pika 3, të po këtij ligji.

- Në asnjë rast nuk është faktuar se vlera e masës administrative është e barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, si parashikohet në **Ligjin 107/2014**, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Neni 52, “Kundërvajtjet administrative”, pika 1, nënpika e) dhe ë), si dhe pika 2 e po këtij neni, kjo me qëllim maksimizimin e të ardhurave nga vjelja e gjobave.

- Për periudhën nën auditim nga IMTV nuk u paraqitën akte kontrolli të miratuara nga Kryeinspektori për kontrollet e ushtruara në objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprime këto në kundërshtim me përcaktimet ligjore të sipër cituara dhe detyrat e Kryeinspektorit dhe inspektorëve të përcaktuara në Rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e administratës së Bashkisë Gjirokastrë.

- Në zbatim të përcaktimeve të Ligjit nr. 9780, datë 06.07.2007 “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, i ndryshuar, IMTV Gjirokastrë ka për detyrë të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjambat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm etj. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacion periodik çdo tre muaj për masat e marra dhe

nuk ka raportuar në IKMT në kundërshtim me përcaktimet ligjore sipërcituar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 103-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve njerëzore të marrë masa për ristrukturimin e Inspektoriatit Mbrojtjes Territorit me personel të kualifikuar arsimorë sipas deponitave ligjore.

**Menjëherë**

**3.2. Rekomandimi:** IMTV Gjirokastrë të marrë masa për:

- Kryerjen e kontrolleve në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga Kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike.

- Të kryejë kontrolle mbi zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi për të kontrolluar nëse objekti po ndërtohet në përputhje me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik.

- Marrjen e masave për arkëtimin e penaltetit në masën 2% për çdo ditë vonesë në shumën 900,000 lekë ndajë 2 subjekteve të cilat nuk kanë likuiduar në afat, respektivisht: “E.H.” në shumën **300,000 lekë** dhe subjektin “M.C.” në shumën **600,000 lekë**.

- Për të gjitha rastet e shkeljeve të lejes së ndërtimit të kërkohet heqjen e licencës profesionale, personale ose të shoqërisë.

- Të raportojë në IKMT në mënyrë periodike mbi aktivitetin e tij, përkatësisht mbi gjobat e vendosura sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, mbi vendimet për pezullimin e punimeve, mbi vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundër-ligjshëm.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

#### **D. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dokumentacionit ligjorë për arkëtimin e debitorëve nga Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, Bashkia Gjirokastrë konstatohet se në fund të periudhës janë gjithsej debitorë 1032 subjekte në vlerën 70,197,983 lekë, 64 subjekte për qira objekte të tregut në vlerën 2,526,000 lekë dhe 11,345 familje për taksë toke, taksë ndërtese, taksë trualli dhe tarifa vendore, në vlerën 108,289,000 lekë për të cilat edhe pse vazhdojnë procedurat mbledhjes me forcë të detyrimeve, rezultojnë se nga 1032 subjekte debitorë në vlerën 70,197,983 lekë, janë aktiv 591 subjekte ose 57 % e totalit të cilët nuk kanë paguar taksa dhe tarifa, në vlerën 45,033,000 lekë ose 64 % e vlerës së debitorëve.

-Nuk u gjet asnjë rast i ndjekjes së plotë të procedurave të arkëtimin të debitorëve, në kundërshtim me Kreun XI “Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar”, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2, faqe 49-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Gjirokastrë, Drejtoria e të Ardhurave, Pronave Publike, Lejeve dhe Licencave, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 181,012,983 lekë.

**Menjëherë**

#### **E. MASA DISIPLINORE.**

Në lidhje me masa disiplinore nuk rekomandojmë pasi për të njëjtat shkelje të evidentuara në periudhën e auditimit 01.10.2022 – 31.12.2022, për punonjësit përgjegjës janë rekomanduar masa disiplinore në Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 28, datë 23.01.2023, “Mbi auditimin e realizuar për periudhën 01.01.2021 – 31.10.2022”, të cilat subjekti Bashkia Gjirokastrë i ka

zbatuar në masën 100%.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

**KONTROLLI I LARTË i SHTETIT**